



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në:  
“Regji Filmi dhe Televizioni dhe Mësuesi”  
“Universiteti i Arteve”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**


**Prof.Asoc. Dr. Arian Krasniqi**

**Prof.Asoc.Dr. Leticja Gusho**

**Prill / 2023**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Master i Arteve në: “Regji Filmi dhe Televizioni dhe Mësuesi”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Arteve
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Regji dhe Regji Filmi & TV
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Arteve në: “Regji Filmi dhe Televizioni dhe Mësuesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 821, datë 26.12.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 150, datë 19.09.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli II
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	13 PAE dhe 6 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021; 6 studentë; 2021-2022; 7 studentë;
19	Komente / të tjera:	

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Në kuadrin e akreditimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Arteve në “Regji Filmi & TV dhe Mësuesi, kërkuar nga Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, është realizuar procesi i vlerësimit respektivisht sipas gjithë procedurave të miratuara.

Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm.

Programi është riorganizuar nga programi Master i Arteve të Bukura në “Regji Filmi dhe Televizioni”, në Master i Arteve “Regji Filmi & Televizioni dhe Mësuesi”, sipas urdhërit nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë me Nr. 821, datë 26.12.2018.

Ky program ofrohet nga Departamenti i Regji dhe Regji Filmi & TV, pjesë përbërëse e Fakultetit të Artit Skenik.

Programi i Studimit Master i Arteve në Regji Filmi & Televizioni dhe Mësuesi, që ofrohet nga Departamenti Regji Filmi dhe Televizioni është vazhdim i thelluar i njohurive që merren në ciklin e parë të studimeve. Ky program studimi, i cili ka në themel të tij parimin e punës me studentin në qëndër, ka për qëllim kryesor që të përgatisë regjisorë filmi dhe televizioni dhe si rezultat i riorganizimit të tij, bën të mundur dhe formimin psiko-pedagogjik të studentëve për ti aftësuar ata dhe në tregun e punës si mësues në arsimin e mesëm të ulët apo të lartë.

Ky program Master i Arteve përmban gjithsej 120 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike. Numri i studentëve të regjistruar në këtë master ndër vite ka qenë:

Për vitin akademik 2020-2021 ka qënë 6 studentë;

Për vitin akademik 2021-2022 ka qënë 7 studentë;

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

### *Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm*

ASCAL ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UART, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Asoc.Dr.Arian Krasniqi, dhe Prof. Asoc.Dr. Leticja Gusho. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirmeli

### *Dokumentacioni ligjor mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm*

Baza ligjore mbi të cilën është mbështetur vlerësimi i jashtëm është:

- Ligji nr.80 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM nr.824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”.
- Manuali mbi “Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në Kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të lartë dhe programeve të Studimit”, viti 2017, seksioni Nr.3, “Procedura për vlerësimin e programeve të Studimit në Kuadër të Akreditimi të parë periodik”.
- Rregullore e sigurimit të cilësisë e ASCAL
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë UART, si institucini i vetëm publik i arsimit në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.

### *Aktivitetet kryesore të realizuara*

Në kuadër të këtij vlerësimi janë kryer disa aktivitete. Kështu, është realizuar analiza e të dhënave parësore dhe dytësore.

- **Analiza e të dhënave parësore.** Të dhënat parësore janë ekstraktuar nga raporti i vlerësimit të brendshëm për programin e studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve “Regji Filmi & TV dhe Mësuesi” (2022) i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm (Urdhër i Rektorit UART, nr.283, datë 28.02.2022)<sup>1</sup>, dhe urdhëri i dekanit të FAS, Nr.01, dt 10.03.2022<sup>2</sup>, Statuti i UART,

<sup>1</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Urdhëri i Rektorit të UART Prof. Kastriot Çausi, me Nr. 283, datë 28.02.2022, “lënda: “Mbi ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër akreditimit të programeve të studimit të ciklit të dytë Master” ASCAL, Evidenca. Nr.1.17. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>2</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Urdhëri FAS Nr. 01, dt. 10.03.2022, “Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë master në Fakultetin e Artit Skenik” ASCAL, Evidenca. Nr.1.18. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Rregullore e UART, paketa e plotë e dokumentacionit të Programit, programet lëndore, si dhe dokumentacione të tjera administrative, siç është dokumentacioni i personelit.

- **Analiza e të dhënave dytësore.** Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga vizitat në institucion. Vizitat në ambjentet e institucionit UART, FAS u zhvilluan në datat 10 edhe 11 Nëntor 2022. Gjatë këtyre vizitave u zhvilluan bashkëbisedime të qëllimta si edhe vëzhgime. Kështu, u realizuan biseda të drejtuara me Drejtuesin e Njesisë Qëndrore, Dekanin e Fakultetit të Artit Skenik, Përgjegjës të Departamentit Regji Filmi dhe Televizioni, takim me përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, takim me përfaqësuesit e Sektorit mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Aluminit, takim me përfaqësues të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, takim me përfaqësues të sekretarisë, takim me përfaqësues të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të Programit, takim me stafin akademik të programit të studimit, si edhe takim me përfaqësues të Sektorit të Projekteve Artistike & Shkencore.
- **Vëzhgim i mjediseve**  
Gjatë ditëve të vizitave në institucion u realizuan vëzhgime të ndryshme në auditorë, mjedise artistike, shërbimet për studentët, si edhe ambjenteve të bibliotekës

Duke u mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime është hartuar dhe raporti i vlerësimit të jashtëm.

Universiteti i Arteve është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 10.03.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 52/13 Prot, datë 13.03.2023. Universiteti i Arteve më datë 24.03.2023, njofton me anë të shkresës Nr. 296/1 Prot, datë 21.03.2023, "Mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit MA në "Regji Filmi dhe Televizioni dhe Mësuesi".

*Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:*

**Konstatim i GVJ:** Standardi I.2, Kriteri 5: Siç është konstatuar edhe në RVB, UART-i nuk ofron trajnime profesionale apo programe të ciklit të vazhduar.

Rekomandohet ofrimi i trajnimeve të mëtejshme profesionale për të gjithë të interesuarit në këtë fushë.

**Komenti i IAL:** Universiteti i Arteve, FAS dhe Departamenti RRFTV zotërojnë eksperiencën dhe kapacitetet, si në personel akademik ashtu edhe në punë organizative apo ambiente, për të ofruar trajnime profesionale apo programe të ciklit të vazhduar në Regji Filmi & TV dhe Mësuesi. Sigurisht kjo do të ndodhë pasi tendencat aktuale të tregut mendojmë se po shfaqim si imperative ofrimin e trajnimit dhe kurseve të mësipërme. Elemente të tjera që duhen mbajtur parasysh janë edhe kapacitetet pritëse të institucioneve artistike të fushës. Ofrimi i trajnimeve dhe programeve të cituara nga GVJ sigurisht që do të rriste konkurrencën në treg duke rritur edhe cilësinë.

**Përgjigjja GVJ:** Vlerësimi për Standardin I.2, Kriteri 5, nuk ndryshon. GVJ i qëndron vlerësimin fillestar të standardit: përmbushet kryesisht.

**Konstatim i GVJ:** Standardi I.3, Kriteri 4: Rekomandohet që në çdo raport apo analizë që merret me veprimtarinë vjetore të FAS dhe të Departamentit të RRFTV, të merret në konsideratë edhe analizimi i zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara me rrugë institucionale, që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi & Tv dhe Mësuesi”.

**Komenti i IAL:** Departamenti i RRFTV e vlerëson gjetjen dhe rekomandimin e lëshuar nga GVJ. Deri më tani Departamenti i RRFTV në raportet dhe analizat e veta apo atyre që janë zhvilluar në Grupet Mësimore apo edhe në Dekanatin e FAS ka shqyrtuar të gjitha elementët e punës që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Janë disa faktorë që kanë ndikuar vitet e fundit lidhur me analizën e zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara.

-Për shkak të pandemisë Covid-19, si UART edhe partnerët e tij brenda dhe jashtë vendit u gjetën të shtrënguara ta zhvillojnë aktivitetin e tyre online, duke mos patur mundësinë e realizimit konkret të projekteve të përbashkëta.

-Po ashtu, theksojmë se një pjesë e madhe e marrëveshjeve të nënshkruara janë marrëveshje afatgjata dhe parimore të cilat shtrihen në kohë.

Pavarësisht sa më lart, Departamenti i RRFTV e gjen me vend rekomandimin e lëshuar nga GVJ, për rrjedhojë analiza e zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara në rrugë institucionale nuk do të jetë më një element i munguar në analizat tona.

**Përgjigjja GVJ:** Vlerësimi për Standardin I.3, Kriteri 4, nuk ndryshon. GVJ i qëndron vlerësimin fillestar të standardit: përmbushet kryesisht. Theksojmë këtu se vetë Departamenti i RRFTV e ka pranuar rekomandimin e lëshuar nga GVJ.

**Konstatim i GVJ:** Standardi II.1, Kriteri 8: Rekomandohet që kodi 72MA0211S i Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi & Tv dhe Mësuesi” të shoqërojë të gjithë dokumentacionin që i përket këtij programi.

**Komenti i IAL:** Departamenti i RRFTV e vlerëson gjetjen dhe rekomandimin e lëshuar nga GVJ. Departamenti i RRFTV do të punojë ngushtësisht me Dekanatin e FAS si edhe Sektorin Mësimor dhe të Kurrikulës për zbatimin e rekomandimit të GVJ.

**Përgjigjja GVJ:** Vlerësimi për Standardin II.1, Kriteri 8, nuk ndryshon. GVJ i qëndron vlerësimin fillestar të standardit: përmbushet kryesisht. Theksojmë këtu se vetë Departamenti i RRFTV e ka pranuar rekomandimin e lëshuar nga GVJ.

**Konstatim i GVJ:** Standardi IV.4, Kriteri 6: Për informacionet e përgjithshme faqja është e qasshme nga çdo përdorues, pa limitime aksesit. Por, disa informacione në faqen mund të ofrohen edhe në gjuhën angleze, edhe pse jo të gjitha.

**Komenti i IAL:** Departamenti i RRFTV e vlerëson gjetjen dhe rekomandimin e lëshuar nga GVJ.

UART prej një viti është në procesin e evidentimit të problematikave të uebfaqes së UART me qëllim shndërrimin e saj në një faqe edhe më interaktive, ku vendin kryesor do ta zërë thjeshtësia e përdorimit, informacioni i bollshëm dhe i saktë, si edhe transparënca me publikun e gjerë.

Duke falenderuar GVJ për rekomandimin e lëshuar, Departamenti i RRFTV do të parashtrojë kërkesën e tij në grupin e punës për realizimin e uebfaqes së re të UART për një kopje të plotë të kësaj uebfaqeje në gjuhën angleze.

**Përgjigjja GVJ:** Vlerësimi për Standardin IV.4, Kriteri 6, nuk ndryshon. GVJ i qëndron vlerësimin fillestar të standardit: përmbushet kryesisht. Theksojmë këtu se vetë Departamenti i RRFTV e ka pranuar rekomandimin e lëshuar nga GVJ.

**Konstatim i GVJ:** Standardi VI.5, Kriteri 4: Megjithatë, GVJ sugjeron, që një proces i monitoruar në mënyrë më të përqëndruar, do të kishte një impakt më të spikatur në përmirësimin e sigurimit të cilësisë. Kjo do të ishte në dobi më afatgjatë, jo vetëm për Programin që i nënshtrohet vlerësimin, por edhe vetë institucionit.

**Komenti i IAL:** Departamenti i RRFTV, duke falenderuar GVJ për sugjerimin, do të punojë ngushtësisht me të gjitha strukturat, si në FAS ashtu edhe në UART, për të realizuar procesin e vlerësimin dhe sigurimit të efektivitetit dhe impaktit të veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimin të cilësisë në mënyrë më të përqëndruar.

**Përgjigjja GVJ:** Vlerësimi për Standardin VI.5, Kriteri 4, nuk ndryshon. GVJ i qëndron vlerësimin fillestar të standardit: përmbushet kryesisht. Theksojmë këtu se vetë Departamenti i RRFTV e ka pranuar rekomandimin e lëshuar nga GVJ.

**Konstatim i GVJ:** Standardi VI.5, Kriteri 5: Megjithatë, edhe pse Grupit të Vlerësimin të Jashtëm iu bë një paraqitje shumë e mirë e të gjithë punës së Komisionit AD Hoc për Sigurimin e Cilësisë, GVJ i rekomandon Universitet të Arteve, që këtë Komision ta shndërrojë në një Njësi Permanente për Sigurimin e Cilësisë, në përputhje edhe me Statutin dhe Organogramin të miratuar nga Ministria e Arsimit, që do të kishte mandate dhe fushëveprimtari të qartë për Sigurimin e Cilësisë në Institucion e rrjedhimin edhe në Program.

**Komenti i IAL:** Departamenti i RRFTV e vlerëson gjetjen dhe rekomandimin e lëshuar nga GVJ. Duke kuptuar rëndësinë e rekomandimit të lëshuar nga GVJ, Departamenti i RRFTV merr përsipër të përdorë influencën e vet pranë Dekanatit të FAS si edhe të anëtarëve të tjerë të këtij departamenti të cilët janë përfaqësuesit tanë në Senatit Akademik të UART për të zgjidhur në mënyrë institucionale dhe përfundimtare edhe çështjen e sigurimit të cilësisë nëpërmjet ngritjes, sipas rekomandimit, të Njësisë Permanente për Sigurimin e Cilësisë në UART.

**Përgjigjja GVJ:** Vlerësimi për Standardin VI.5, Kriteri 5, nuk ndryshon. GVJ i qëndron vlerësimin fillestar të standardit: përmbushet kryesisht. Theksojmë këtu se vetë Departamenti i RRFTV e ka pranuar rekomandimin e lëshuar nga GVJ.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë i Arteve në “Regji Filmi & TV dhe Mësuesi”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Në parathënien e Statutit<sup>3</sup> të UART-it, vihet në dukje se UART-i është trashëgimtar i të gjitha institucioneve pararendëse që kanë ushtruar veprimtarinë e tyre përpara vitit 1990. Gjithashtu, UART është nxitës dhe nismëtar i zhvillimeve artistike dhe kulturore që promovojnë ruajtjen, mbrojtjen dhe pasurimin e trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar.</p> <p>Në Statutin e UART<sup>4</sup> theksohet në nenin 4/b se misioni i UART-është që të formojë specialistë të lartë në fushën e arteve dhe të përgatisë artistë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit. Gjithashtu, po në nenin 4/e të Statutit, theksohet se UART mbështet prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit.</p> <p>Në nenin 7/2 të Statutit (Zhvillimi i veprimtarisë), theksohet se UART vendos në bazë të mësimdhënies <i>traditat më mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit</i>, të ndërthurrura me standardet dhe arritjet më të mira europiane dhe botërore.</p> <p>Në Planin Strategjik të UART<sup>5</sup> për vitet 2018-2025, në vizionin strategjik (pika 1.1) theksohet se <i>objektivat e UART-it janë në mbështetje të qëllimeve dhe prioritetëve kombëtare.</i></p>

<sup>3</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Urdhër të MASR Nr.319 datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të UART”. Bashkëngjitur Statuti.” ASCAL, Evidenca Nr.1.15.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>4</sup> idem

<sup>5</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025” ASCAL, Evidenca Nr.2.6. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Në qëllimet dhe objektivat e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”<sup>6</sup> përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Specializim i njohurive të studentëve krahasuar me programin e studimit të ciklit të parë në fushën e regjisë skenike;</li> <li>- Përgatitje e avancuar e studentëve për formimin e kompetencave dhe aftësive që iu korrespondojnë nivele të kualifikuara të punësimit dhe të profesionalizmit në fushën e regjisë së teatrit dramatik, të regjisë së teatrit të operas, të regjisë së teatrit të kukullave dhe të çdo lloj spektakli tjetër skenik;</li> <li>- Trajnim për kërkim të pavarur nëpërmjet njohjes së metodave, instrumentave e teknikave të krijimit në aspekte që kanë të bëjnë me regjinë, dramaturgjin pedagogjinë, etj;</li> </ul> <p>Ndërsa në parathënien e Statutit theksohet se UART-i është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, me karakter akademik, artistik dhe shkencor me veprimtari në fushën e arteve, duke shtuar se UART-i gëzon status të veçantë bazuar në VKM me nr.145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e statusit të veçantë UART si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”. Duket qartë që ka përputhje të plotë midis qëllimeve dhe misionit të Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” dhe qëllimeve dhe misionit të UART-it.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të Institucionit.</p>	<p>Fushat e drejtimeve akademike të UART-it tregohen në parathënien e Statutit<sup>7</sup> dhe misionin e UART-it ndërsa në nenin 7 të Statutit thesohet se <i>UART-i, në përputhje me misionin e tij të mësimdhënies, të artit e të kulturës dhe të kërkimit shkencor, harton programe dhe projekte të veçanta sipas nevojave dhe fushave të ndryshme.</i></p> <p>Një nga njësitë kryesore të UART-it, siç tregohet në nenin 10 të Rregullores së UART-it<sup>8</sup>, është edhe Fakulteti i Artit Skenik (FAS), në përbërje të të cilit është edhe Departamenti Regji dhe Regji Filmi &amp; TV. Në Planin Strategjik të Zhvillimit të UART-</p>

<sup>6</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.”

<sup>7</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Urdhër të MASR Nr.319 datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të UART”. Bashkëngjitur Statuti.” ASCAL, Evidenca Nr.1.15.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>8</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.”




	<p>it<sup>9</sup> për vitet 2018-2025 (Qëllimet strategjike) theksohet zgjerimi i aksesit nëpërmjet programeve të reja. Gjithashtu, në këtë strategji, në Objektivat e Strategjisë, theksohet mundësimi i studentëve që të jenë konkurrues në tregun e punës. Duket se Programi i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”, është në përputhje me strategjinë dhe fushat e drejtimeve akademike të institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Nuk ka referencë në RVB dhe as në dokumentacionin e paraqitur për lidhjen e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” me strategjinë kombëtare për arsimin që është miratuar me VKM nr.621, datë 22.10.2021 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”. Mendojmë se është e vështirë, madje e pamundur, që UART-i të sinkronizohet në kohë dhe objektiva me këtë strategji. Por UART-i ka Planin e vet Strategjik për vitet 2018-2025, sipas të cilit <i>UART-i operon në një treg global, duke konkurruar brenda vetes dhe brenda vendit për t’i shërbyer atyre që duan të shkollohen në Shqipëri si dhe duke plotësuar të gjitha nevojat e tregut të shkollimit artistik me afrimin e politikave konkurruese me tregun vendas dhe me atë të huaj.</i></p> <p>Gjithashtu, në Planin Strategjik 2018-2025, UART-i synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshtatjen e mëtejshme me tregun kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet hapjes së programeve të reja të studimit dhe plotësimit të tyre ekzistuese sipas kërkesave të akteve ligjore në fuqi.</li> <li>- Studimin e kërkesave të tregut për produktin që del nga UA, duke e intensifikuar kërkimin për produktin.</li> <li>- Plotësimin e qëllimeve dhe prioriteteve kombëtare.</li> </ul>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Statuti i UART-it, si edhe Plani Strategjik 2018-2025 theksojnë se qëllimet dhe synimet e UART-it marrin në konsideratë prioritetet e zhvillimit të vendit dhe interesat kombëtare. Programi i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” është hartuar në përputhje me aktet kryesore</i></p>

<sup>9</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025” ASCAL, Evidenca Nr.2.6. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




	<i>rregullatore të institucionit që janë Statuti dhe Plani Strategjik 2018-2025.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.2

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Programi i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” mbulohet nga Departamenti i Regji, Regji Filmi dhe Televizioni (RRFTV) si pjesë përbërëse e Fakultetit të Artit Skenik (FAS). Konstatohet se përgjatë viteve 2017-2021<sup>10</sup> si pjesë e Departamentit RRFTV, detyrën e personelit akademik efektiv dhe atij të ftuar (me kontratë) e kanë ushtruar pedagogë me përvojë dhjetrvjeçare në fushën përkatëse dhe njëkohësisht, nisur nga CV<sup>11</sup> e personelit akademik, rezultoi se personeli akademik është një kombinim brezash dhe përvojash të larmishme, me kualifikime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Fakulteti i Artit Skenik për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej <b>72 pedagogë</b>, nga të cilët <b>44 janë pedagogë efektiv (PAE)</b> nga ku: 13 kanë titullin “Profesorë”, 15 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 8 kanë gradën Dr./PhD, dhe 8 Asistent Lektorë me Msc; dhe <b>28 pedagogë me kontratë (PAK)</b> nga ku 2 ka titullin “Profesor”, 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”, 3 kanë gradën Dr./PhD. dhe 22 Asistent Lektorë me Msc. (<i>Aneks 182 Tabela Nr 1 Fakulteti i Artit Skenik</i>)</p>

<sup>10</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Tabelat e stafit akademik FAS 2017-2018 ” ASCAL, Evidenca Nr.2.8.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Tabelat e stafit akademik FAS 2018-2019 ” ASCAL, Evidenca Nr.2.8.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Tabelat e stafit akademik FAS 2019-2020” ASCAL, Evidenca Nr.2.8.3. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “4 Tabelat e stafit akademik FAS 2020-2021” ASCAL, Evidenca Nr.2.8.4. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>11</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Të dhëna mbi titujt akademikë dhe gradave shkencore të stafit akademik të programit të studimit dhe CV të personelit akademik të angazhuar në këtë program”

	<p>Ndërsa në departamentin Regji, Regji Filmi dhe Televizioni, për vitin akademik 2021-2022, janë <b>16 pedagogë, si personel akademik efektiv (PAE)</b>, nga të cilët janë 6 me titullin “Profesor”, 5 me titullin “Prof. As”, 1 me gardën “Dr” dhe 4 me kualifikimin “Master i Shkencave”. Në departament janë të angazhuar dhe <b>12 personel akademik me kontratë (PAK)</b>, nga të cilët janë 1 me titullin “Profesor”, 1 me titullin “Profesor i Asociuar”, 1 “Dr” dhe 9 me “Master i Shkencave”.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Sipas nenit 4 të Rregullores, FAS<sup>12</sup> ka për qëllim organizimin e procesit të mësimdhënies në fushën e Aktrimit, Regjisë, Regjisë së Filmit dhe Televizionit, Skenografisë, Kostumografisë dhe Koreografisë. Sipas nenit 2 të Rregullores së Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”<sup>13</sup>, qëllimi kryesor i këtij programi studimi është që të garantojë, midis të tjerash:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Specializim në fushën e regjisë skenike;</li> <li>- Përgatitje të avancuar në fushën e regjisë së artit dramatik, të regjisë së teatrit të operas, të regjisë të teatrit të kukullave, të regjisë skenike të spektaklit televiziv, regjinë televizive dhe regjinë e filmit.</li> </ul> <p>Referuar VKM nr.310, datë 11.5.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, fusha e gjerë e studimit përkon me atë të UART (02-Arte dhe Shkenca Humane), fusha e ngushtë e studimit përkon me atë të Fakultetit të Artit Skenik (021-Arte) dhe fusha e detajuar e studimit përkon me të Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” (që është 0211-teknika audiovizuale dhe produksion mediatik). Programi i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” përkon me nivelin 7/1 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Rezulton se ka harmoni midis fushës së studimit të UART-it, fushës së studimit të FAS-it, si edhe fushës së studimit të Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”.</p>

<sup>12</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e FAS” ASCAL, Evidenca Nr.2.3. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>13</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Departamenti i RRFTV<sup>14</sup> ka për qëllim kryesor organizimin e procesit të mësimdhënies, atij artistik kërkimor-shkencor, zhvillimin dhe përhapjen në nivele më të larta intelektuale të dijes në fushën e Regjisë, Regjisë së Filmit dhe Televizionit. Siç u tregua në Kriterin 2 të Standardit I.2, Programi i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”<sup>15</sup>, ka si qëllim kryesor që të garantojë, midis të tjerash:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Specializim në fushën e regjisë skenike.</li> <li>- Përgatitje të avancuar në fushën e regjisë së artit dramatik, të regjisë së teatrit të operas, të regjisë së teatrit të kukullave, të regjisë skenike të spektaklit televiziv, regjinë televizive dhe regjinë e filmit.</li> </ul> <p>Konstatohet se fusha e përgjithshme dhe specifike Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë (Departamentit të RRFTV).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.</p>	<p>Kriteri 4 nuk përkon me rastin e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Siç është konstatuar edhe në RVB, UART-i nuk ofron trajnime profesionale apo programe të ciklit të vazhduar.</p> <p><i>Rekomandohet ofrimi i trajnimeve të mëtejshme profesionale për të gjithë të interesuarit në këtë fushë.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Personeli akademik është një kombinim brezash dhe përvojash të larmishme, me kualifikime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e Programi të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” është në</i></p>

<sup>14</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Departamentit RRFTV” ASCAL, Evidenca Nr.2.4.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>15</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<i>përputhje me fushën akademike e kërkimore të FAS-it dhe të Departamentit RRFTV që mbulon programin e studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Rregullimi i jetës së brendshme dhe organizative të Fakultetit të Artit Skenik, në përbërje të të cilit funksionon edhe departamenti i RRFTV-së, bëhet në bazë të Rregullores së FAS <sup>16</sup> , ndërsa rregullimi i jetës së brendshme dhe organizative të Departamentit të RRFTV-së bazohet në Rregulloren e departamentit <sup>17</sup> .  Në rregulloren e FAS-it përcaktohen qëllimet e fakultetit, parimet, fusha e veprimit, organizimi dhe drejtimi i fakultetit. Organizimi i fakultetit përbëhet nga organet drejtuese, autoritetet drejtuese, njësitë bazë mësimore-artistike-shkencore, si edhe nga administrata. Në rregulloren e FAS-it, si edhe në rregulloren e departamentit të RRFTV, përcaktohen me detaje detyrat e çdo hallke mësimore-drejtuese-organizative-ndihmëse dhe në fund të çdo viti akademik përpilohet edhe raporti i analizës vjetore <sup>18</sup> të punës në departament.
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit	Referuar evidencave shoqëruese <sup>19</sup> të RVB-së, UART-i ka zhvilluar ndër vite marrëdhënie bashkëpunimi në fusha të

<sup>16</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e FAS" ASCAL, Evidenca Nr.2.3. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>17</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e Departamentit RRFTV" ASCAL, Evidenca Nr.2.4.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>18</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Analiza e punës vjetore për vitin akademik 2019-2020 në RFTV." ASCAL, Evidenca Nr. 2.12. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>19</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "UART në Marrëveshjet e Bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus +" ASCAL, Evidenca Nr.2.13. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

14

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

<p>mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>ndryshme me interes të ndërsjelltë të palëve, me institucione të ndryshme si brenda ashtu edhe jashtë vendit.</p> <p><u>Marrëdhëniet ndërinstitucionale brenda vendit përfshijnë:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- midis universiteteve publike dhe private;</li> <li>- midis UART-it dhe ministrisë që mbulon arsimin dhe shkencën;</li> <li>- midis UART-it dhe enteve publike që operojnë në fushat që mbulon veprimtaria e UART-it;</li> </ul> <p><u>Marrëdhëniet ndërinstitucionale me jashtë vendit përfshijnë:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- marrëdhëniet midis UART-it dhe institucioneve europiane (dhe jo vetëm) të arsimit të lartë me profil të ngjashëm me UART-in;</li> <li>- marrëdhëniet midis UART-it dhe programeve Erasmus+ apo programeve të ngjashme me to;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve.</p>	<p>Referuar evidencës shoqëruese<sup>20</sup> të RVB-së, UART-i ka zhvilluar ndër vite marrëdhënie bashkëpunimi në fusha të ndryshme, me interes të ndërsjelltë të palëve, me shumë institucione dhe institute të fushave të ngjashme me ato që mbulon UART-i, si me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Akademinë e Studimeve Albanologjike;</li> <li>- Arkivin Shtetëror Qëndror të Filmit;</li> <li>- Insitutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;</li> <li>- Qendrën Kombëtare të Kinematografisë;</li> <li>- Teatrin kombëtar të Operas dhe Ansamblin Popullor;</li> <li>- Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë;</li> <li>- Galerinë Kombëtare të Arteve;</li> <li>- Teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”;</li> </ul> <p>Marrëveshjet e bashkëpunimit kanë konsistuar kryesisht në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shkëmbimin e stafit akademik, të kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarive kërkimore-shkencore;</li> <li>- nxitjen e projekteve të përbashkëta;</li> <li>- shkëmbim literature dhe akses në arkiva;</li> </ul>

“UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Marrëveshje Bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit” ASCAL, Evidenca Nr.2.14. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>20</sup>“UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Marrëveshje Bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit” ASCAL, Evidenca Nr.2.14. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




	<p>- kryerje e internship-eve, stazheve dhe praktikave të studentëve; - pjesëmarrje në shfaqje, forume dhe debate etj;</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Siç edhe tregohet në RVB, në tre vitet e fundit për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, marrëveshjet e arritura midis UART-it dhe institucioneve apo insituteve apo organizmave të tjera brenda dhe jashtë vendit, nuk janë realizuar plotësisht sipas programit të parashikuar.</p> <p>Në Raportin<sup>21</sup> e paraqitur për realizimin e punës artistike-mësimore-shkencore të stafit akademik të FAS për vitin akademik 2019-2020, në pjesën që analizon punën e FAS-it, nuk përmendet analizimi i zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka nënshkruar UART-i dhe që lidhen drejtpërsëdrejti me zbatimin e Programit të Studimit Master i Arteve "Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi". Gjithashtu, edhe në raportin që analizon vitin akademik 2020-2021<sup>22</sup>, përsëri nuk përmendet analizimi i zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit. Duhet theksuar se departamente të tjerë në përbërje të FAS kanë marrë në analizë zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p><i>Rekomandohet që në çdo raport apo analizë që merret me veprimtarinë vjetore, të FAS dhe të Departamentit të RRFTV, të merret në konsideratë edhe analizimi i zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara me rrugë institucionale, që lidhen drejtpërdrejti me zbatimin e Programit të Studimit Master i Arteve "Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi".</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>UART-i, në përbërje të të cilit është FAS, ka nënshkruar marrëveshje të shumta bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj, të cilat kanë konsistuar në shkëmbimin e stafit akademik, të kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarive kërkimore-shkencore, nxitjen e projekteve të përbashkëta etj.</p> <p>Në UART funksionon një ndarje e qartë e detyrave, si në linjën vertikale UART-FAS-DRRFTV, ashtu edhe në linjën horizontale</p>

<sup>21</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Raporti vjetor i punës artistike-mësimore-shkencore i stafit akademik të FAS për vitin akademik 2019-2020" ASCAL, Evidenca Nr.4.4. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>22</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore i stafit akademik të UART për vitin akademik 2020-2021 " ASCAL, Evidenca Nr.6.11. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



	<i>që është ndarja e punës dhe veprimtarive midis dhe brenda çdo njësie përbërëse.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Elementët që përbëjnë strukturën e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”, referuar VKM 41/2018, të ndryshuar, të përcaktuara në Rregulloren e Programit të studimit<sup>23</sup> figurojnë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi ka kohështrirje 2 vjeçare dhe në përfundim të tij studenti grumbullon 120 kredite;</li> <li>- Kontrolli i dijeve bëhet përmes provimit me shkrim, provimit me gojë, vlerësimit të detyrave dhe projekteve, kombinimit të tre formave, etj;</li> <li>- Rezultatet e të nxënit dhe kompetencat profesionale përcaktohen në nenin 3 të rregullores;</li> <li>- Veprimtaritë formuese, kategoritë e veprimtarive formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit përcaktohen në nenin 6 të rregullores;</li> <li>- Plani mësimor përcaktohet në nenin 9 të rregullores;</li> </ul>

<sup>23</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuotat e pranimit dhe mënyrat e pranimit përcaktohen në nenet 11 dhe 12, ndërsa grupet mësimore parashikohen në nenin 15 të rregullores;</li> <li>- Programi lëndor (Syllabus-et) jepet i plotë në evidencën 3.2.5.<sup>24</sup></li> <li>- Mënyra e dhënies së diplomës dhe e suplementit të saj parashikohen në nenin 37-38 të rregullores;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” është hartuar që t’i përshtatet tregut të punës. Silabusi i Programit<sup>25</sup> të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”, në pjesën ku përcaktohen rezultatet e të nxënësve dhe karakteristikat e programit të studimit tregojnë me detaje njohuritë dhe aftësitë, e përgjithshme dhe speciale, që fiton studenti në përfundim të studimeve, tregojnë njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin, si edhe mundësitë për punësim që hapen pas përfundimit me sukses të programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Referuar programit lëndor<sup>26</sup>, praktika mësimore kryhet përgjatë dy viteve akademike dhe përfshin 150 orë mësimore në auditor dhe 75 orë pune individuale dhe vlerësohet me 6 kredite.</p> <p>Detyrimet përmbyllëse cilësohen si Tema teorike dhe Projekti artistik dhe vlerësohen me 6 kredite.</p>

<sup>24</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Programi i Ciklit të dytë të Studimit MA në RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca Nr.3.2.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>25</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Programi i Ciklit të dytë të Studimit MA në RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca Nr.3.2.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>26</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Programi i Ciklit të dytë të Studimit MA në RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca Nr.3.2.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Programi i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” është vijim në një formë më të thelluar i studimeve të kryera nga studentët që zotërojnë diplomën “Bachelor” në degën Regji Filmi dhe Televizioni.</p> <p>Pas përfundimit me sukses të programit të ciklit të dytë të studimit, të diplomuarit mund të punojnë edhe si mësimsdhënës në lëndët e artit pranë institucioneve të arsimit parashkollor.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Programi mësimor i Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”, referuar programit<sup>27</sup> të paraqitur bashkë me RVB-në, përmban këto lëndë të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik sipas krediteve përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Metodologji e mësimsdhënies, 6 kredite ECTS;</li> <li>- Teoritë e të nxënimit-menaxhimi i klasës, 6 kredite ECTS;</li> <li>- Vlerësim në arsim, 4 kredite ECTS;</li> <li>- Zhvillim i kurrikulës, 4 kredite ECTS;</li> <li>- Psikologji zhvillimi e moshave, 4 kredite ECTS;</li> <li>- Praktikë mësimore, 6 kredite ECTS;</li> </ul> <p>Gjithsej 6 lëndët e mësipërme të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik vlerësohen me 30 kredite ECTS, pra zënë 25% të numrit të përgjithshëm të krediteve prej 120.</p> <p>Programi i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” është program unik dhe nuk ka ngjashmëri me ndonjë program tjetër analog.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të</p>	<p>UART-i është rast unik në Republikën e Shqipërisë dhe funksionon në bazë të VKM nr.145, datë 10.3.2021 “Për dhënie e statusit të veçantë universitetit të arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e</p>

<sup>27</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Programi i Ciklit të dytë të Studimit MA në RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca Nr.3.2.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




<p>veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Shqipërisë”. Sipas këtij vendimi, UART-i gëzon status të veçantë lidhur me:</p> <p>a) organizimin e programeve të studimeve në tri cikle të njëpasnjëshme që përfundojnë me marrjen e diplomave ose të certifikatave përkatëse. Programet e studimeve në UART hartohen nga njësitë bazë dhe paraqiten për miratim në Senatën Akademik. UART-i ofron edhe studime specializuese afatgjata, programe të formimit të vazhduar për fushat e edukimit artistik, si dhe programe studimi me karakter profesional në fushën e arteve;</p> <p>b) punësimin e personelit akademik me kohë të plotë, sipas kriterëve të përcaktuara nga njësia bazë përkatëse e të miratuara nga rektori, që mbajnë parasysh vlerësimin e karrierës profesionale dhe artistike, sipas përcaktimeve në statutin e UART-it;</p> <p>c) të drejtën për të realizuar marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbim përvoja dhe mobiliteti në procesin mësimor-artistik dhe shkencor me institucione të arsimit të lartë, institucione të kërkimit shkencor, persona juridikë publikë ose privatë, vendas apo të huaj. Niveli i bashkëpunimit përcaktohet në marrëveshjet përkatëse të lidhura ndërmjet institucioneve;</p> <p>ç) hartimin e kriterëve dhe të testeve artistike të pranimit me konkurrim të kandidatëve për studentë në UART;</p> <p>Statuti i UART-it miratohet me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, bazuar edhe në statusin e veçantë të dhënë me këtë vendim;</p> <p>Gjithashtu, edhe mënyra e pranimit të studentëve është e veçantë: UART-i miraton kuotat për çdo vit akademik, të cilat miratohen nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, së bashkë me afatet e zhvillimit të konkurseve dhe të tarifave të shkollimit.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë,</p>	<p><b><i>Nuk mund të jepet vlerësim për këtë kriter</i></b> pasi UART-i nuk ofron programe të Ciklit të Dytë me të njëjtën emërtesë dhe në të njëjtën fushë studimi.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me</p>	<p>Sipas referimeve të VKM nr.310 datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të</p>




<p>kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodi i Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” është: <b>72MA0211S</b> ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>72MA</b> tregon llojin e programit të studimit;</li> <li>- <b>0211</b> tregon fushën e detajuar të programit të studimit;</li> <li>- <b>S</b> tregon se programi i studimit zhvillohet në gjuhën Shqipe;</li> </ul> <p><i>Rekomandohet që kodi 72MA0211S i Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” të shoqërohet të gjithë dokumentacionin që i përket këtij programi.</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” nuk është program i përbashkët midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas apo të huaj, për shkak dhe të statusit të veçantë të UART.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>I gjithë dokumentacioni i Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” është hartuar dhe organizuar në mënyrë strikte në përputhje me VKM 4i/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të”, i ndryshuar. Kjo konstatohet në të gjithë elementët e programit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.2</b></p> <p><b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e</p>	<p>Fakulteti i Artit Skenik (FAS) është njësia kryesore, në përbërje të të cilit është Departamenti i RRFTV si njësi bazë, i cili nga ana e tij është përgjegjës për zbatimin e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”. Në përbërje të</p>




përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Departamentit të RRFTV për vitin 2020-2021 janë 14 personel akademik efektiv dhe 14 personel akademik me kontaktë. Gjithashtu, në përbërje të Departamentit të RRFTV janë 11 personel akademik me tituj shkencorë, e personel akademik me gradën Doktor dhe 2 personel akademik as-lektor.

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit i përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	6	1	6	1	6	1
Prof. Asoc.	5	1	5	1	5	1
Dr./PhD.	1	1	1	1	1	1
Msc.	4	9	2	11	2	11
<b>Totali</b>	<b>16</b>	<b>12</b>	<b>14</b>	<b>14</b>	<b>14</b>	<b>14</b>

Rezultoni se numri i personelit akademik të departamentit të RRFTV, si edhe përbërja e tij lidhur me titujt dhe gradat shkencore, është në përputhje me kërkesat e neneve 23 dhe 25 të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik/administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Në nenin 14 të Rregullores<sup>28</sup> së FAS-it parashikohet se pranë FAS-it kryejnë funksionet e tyre:

- Personel ndihmës akademik me karakter mësimor;
- Personel administrative;

Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor-artistik-shkencor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies, projekteve artistike dhe/ose të kërkimit shkencor. Në këtë kategori futen laborantët dhe teknikët. Sekretaria Mësimore është njësi ndihmëse dhe shërbimi, në funksion të procesit mësimor dhe përgjigjet për organizimin dhe mirëfunksionimin e procesit të regjistrimeve, të transferimeve, të

<sup>28</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e FAS" ASCAL, Evidenca Nr.2.3. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>provimeve, për procesin e lëshimit të diplomave, si edhe mbajtjen e rregjistrave të ndryshëm. Për vitin 2020-2021<sup>29</sup>, numri i personelit ndihmës akademik është 8.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Bazuar në VKM nr.824, datë 24.12.2021 "Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë", sipas të cilit është hartuar edhe vlerësimi i këtij programi, koordinatori caktohet nga njësia kryesore/bazë. Në rregulloren e Departamentit të RRFTV<sup>30</sup>, në nenin 9 dhe 10 të saj parashikohen edhe ngritja e grupeve mësimore-artistike-kërkimore brenda departamenteve si edhe funksionet e drejtuesit të grupit mësimor. Në RVB e programit të studimit Regji Filmi dhe Televizioni dhe Mësuesi sqarohet se "RRFTV është organizuar në grupe mësimore. Përgjegjësit e grupeve mësimore janë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij" si dhe "Kordinatori i Programit të Studimit është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale (në rastin kur Dekani nuk ka ngarkuar një tjetër anëtar të stafit akademik me këtë detyrë) në përputhje me objektivat e tij. Kordinatori është anëtar i Personelit Akademik në FAS ose RRFTV. Përgjithësisht rolin e koordinatorit të Programit të Studimit e luan pedagogu që është caktuar edhe kryetar i grupit mësimor për këtë program studimi. Kjo edhe në bazë të nenit 25 të Ligjit të Arsimit të Lartë, pika 5: "Departamenti mund të organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor, në përputhje me llojin dhe misionin e institucionit" dhe pika 11: "Rregulla të tjera për strukturën dhe funksionimin e departamentit përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë".</p> <p>Në këtë frymë, të gjitha atributet e kërkuara nga kriteri i janë atashuar pozicionit të drejtuesit të grupeve mësimore sipas asaj çka shpreh ligji si dhe Rregullorja e Departamentit RRFTV, Rregullorja e programit MASTER ne RTSM si dhe Rregullorja e programit MASTER në RFTV. Në të gjitha rastet në dy rregulloret e mësipërme përmendja e termit</p>

<sup>29</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "4 Tabelat e stafit akademik FAS 2020-2021" ASCAL, Evidenca Nr.2.8.4. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>30</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e Departamentit RRFTV" ASCAL, Evidenca Nr.2.4.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




	"koordinatori/koordinatorja" është në funksion të "përgjegjesit të grupit mësimor".			
<b>Konkluzione</b>	<i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, lidhur me organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike, personelin ndihmës akademik/administrativ.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Jo përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Programi i Studimit Master i Arteve "Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi" rregullohet kryesisht përmes këtyre akteve rregullatore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullorja e FAS-it<sup>31</sup>. Në këtë rregullore përcaktohen llojet e programeve të studimit që ofrohen nga FAS-i, mënyra e pranimit të studentëve, kohëzgjatja e studimeve, regjistrimi, kriteret e procesit të transferimit të studimeve, frekuentimi, mënyra e kontrollit të dijeve, diplomimi, etj.</li> <li>- Rregullorja e Departamentit RRFTV<sup>32</sup>. Në këtë rregullore përcaktohen rregulla më të detajuara për frekuentimin, mënyrën e kontrollit të dijeve, diplomimin, etj.</li> <li>- Rregullorja e Programit të Studimit<sup>33</sup>. Në këtë rregullore përcaktohen qëllimet dhe objektivat e programit të studimit; njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin; kreditet për çdo lëndë dhe në përgjithësi; veprimtaritë formuese të programit të studimit; plani mësimor i programit të studimit dhe programi mësimor lëndor; format e mësimimit dhe ato të kontrollit të dijeve; organizimi i procesit mësimor</li> </ul>

<sup>31</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e FAS" ASCAL, Evidenca Nr.2.3. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>32</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e Departamentit RRFTV" SCAL, Evidenca Nr.2.4.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>33</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



	<p>dhe ndarja në grupe mësimore; frekuentimi dhe kontrolli i dijes; transferimet, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve; ndërrimi, ekuivalentimi i programit dhe apelimi i vendimit të marrë, organizimi i praktikave profesionale; diplomimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Plani mësimor i Programit të Studimit<sup>34</sup>. Plani mësimor paraqet në mënyrë të përmbledhur ndarjen e lëndëve në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë me zgjedhje, lëndë plotësuese, detyrime përmbyllëse. Ndarja e lëndëve dhe sasia e krediteve për çdo lëndë është e shpërndarë në dy vite akademike dhe katër semestra dhe përcakton mënyrën e kontrollit të dijeve për çdo lëndë.</li> <li>- Programet lëndore<sup>35</sup>. Këtu jepen për çdo lëndë/disiplinë në veçanti: emërtimi i lëndës, forma e zhvillimit të saj, numri i krediteve dhe numri i orëve mësimore në klasë; konceptet themelore dhe termat bazë të lëndës; temat e lëndës të ndara në kapituj; forma e kontrollit të dijeve dhe frekuentimi; sistemi i vlerësimit; literatura bazë dhe ajo e detyrueshme.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Siç u përmend në kriterin e mësipërm, Plani mësimor i Programit të Studimit<sup>36</sup> paraqet në mënyrë të përmbledhur ndarjen e lëndëve në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë me zgjedhje, lëndë plotësuese, detyrime përmbyllëse. Ndarja e lëndëve dhe sasia e krediteve për çdo lëndë është e shpërndarë në dy vite akademike dhe katër semestra dhe përcakton mënyrën e kontrollit të dijeve për çdo lëndë. Gjithashtu, përcaktohen edhe sasia e orëve mësimore në auditor dhe e orëve të punës individuale.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me</p>	<p>Informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve tregohen në Rregulloren e FAS-it<sup>37</sup> si edhe në Rregulloren e Programit të Studimit<sup>38</sup>. Në këto</p>


<sup>34</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Planet mësimore FAS" ASCAL, Evidenca Nr.3.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>35</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Programi i Ciklit të dytë të Studimit MA në RFTV dhe Mësuesi" ASCAL, Evidenca Nr.3.2.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>36</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Planet mësimore FAS" ASCAL, Evidenca Nr.3.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>37</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e FAS" ASCAL, Evidenca Nr.2.3. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>38</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>





<p>kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>rregullore përcaktohen midis të tjerash kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit si edhe kriteret për transferimet, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve; ndërrimi, ekuivalentimi i programit dhe apelimi i vendimit të marrë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në aktet rregullatore të Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” përfshihen edhe Programet lëndore<sup>39</sup>. Këtu jepen për çdo lëndë/disiplinë në veçanti: emërtimi i lëndës, forma e zhvillimit të saj, numri i krediteve dhe numri i orëve mësimore në klasë; ndarja në orë leksioni dhe orë seminari, konceptet themelore dhe termat bazë të lëndës; temat e lëndës të ndara në kapituj; forma e kontrollit të dijeve dhe frekuentimi; sistemi i vlerësimit; literatura bazë dhe ajo e detyrueshme.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Rishikimi periodik i Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” parashikohet në Rregulloren e Programit të Studimit<sup>40</sup> në nenin 41 të saj sipas të cilit parashikohen rastet e rishikimit të programit të studimit si: rishikimit të krediteve; rishikimit të programeve mësimore të lëndëve të veçanta; rishikimit të elementëve përbërës të disiplinave të ndryshme; rishikimit të bazës didaktike dhe përmirësimin e literaturës; rishikimit të programit në përputhje me tregun e punës. Rezulton se rishikimi i fundit i programit të studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” është bërë në datë 07 Tetor 2021.<sup>41</sup></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Zhvillimi i Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” rregullohet përkatësisht nga Rregullorja e FAS-it, Rregullorja e Departamentit RRFTV, si edhe Rregullorja e Programit të Studimit. Plani mësimor është i strukturuar në</i></p>

<sup>39</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Programi i Ciklit të dytë të Studimit MA në RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca Nr.3.2.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>40</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>41</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “VSA Nr 27 dt. 07.10.2021 “Miratimi i Planeve Mesimore, Cikli i pare i studimeve me Kohë të Plotë Bachelor dhe Cikli i Dyte i Studimeve me Kohë të Plotë Master në FAS për Vitin Akademik 2021-2022.” ASCAL, Evidenca Nr.3.14. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<i>mënyrën e duhur dhe studentët kanë në dispozicion gjithë informacionin e nevojshëm për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë informacionin e duhur lidhur me regjistrimin, ekuivalentimin dhe transferimin e krediteve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Vetë emërtimi i programit të studimit si program studimi Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”, lejon studimin e njohurive dhe aftësive që i referohen një diapazoni të gjerë mundësish studimi dhe punësimi, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Konstatohet se UART-i ka hartuar aktet e tij rregullatorë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, madje duke iu përgjigjur me shpejtësi edhe ndryshimeve më të fundit ligjore. Programi i studimit i korrespondon nivelit të 7/1 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe përfundimi me sukses i këtij cikli hap rrugën për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- nivelin 8/1 (Dokoratë Shkollë studimesh pasuniversitare Studime të thelluara);</li> <li>- nivelin 8/2 (Master ekzekutiv/master i nivelit të dytë/postmaster specializim afatgjatë);</li> <li>- nivelin 8/3 (Programet e studimeve të formimit të vazhduar);</li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e	Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit Master i Arteve “Regji Filmi & Tv dhe Mësuesi” tregohen në nenin 2 të rregullores së Programit të studimit <sup>42</sup> ndërsa njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin jepen në nenin 3 të rregullores. Kështu, qëllimi kryesor i programit të studimit,

<sup>42</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



<p>objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>përmes aktiviteteve formuese, teorike dhe praktike, është të garantojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Specializim të njohurive krahasuar me programin e ciklit të parë në fushën e regjisë skenike;</li> <li>- Përgatitje e avancuar për formimin e kompetencave dhe aftësive që korrespondojnë me nivele të kualifikuara të punësimit në fushën e regjisë së teatrit dramatik, të regjisë së teatrit të operas, të regjisë së teatrit të kukullave, të regjisë skenike të spektaklit televiziv, të regjisë televizive dhe të regjisë së filmit;</li> <li>- Trajnim për kërkim të pavarur për aspekte që kanë të bëjnë me regjinë, dramaturgjinë, teatrologjinë, kritikën teatrore, pedagogjinë, stile dhe shkolla të ndryshme të krijimit regjisorial;</li> </ul> <p>Ndërsa njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin janë, midis të tjerash:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aftësi për të formuar koncepte komplekse mbi prodhimin teatral;</li> <li>- Aftësi për t'i implementuar konceptet në mënyrë të pavarur;</li> <li>- Aftësi menaxhuese të trupave teatrore;</li> <li>- Aftësi interpretimi si aktor;</li> <li>- Aftësi për të transformuar vizionin teatral në media të tjera;</li> <li>- Aftësi elementare në shkrimin e dramës dhe në kritikën teatrale;</li> </ul> <p>Konstatohet se lëndët e zgjedhura, emërtimi dhe përmbajtja e programeve lëndore, vlerësimi në kredite, si edhe shpërndarja lëndë teorike/praktike mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Konstatohet se struktura e programit dhe lëndët që zhvillohen janë në përputhje me profilin dhe natyrën e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”. Në Planin mësimor<sup>43</sup> konstatoam më përpara se lëndët e formimit pedagogjik zënë 25% të numrit të përgjithshëm të krediteve dhe ky raport i përgjigjet asaj pjese të programit të studimit që lidhet me mësuesinë, duke shtuar se raporti 25% i këtyre lëndëve është</p>

<sup>43</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Planet mësimore FAS” ASCAL, Evidenca Nr.3.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




<p>Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>detyrim ligjor. Po ashtu, emërtimi i lëndëve të tjera me drejtim të ndryshëm nga ai pedagogjik, si edhe raporti teori/praktikë i orëve mësimore i përgjigjet plotësisht profilit të studimit.</p> <p>Siç është përmendur edhe më përpara gjatë gjykimit për Standardin I.3, UART-i ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, por nuk mund të gjykojmë nëse struktura e programit të studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” është apo jo e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Kjo gjë mbetet në diskrecionin e vetë institucionit.</p> <p>Programi i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” nuk është master me drejtim profesional.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Përqindja që zë çdo grup-lëndë (bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, plotësuese, detyrime përmblyëse) duhet të jetë në përputhje me kërkesat e treguara në VKM 41/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të”, i ndryshuar. Por vetë VKM 41/2018 i ka lënë hapësirë manovrimi institucioneve të arsimit të lartë që ofrojnë programe studimi “Master i Arteve”. Në këtë këndvështrim, FAS-i ka të drejtë që të vendosë ato raporte midis lëndëve të natyrave të ndryshme, në përputhje me specifikat dhe profilin e programit të studimit. Siç u përmend më përpara, programet lëndore të Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” mundësojnë punësim në një sërë profilesh dhe profesionesh, përfshirë edhe mësimdhënien. Gjithashtu, UART-i ka marrëveshje në kuadër në Programit Erasmus+, gjë që mundëson mobilitetin dhe shkëmbimin e stafit akademik dhe të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë</p>	<p>Siç u përmend gjatë vlerësimit të standardit II.3.5, rishikimi periodik i Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” parashikohet në Rregulloren e Programit të Studimit<sup>44</sup> në nenin 41 të saj, sipas të cilit parashikohen rastet e rishikimit të programit të studimit. Midis të tjerash, një rast i veçantë është edhe rishikimi i programit në përputhje me tregun e punës. Rezulton se Programi i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” është përshtatur më së miri me kërkesat</p>

<sup>44</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

dhe ndihmëse të viteve të fundit.	e tregut të punës, pasi është modifikuar në atë mënyrë, që pas përfundimit me sukses të studimeve, studenti tashmë i diplomuar mund të punojë edhe në fushën e mësimdhënies. Rezulton se rishikimi i fundit i programit të studimit Master i Arteve “Regji Filmi & Tv dhe Mësuesi” është bërë në datë 07 Tetor 2021. <sup>45</sup>				
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Gjatë vlerësimit të standardit II.4.2 janë treguar edhe qëllimi, njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin e studimit Master i Arteve “Regji Filmi & Tv dhe Mësuesi”. Konstatohet se lëndët e zgjedhura, emërtimi dhe përmbajtja e programeve lëndore, vlerësimi në kredite, si edhe shpërndarja lëndë teorike/praktike mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.				
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Siç u përmend më sipër gjatë vlerësimit të Standardit II.4.1, Master i Arteve në “Regji Filmi & Tv dhe Mësuesi” i korrespondon nivelit të 7/1 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe përfundimi me sukses i këtij cikli hap rrugën për: nivelin 8/1 (Doktoratë Shkollë studimesh pasuniversitare Studime të thelluara); nivelin 8/2 (Master ekzekutiv/master i nivelit të dytë/postmaster, specializim afatgjatë); nivelin 8/3 (Programet e studimeve të formimit të vazhduar).  Vetë emërtimi i programit të studimit si Program i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi & Tv dhe Mësuesi” lejon studimin e njohurive dhe aftësive që i referohen një diapazoni të gjerë mundësish studimi dhe punësimi, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, përfshirë edhe mësimdhënien.				
<b>Konkluzione</b>	<i>Përfundimi me sukses i Master i Arteve në “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” (niveli 7/1) hap rrugën për nivelet 8/1, 8/2 dhe 8/3 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Qëllimi i programit, rezultatet e pritshme të të nxënit, si edhe kompetencat e synuara janë të shprehura në mënyrë të qartë, të cilat arrihen përmes një raporti të drejtë të veprimtarive formuese teorike dhe praktike.</i>				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> </table>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>		

<sup>45</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “VSA Nr 27 dt. 07.10.2021 “Miratimi i Planeve Mesimore, Cikli i pare i studimeve me Kohë të Plotë Bachelor dhe Cikli i Dyte i Studimeve me Kohë të Plotë Master në FAS për Vitin Akedemik 2021-2022.” ASCAL, Evidenca Nr.3.14. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

**Standardi II.5**

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Rezulton se ka patur një bashkëveprim intensiv midis UART-it dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (ose më parë nën emërtimin MASR), në përfundim të cilit ka dalë edhe Urdhëri i MASR nr.821, datë 26.12.2018 “Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Arteve”, sipas të cilit programet e studimit të ciklit të dytë u riorganizuan të gjitha në formën e programeve të studimit në fushën e mësuesisë.</p> <p>Bashkëlidhur RVB-së janë paraqitur edhe studimi i tregut të punës<sup>46</sup> për Programin e Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”, database i personave të diplomuar<sup>47</sup> pranë FAS-it, si edhe dosja e repertorit të shfaqjeve të pedagogëve dhe studentëve<sup>48</sup> të FAS-it dhe të ish të diplomuarve nga ky fakultet.</p> <p>Në faqen e internetit<sup>49</sup> të UART-it, nën emërtimin ALUMNI, gjendet ftesa që u bëhet studentëve-diplomantë për t’u regjistruar në Platformën GRADUA, gjë që u mundëson studentëve të UART-it lehtësi kontakti me tregun e punës.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e</p>	<p>Nga bisedat me Stafin Akademik Efektiv dhe të Ftuar, dhe studentët, rezulton se në fund të çdo viti akademik zhvillohet edhe një sondazh, përmes përdorimit të pyetësorëve me studentët, me qëllim marrjen e mendimeve të tyre përmes lidhur me vlerësimin sipas fushave të Programit të Studimit dhe të Mësimdhënies. Sipas pyetësorit janë marrë mendime nga studentët lidhur me:</p>

<sup>46</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Studimi i tregut për UART/FAS” ASCAL, Evidenca Nr.6.18. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>47</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Database i studentëve të punësuar të RRFTV” ASCAL, Evidenca Nr.6.13. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


<sup>48</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Dosja e repertorit të shfaqjeve/filmave të pedagogëve të FAS, studentëve aktualë dhe ish studentëve” ASCAL, Evidenca Nr.3.16. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>49</sup> <http://ëëë.uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=705&niveli=72>

<p>programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- informacionin që jepet në UART;</li> <li>- shkallën e përmbushjes së pritshmërive krijuese-artistike;</li> <li>- vlerësimin e organizimit dhe të shpërndarjes lëndore;</li> <li>- vlerësimin dhe organizimin e formave të mësimdhënies;</li> <li>- mbështetjen didaktike;</li> <li>- plotësimin e nevojave material;</li> <li>- mënyrën e kontrollit të njohurive;</li> <li>- bashkëpunimin me stafin akademik;</li> <li>- shfrytëzimin e ambienteve të bibliotekës, sallave të leksioneve, të koncerteve, atelieve;</li> </ul> <p>Përfundimet e pyetësorit janë interesante dhe duhet të shërbejnë për përmirësimin e të gjitha elementeve të programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Siç është pasqyruar edhe në vlerësimin e Standardit I.3.3, referuar evidencës shoqëruese<sup>50</sup> të RVB-së, UART-i ka zhvilluar ndër vite marrëdhënie bashkëpunimi në fusha të ndryshme, me interes të ndërsjelltë të palëve, me shumë institucione dhe institute të fushave të ngjashme me ato që mbulon UART-i, si me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Akademinë e Studimeve Albanologjike;</li> <li>- Arkivin Shtetëror Qëndror të Filmit.</li> <li>- Insitutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;</li> <li>- Qendrën Kombëtare të Kinematografisë;</li> <li>- Teatrin kombëtar të Operas dhe Ansamblin Popullor;</li> <li>- Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë;</li> <li>- Galerinë Kombëtare të Arteve;</li> <li>- Teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”;</li> </ul> <p>Marrëveshjet e bashkëpunimit kanë konsistuar kryesisht në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shkëmbimin e stafit akademik, të kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarive kërkimore-shkencore;</li> <li>- nxitjen e projekteve të përbashkëta;</li> <li>- shkëmbim literature dhe akses në arkiva;</li> <li>- kryerje e internship-eve, stazheve dhe praktikave të studentëve;</li> <li>- pjesëmarrje në shfaqje, forume dhe debate etj;</li> </ul>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Departamenti i RRFTV, si edhe FAS, bëjnë përpjekje të vazhdueshme, duke marrë edhe mendimin e studentëve, për të</i></p>

<sup>50</sup>“UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Marrëveshje Bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit” ASCAL, Evidenca Nr.2.14. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



	<i>përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme elementët e programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmirësuar</b>	<b>Përmirësuar pjesërisht</b>	<b>Përmirësuar kryesisht</b>	<b>Përmirësuar plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Në Statutin<sup>51</sup> e UART-it, në nenin 4 të tij (Misioni) përcaktohet se misioni i UART-it është, midis të tjerash:</p> <p>f) të integrojë mësimdhënien me kërkimin artistik/shkencor;</p> <p>J) të ofrojë mundësi për kryerjen e studimeve artistike-kërkimore-shkencore;</p> <p>Ndërsa në nenin 7 të Statutit<sup>52</sup>, përcaktohet, midis të tjerash:</p> <p>3. UART-i e zhvillon veprimtarinë e tij brenda sistemit universitar e të kërkimit artistik/shkencor kombëtar e ndërkombëtar;</p> <p>4. UART-i konsideron detyrë themelore të mësuarit, studimin dhe kërkimin artistik/shkencor;</p> <p>Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” tregohen në nenin 2 të rregullores së Programit të studimit<sup>53</sup>. Kështu, qëllimi kryesor i programit të studimit, përmes aktiviteteve formuese, teorike dhe praktike, është të garantojë, midis të tjerash:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Trajnim për kërkim të pavarur për aspekte që kanë të bëjnë me regjinë, dramaturgjinë, teatrologjinë, kritikën teatrore, pedagogjinë, stile dhe shkolla të ndryshme të krijimit regjisorial;</li> </ul>

<sup>51</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Urdhër të MASR Nr. 319 datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të UART”. Bashkëngjitur Statuti.” ASCAL, Evidenca Nr.1.15.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


<sup>52</sup> idem

<sup>53</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>Gjithashtu, po në nenin 2 të rregullores së programit të studimit, përcaktohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”, i pajis të diplomuarit që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara artistike, teorike dhe praktike, si edhe trajnim për kërkim të pavarur në një fushë brenda një specialiteti;</li> </ul> <p>Rezulton se pjesa që lidhet me kërkimin shkencor e treguar në Rregulloren e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” pasqyron në mënyrë të qartë objektivat madhorë të UART-it të treguara në aktin më të rëndësishëm rregullator të institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Parimi i lirisë akademike të personelit akademik të UART-it pasqyrohet në Statutin e UART-it, si edhe në Rregulloren e FAS-it, Kështu, në Statut<sup>54</sup> në nenin 6 të tij theksohet:</p> <p>Liria akademike garantohet nëpërmjet të drejtës:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a) për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore-artistike dhe shkencore;</li> <li>b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit;</li> </ol> <p>Ndërsa në nenin 5 (Liria akademike) të Rregullores<sup>55</sup> së FAS-it, përcaktohet se”:</p> <p>“Personeli mësimor shkencor në FAS gëzon liri akademike në procesin mësimor-artistik dhe në kërkimin shkencor. Liria akademike nënkupton respektimin e shumëllojshmërisë së ideve, opinionëve, metodave të punës akademike. Garanton zhvillimin e lirë, kritik e krijues të mësimdhënies, të kërkimit artistik-shkencor si edhe të shërbimeve në përputhje me standardet e cilësisë. Liria akademike ushtrohet në përputhje me planet dhe programet mësimore të hartuara dhe të miratuara nga ky fakultet.”</p>

<sup>54</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Urdhër të MASR Nr. 319 datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të UART”. Bashkëngjitur Statuti.” ASCAL, Evidenca Nr.1.15.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>55</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “VSA Nr. 35 datë 07.12.2021 “Për miratimin e rregullores së veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore FAS” ASCAL, Evidenca Nr.4.8. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Në Rregulloren<sup>56</sup> e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” në nenin 13 (Format e mësimit dhe format e kontrollit) përcaktohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- “Procesi mësimor përfshin një larmi formash të mësimit dhe të kontrollit të dijes, të cilat, midis të tjerash, janë: projekte artistike individuale dhe kolektive, punët laboratorike, detyrat e kursit”.</li> </ul> <p>Ndërsa kontrolli i dijeve mund të bëhet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimit të detyrave dhe të projekteve dhe në mënyrat e organizimit të provimit përfshihet edhe provim me detyra dhe projekte kursi.</li> </ul> <p>Vlen të theksohet se edhe në planin mësimor<sup>57</sup> të Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” projekti artistik parashikon 240 orë pune individuale dhe vlerësohet me 14 kredite.</p> <p>Rezulton se për natyrën specifike të UART-it, është diçka e natyrshme promovimi dhe përdorimi në një masë të konsiderueshme i studimeve, projekteve teorike dhe praktike, i punimeve artistike, si edhe i formave të tjera të kësaj natyre.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Siç është treguar edhe në R.VJ, si edhe nga bisedat me drejtues të FAS-it, për shkak të numrit të vogël të studentëve, funksionon me vetëm një njësi qendrore të shërbimeve financiare. Gjithashtu, në fillim të çdo viti akademik, UART-i bën shpërndarjen e buxhetit<sup>58</sup> për çdo njësi kryesore, por duke mos bërë një detajim të nevojave apo kërkesave të ndryshme, qoftë edhe përsa i përket mbështetjes financiare të projekteve të ndryshme artistike. Gjithashtu, FAS-i në përgjigje të kërkesave apo të ideve inovatore merr pjesë në konkurse apo projekte<sup>59</sup> të llojeve të ndryshme, apo në aktivitete të tjera artistike-shkencore.</p>

<sup>56</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA Regji Teatri e Spektakli dhe Mësuesi ” ASCAL, Evidenca Nr.2.5.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>57</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Planet mësimore FAS” ASCAL, Evidenca Nr.3.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>58</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Dosja e buxhetit nga Drejtoria ekonomike ” ASCAL, Evidenca Nr.3.18. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>59</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Model aplikimi projekti nga FAS” ASCAL, Evidenca Nr.3.17. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<b>Konkluzione</b>	<i>Prioritetet dhe objektivat më të rëndësishme të programit të studimit janë sanksionuar në aktet më të rëndësishme rregullatore të UART-it dhe te FAS-it, por për vetë natyrën specifike të UART-it, është diçka e natyrshme promovimi dhe përdorimi në një masë të konsiderueshme i studimeve, projekteve teorike dhe praktike, i punimeve artistike, si edhe i formave të tjera të kësaj natyre, gjithmonë duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Puna mësimore <sup>60</sup> për Programin e Studimit Master i Arteve “Regji Filmi & Tv dhe Mësuesi” zhvillohet në bazë grupi, kursi, si edhe individuale. Ka një ndryshim nga parimet e përgjithshme të përcaktuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të”, i ndryshuar, për shkak të veçantisë së UART-it, i njohur si i “veçantë” përmes VKM nr.145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e statusit të veçantë UART-it si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë shkak, numri i grupeve mësimore mund të lëvizë nga 1 (për lëndë individuale) deri në maksimum 15 studentë.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter	Për shkak të veçantisë së UART-it, është karakteristikë e veprimtarisë së tij mësimore dhe jashtë auditorit organizimi dhe pjesëmarrja e aktiviteteve të llojeve dhe natyrave të ndryshme, të gërshetuara me procesin mësimor. Bashkëlidhur RVB-së, jepen edhe CV-të e personelit akademik <sup>61</sup> dhe pjesëmarrja e tyre ndër

<sup>60</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>61</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Të dhëna mbi titujt akademikë dhe gradave shkencore të stafit akademik të programit të studimit dhe CV të personelit akademik të angazhuar në këtë program”

<p>kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>vite në veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, në mënyrë individuale ose në bashkëpunim me kolegët apo studentët e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Siç është përmendur disa herë më përpara në këtë RVJ, UART/FAS-i është në pozicion të privilegjuar sa i përket mundësive që u ofron studentëve për të gërshtuar veprimtarinë pedagogjike me veprimtarinë krijuese<sup>62</sup>.</p> <p>Në këtë kuadër, është përmendur më përpara në këtë RVJ që UART-i ka disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione analoge brenda dhe jashtë vendit, si edhe me institucione të tjera të ngjashme publike dhe jopublike brenda vendit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” është riorganizuar në bazë të Urdhërit të MASR nr.821, datë 26.12.2018 “Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në UART”, me qëllim që të gjithë programet e mëparshme të studimit të përshtateshin edhe në programe në fushën e mësuesisë. FAS-i ka rishikuar<sup>63</sup> në mënyrë të vazhdueshme kurrikulat e programeve të ciklit të dytë, me qëllim që t’i paraprijë kërkesave të fushës dhe të tregut artistik të brendshëm dhe të jashtëm.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Siç është përmendur edhe në RVB, Programi i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” përfshin pjesën artistike dhe pjesën pedagogjike.</p> <p>Nuk rezultojnë që të ketë komunikim të FAS-it me urdhra/shoqata profesionale lidhur me rekomandime të ndryshme që mund të japin këto urdhra/shoqata sa i përket profesionit të rregulluar të mësuesit, sepse nuk është detyrim ligjor i FAS-it që të hyjë në marrëdhënie bashkëpunimi të këtyre llojeve.</p>

<sup>62</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Dosja e repertorit të shfaqjeve/filmave të pedagogëve të FAS, studentëve aktualë dhe ish studentëve” ASCAL, Evidenca Nr.3.16. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


<sup>63</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Grupet mësimore proces-verbal” ASCAL, Evidenca Nr.3.19. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Pjesa e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” që i korrespondon pedagogjisë (mësuesisë) shkon në 30 kredite, kundrejt sasisë së përgjithshme prej 120 kredite, pra, lëndët e formimit psiko-pedagogjik zënë 25% të totalit të krediteve. Kjo ndarje është në përputhje me kërkesat e vendosura në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Për vetë natyrën e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”, organizimi i mësimit me grupe mësimore, pjesëmarrja në projekte apo detyra të ndryshme me karakter kërkimor-shkencor është diçka e natyrshme. Gjithashtu, përfundimi me sukses i programit të studimit hap rrugën për mundësi të shumta punësimi në tregun e punës.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Niveli i përmbushjes</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p><b>Niveli i përmbushjes</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p><b>Standardi III.1</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies të përdorura gjatë zhvillimit të Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” tregohen në nenin 13 të Rregullores së Programit të Studimit<sup>64</sup> sipas të cilit, format kryesore të procesit mësimor janë:</p> <p>Format e mësimi teorik dhe praktik: mësimet artistike, profesionale individuale dhe kolektive, leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat profesionale, projektet artistike individuale dhe kolektive, punët laboratorike, konsultimet, detyrat e kursit, etj.</p> <p>Gjithashtu, edhe në nenin 23 të Rregullores<sup>65</sup> së Departamentit të RRFTV përcaktohet se format kryesore të punës në departament janë leksionet, seminarët, praktikat profesionale, laboratorët, praktikat lëndore, etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nisur edhe nga veçantia që ka UART-i lidhur me natyrën e tij të mësimdhënies, rezulton se përveç formave tradicionale të mësimdhënies të treguara në kriterin e mësipërm të kësaj RVJ-je, praktikohen edhe forma të tjera të mësimdhënies si pjesëmarrja e studentëve<sup>66</sup> dhe pedagogëve në grupe të përbashkëta artistike-mësimore, zhvillimi i orëve të hapura<sup>67</sup> me pjesëmarrjen e figurave të njohura të fushës së regjisë së filmit dhe të televizionit apo me aktorë të njohur, pjesëmarrja në organizimin e shfaqjeve në rrethe apo grupe të caktuara interesi<sup>68</sup>, etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin</p>	<p>Nga Raporti i Vlerësimit të Brëndshëm<sup>69</sup> dhe gjithashtu nga bisedat e zhvilluara me stafin u konstatua se në kuadër të rritjes</p>

<sup>64</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA Regji Teatri e Spektakli dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca. Nr.2.5.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


<sup>65</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Departamentit RRFTV” ASCAL, Evidenca. Nr.2.4.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>66</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Aktivitetet e përbashkëta të pedagogëve dhe studentëve në 3 vitet e fundit” ASCAL, Evidenca Nr.2.15. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>67</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Shfaqje apo takime me regjisorë/aktorë”) ASCAL, Evidenca Nr.4.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>68</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Të dhëna mbi titujt akademikë dhe gradave shkencore të stafit akademik të programit të studimit dhe CV të personelit akademik të angazhuar në këtë program” ASCAL, Evidenca Nr.3.11. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>69</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi” ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>së cilësisë së mësimdhënies, nxitej në mënyrë të vazhdueshme rritja e kapaciteteve të stafit akademik me anë të pjesëmarrjes në trajnime, masterclases, shkëmbime dhe aktivitete të tjera artistike. Në të njëjtën mënyrë inkurajohet dhe përmirësimi i strategjisë së mësimdhënies dhe nxitjes së procesit të të mësuarit jashtë auditorit në mënyrë të pavarur me anë të studimit të literaturës shtesë. Në të njëjtën kohë mbështetet PAE që të përfitojë nga shkëmbimet në kuadër të programeve të ndryshme Erasmus<sup>70</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentit mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Siç është përmendur në vlerësimin e kriterit I.2.1, konstatohet se përgjatë viteve 2017-2021<sup>71</sup> si pjesë e Departamentit RRFTV, detyrën e personelit akademik efektiv dhe atij të fuar (me kontratë) e kanë ushtruar pedagogë me përvojë dhjetrvjeçare në fushën përkatëse<sup>72</sup> dhe njëkohësisht, nisur nga CV<sup>73</sup> e personelit akademik, rezultojnë se personeli akademik është një kombinim brezash dhe përvojash të larmishme, me kualifikime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Sa i përket ndërtimit të marrëdhënies student-personel mësimdhënës, personeli akademik duhet të respektojë Kodin e Etikës<sup>74</sup> të UART-it, sipas të cilit, personeli i UART-it gjatë kryerjes së detyrës duhet të udhëhiqet nga parimi i korrektesisë, mirësjelljes, bashkëpunimit, moralit të lartë. Gjithashtu, personeli i UART-it duhet të udhëhiqet edhe nga parimet e etikës universitare si respekti i ndërsjellë dhe dinjiteti njerëzor dhe të sigurojë një ambient të respektit reciprok, të paanshmërisë dhe të bashkëpunimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe</p>	<p>Siç është treguar gjatë vlerësimit të kriterit II.5.2, rezultojnë se në fund të çdo viti akademik zhvillohet edhe një sondazh, përmes përdorimit të pyetësorëve me studentët, me qëllim marrjen e</p>

<sup>70</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Mobiliteti Erasmus+ i pedagogëve dhe studentëve FAS" ASCAL, Evidenca. Nr.4.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>71</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Tabelat e stafit akademik FAS 2017-2018 " ASCAL, Evidenca Nr.2.8.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>72</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Të dhëna të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik FAS" ASCAL, Evidenca Nr.4.3. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>73</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Të dhëna mbi titujt akademikë dhe gradave shkencore të stafit akademik të programit të studimit dhe CV të personelit akademik të angazhuar në këtë program"


<sup>74</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Kodi i Etikës UART" ASCAL, Evidenca Nr.4.10. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



<p>përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>mendimeve të tyre përmes lidhur me vlerësimin sipas fushave të Programit të Studimit dhe të Mësimdhënies. Sipas pyetësorit janë marrë mendime nga studentët, midis të tjerash, lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerësimin e organizimit dhe të shpërndarjes lëndore;</li> <li>- vlerësimin dhe organizimin e formave të mësimdhënies;</li> <li>- mbështetjen didaktike;</li> <li>- mënyrën e kontrollit të njohurive;</li> <li>- bashkëpunimin me stafin akademik;</li> </ul> <p>Rezulton, gjithashtu, se është realizuar rishikimi periodik i Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”, kryesisht përsa i përket: rishikimit të programeve mësimore të lëndëve të veçanta; rishikimit të elementëve përbërës të disiplinave të ndryshme; rishikimit të bazës didaktike dhe përmirësimit të literaturës, etj.</p> <p>Rezulton se rishikimi i fundit i programit të studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” është bërë në datë 07 Tetor 2021.<sup>75</sup></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë</p>	<p>Struktura përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, e parashikuar në nenin 35 të Statutit<sup>76</sup> të UART-it, është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPSBC).</p> <p>Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, në përbërje të tij është edhe një përfaqësues/specialist i NJSBC i çdo fakulteti. Gjithashtu, sipas Statutit, në nenin 35/6 të tij, organizimi dhe funksionimi i komisionit duhet të shoqërohet edhe me rregulloren që duhet të miratohet nga Senati i UART-it. Nga materialet shoqëruese të paraqitura së bashku me RVB-në, rezulton se KPSBC, funksionon dhe kryen dhe gjithë elementët përmbushës të NJSBC-së.</p>

<sup>75</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “VSA Nr 27 dt. 07.10.2021 “Miratimi i Planeve Mesimore, Cikli i pare i studimeve me Kohë të Plotë Bachelor dhe Cikli i Dyte i Studimeve me Kohë të Plotë Master në FAS për Vitin Akedemik 2021-2022.” ASCAL, Evidenca Nr.3.14. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>76</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Urdhër të MASR Nr. 319 datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të UART”. Bashkëngjitur Statuti.” ASCAL, Evidenca Nr.1.15.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.									
<b>Konkluzione</b>	<p>Gjatë zbatimit të programit të studimit përdoret një gamë e gjerë formash të mësimdhënies si detyra kursi, projekte, praktika profesionale, orë të hapura, pjesëmarrje e studentëve dhe pedagogëve në grupe të përbashkëta artistike-mësimore, zhvillimi i orëve të hapura me pjesëmarrjen e figurave të njohura të fushës së regjisë së filmit dhe të televizionit apo me aktorë të njohur, etj.</p> <p>Këto forma përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme. Sa i përket sigurimit dhe kontrollit të cilësisë, e parashikuar në Statutin e UART-it, funksionon KPSBC.</p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren <sup>77</sup> e FAS-it dhe në Rregulloren e Programit të Studimit <sup>78</sup> Master i Arteve "Regji Filmi & Tv dhe Mësuesi". Kështu, në Rregulloren e FAS-it në nenin 37 tregohet mënyra e të provuarit të dijes, në nenin 38 tregohen format e kontrollit të dijes dhe mënyra e organizimit të provimit. Gjithashtu, në nenet e mëpasme të Rregullores së FAS-it tregohet me detaje parakushtet për t'u futur në provim, sezoni i provimeve, zhvillimi i provimeve, provimi i diplomës, etj. Në rregulloren e programit të studimit,


<sup>77</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e FAS" ASCAL, Evidenca Nr.2.3. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>78</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi" ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	në nenin 13 të saj, tregohen format e mësimit dhe format e kontrollit dhe në nenin 18 mënyrat e të provuarit të dijes.
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Programet<sup>79</sup> e çdo lënde të zhvilluar gjatë frekuentimit të Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” tregohen në evidencën 3.2.5. Organizimi dhe paraqitja e çdo programi lëndor është hartuar në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga IAL-të” dhe çdo program lëndor paraqet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Numrin e krediteve;</li> <li>- Numrin e orëve mësimore;</li> <li>- Format e mësimdhënies;</li> <li>- Përmbledhjen e lëndës dhe rezultatet e të nxëniet;</li> <li>- Konceptet themelore dhe termat bazë të lëndës;</li> <li>- Temat e lëndës;</li> <li>- Forma e kontrollit të dijeve;</li> <li>- Kontrolli i vazhdueshëm përmes elementëve të caktuar;</li> <li>- Sistemi i vlerësimit të studentëve;</li> <li>- Literatura;</li> <li>- Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës;</li> </ul>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Format përmes të cilave mundësohet testimi i dijeve dhe aftësive të studentëve që frekuentojnë Programin e Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” tregohen në nenin 13 të Rregullores<sup>80</sup> së Programit të Studimit. Në këtë nen përcaktohet se format e kontrollit të dijeve janë bashkëbisedimet, kontrollet teknike, mbrojtje e punëve laboratorike, mbrojtje e detyrave dhe projekteve individuale dhe të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provimet e ndërmjetme, provimet e kursit, provimet e formimit, mbrojtje e temave dhe diplomave, aktivitetet artistike, etj.</p> <p>Kontrolli i dijes mund të bëhet nëpërmjet provimit me shkrim, provimit me gojë, vlerësimit të detyrave dhe projekteve, kombinimit të formave të ndryshme, provimit të formimit</p>

<sup>79</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Programi i Ciklit të dytë të Studimit MA në RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca Nr.3.2.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>80</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>artistik, provimit në grup dhe individual. Mënyra e organizimit të provimit është në funksion të natyrës së disiplinës së lëndës.</p> <p>Në UART njihen edhe disa mënyra të tjera të organizimit të provimit të tilla si provimi i lëndës speciale individuale, provimi me shkrim me një kohëzgjatje të paracaktuar, provim me shkrim dhe me gojë (ku provimi me shkrim është parakusht për të hyrë në provimin me gojë), provim në grup ose individual në realizimin e veprave atistike sipas programit të miratuar, provim me detyra dhe projekte kursi.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Rregullorja e programit të studimit përcakton në mënyrë të qartë kriteret dhe mënyrat e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Programet e çdo lënde të zhvilluar gjatë frekuentimit të Programit të Studimit Master i Arteve "Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi" janë hartuar në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018. Gjithashtu, janë përcaktuar edhe disa mënyra të organizimit të provimeve, gjithmonë në funksion të natyrës së disiplinës së lëndës.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e	Në Rregulloren e Departamentit <sup>81</sup> të RRFTV (neni 29) përcaktohet se në vlerësimin përfundimtar të studentit për një disiplinë apo modul të caktuar merren në konsideratë të gjithë elementët përbërës të zhvillimit të lëndës: pjesa artistike, pjesa teorike, pjesa ushtrimore, detyrat, projektet artistike, labororët, kontrollet e pjeseshme, frekuentimi, etj.

<sup>81</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e Departamentit RRFTV" ASCAL, Evidenca. Nr.2.4.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


<p>lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në programet lëndore<sup>82</sup> të çdo lënde të veçantë që zhvillohet në Programin e Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”, përcaktohet nga titullari i çdo lënde/moduli se kontrolli i vazhdueshëm do të nxirret nga këta elementë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrje aktive në orën e mësimit: 10%</li> <li>- Punë e pavarur krijuese: 20%</li> <li>- Detyrat e kursit: 20%</li> <li>- Projektet e kursit: 20%</li> <li>- Provimi përfundimtar: 30%</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Siç është përmendur edhe në RVB, për vetë veçorinë dhe natyrën specifike që kanë programet që ofrohen nga UART-i të cilat bazohen kryesisht në cilësitë individuale dhe unike të çdo studenti, në pjesën më të madhe të lëndëve provimet zhvillohen kryesisht në auditor. Rezulton se në lëndët e zhvillimit psiko-pedagogjik, të cilat nuk mbështeten në aftësitë thjesht individuale të studentëve, nuk zhvillohen sisteme elektronike të testimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në VKM nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, në pikën 2.1.dh përcaktohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm).</li> </ul> <p>Gjithashtu, në nenin 2.2 a&amp;b të po kësaj VKM-je përcaktohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim e me gojë, eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, performancave artistike, praktikave dhe tezave të diplomave.</li> <li>- Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit nga studenti.</li> </ul>

<sup>82</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Programi i Ciklit të dytë të Studimit MA në RFTV dhe Mësuesi”  
 ASCAL, Evidenca Nr.3.2.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>Ndërsa në Rregulloren e Departamentit<sup>83</sup> të RRFTV (neni 29) përcaktohet se në vlerësimin përfundimtar të studentit për një disiplinë apo modul të caktuar merren në konsideratë të gjithë elementët përbërës të zhvillimit të lëndës: pjesa artistike, pjesa teorike, pjesa ushtrimore, detyrat, projektet artistike, laboratorët, kontrollat e pjesëshme, frekuentimi, etj.</p> <p>Rezulton se vlerësimi përfundimtar i lëndës është bazuar në elementët e programeve lëndore si edhe në VKM-në me nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Siç është theksuar vazhdimisht si në RVB, por edhe në RVJ, UART-i jo vetëm që ka status të posaçëm në tërësi, por veçantitë e tij pasqyrohen edhe në mënyrën e studimit dhe të formimit të grupeve mësimore. Kështu, sidomos në lëndët thellësisht speciale, studentët këshillohen në fund të çdo ore mësimore dhe atyre u lihen detyra për t’u kryer deri në orën e ardhshme mësimore. Dhënia e feedback-ut çdo studentit të fushës së arteve është pjesë e natyrës së veçantë të mësimdhënies që zbatohet në të gjitha programet e studimit që administrohen nga FAS-i.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në Kodin e Etikës të UART-it, në nenin 17/g theksohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Studentët duhet të mos kopjojnë, të mos mashtrojnë gjatë procesit mësimor, si edhe të mos shmangen nga shlyerja e detyrimeve mësimore;</li> </ul> <p>Në Rregulloren e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”, në nenin 21/9 përcaktohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në provim nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve. Studenti që në provim përdor forma e mjete të palejueshme, largohet nga provimi dhe konsiderohet i vlerësuar negativisht;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen</p>	<p>Rezultatet e kontrollit përcaktohen në nenin 21 të Rregullores<sup>84</sup> së Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”. Sipas kësaj rregulloreje, në të gjitha format e</p>

<sup>83</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Departamentit RRFTV” ASCAL, Evidenca Nr.2.4.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>84</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>





<p>në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se tre ditë pune nga data e dhënies së provimit. Në rastet e jashtëzakonshme, shtyrja e dhënies së rezultatit bëhet me vendim të Dekanit.</p> <p>Në faqen zyrtare të UART-it, është funksional sistemi i paraqitjes online të notave PITAGORA<sup>85</sup>, në të cilin çdo student i UART-it mund të marrë informacion përmes përdorimit të llogarisë së tij vetjake.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit<sup>86</sup> (neni 21) parashikohet se komisioni shpall rezultatet e vlerësimit, para plotësimit të dokumentacionit përkatës. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kontestojë rezultatit e marrë. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara apo regjistrimet (kur ka) të studentit me tezën e zgjidhur.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit<sup>87</sup> (neni 21) përcaktohet se në rastet e kontestimit të rezultatit, në komision duhet të marrë pjesë edhe përgjegjësi i njësisë-bazë, për të monitoruar transparencën e procesit. Në përfundim të procesit të rishikimit, komisioni merr vendimin përfundimtar, i cili është i formës së prerë.</p> <p>Gjithashtu, studenti ka të drejtë që të ankohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose është bërë vlerësim i pamërituar për përgjigjen që ka dhënë ose për performancën artistike që ka realizuar. Ankesa duhet të depozitohet brenda një afati 24 orësh nga shpallja e rezultatit. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime komisionin e provimit dhe vetë studentin dhe pas gjykimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë brenda tre ditëve.</p>

<sup>85</sup> Sekretaria Mësimore (rash.al), gjendet ne faqen e UART. Parë më 10 Nëntor 2022.

<sup>86</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi" ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>87</sup> idem

	Vendimi i Dekanit përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë ose jo. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të japë përsëri provimin, me të njëjtin komision dhe nën monitorimin e një përfaqësuesi të caktuar nga Dekani, në një datë tjetër brenda apo jashtë sezonit, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit të provimeve.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive bëhet përmes disa elementëve të ndryshëm si pjesëmarrja aktive në orën e mësimit, puna e pavarur krijuese, detyrat e kursit, projektet e kursit, si edhe provimi përfundimtar. Dhënia e feedback-ut çdo studenti të fushës së arteve është pjesë e natyrës së veçantë të mësimit që zbatohet në të gjitha programet e studimit që administrohen nga FAS-i. Në rregulloren e Programit të Studimit përcaktohet në mënyrë të saktë e gjithë procedura vlerësimit dhe e kontestimit të çdo rezultati.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	<p>Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” tregohen në nenin 2 të rregullores së Programit të studimit<sup>88</sup>, sipas të cilit, qëllimi kryesor i programit të studimit, përmes aktiviteteve formuese, teorike dhe praktike, është të garantojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Specializim të njohurive krahasuar me programin e ciklit të parë në fushën e regjisë skenike;</li> <li>- Përgatitje e avancuar për formimin e kompetencave dhe aftësive që korrespondojnë me nivele të kualifikuara të punësimit në fushën e regjisë së teatrit dramatik, të regjisë së</li> </ul>


<sup>88</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



	<p>teatrit të operas, të regjisë së teatrit të kukullave, të regjisë skenike të spektaklit televiziv, të regjisë televizive dhe të regjisë së filmit;</p> <p>- Trajnim për kërkim të pavarur për aspekte që kanë të bëjnë me regjinë, dramaturgjinë, teatrologjinë, kritikën teatrore, pedagogjinë, stile dhe shkolla të ndryshme të krijimit regjisorial;</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Siç është përmendur edhe në RVB, specifika e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” nuk ka si objekt parësor krijimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit. Megjithatë, dy nga lëndët specifike të programit (Montazh dhe Audio), si edhe një nga lëndët me zgjedhje (Kompjuter 2D&amp;3D)<sup>89</sup> zhvillojnë njohuri të avancuara të programeve speciale kompjuterike.</p> <p>Nisur nga veçantia e programeve të studimit që administrojnë UART-i, zhvillimi i aftësive sociale dhe të komunikimit është në natyrën e këtyre programeve. Sa i përket gjuhës së huaj, në Rregulloren<sup>90</sup> e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”, në nenin 11/3 tregohet se në Programin e Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” kriter pranimi është njohja nga kandidati e një prej 5 gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin jepen në nenin 3 të rregullores së programit të studimit. Kështu, njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin janë, midis të tjerash:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aftësi për të formuar koncepte komplekse mbi prodhimin teatral;</li> <li>- Aftësi për t’i implementuar konceptet në mënyrë të pavarur;</li> <li>- Aftësi menaxhuese të trupave teatrore;</li> <li>- Aftësi interpretimi si aktor;</li> <li>- Aftësi për të transformuar vizionin teatral në media të tjera;</li> </ul>

<sup>89</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Programi i Ciklit të dytë të Studimit MA në RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca Nr.3.2.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


<sup>90</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>- Aftësi elementare në shkrimin e dramës dhe në kritikën teatrale;</p> <p>Në përfundim të procesit mësimor për çdo lëndë të programit të studimit, kompetencat dhe aftësitë e fituara kontrollohen në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë semestrit nisur nga tregues të përcaktuar qartë, si edhe përmes provimit përfundimtar dhe detyrimeve përmbyllëse.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Siç treguam në Standardin III.4.3, njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin janë, midis të tjerash:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aftësi për të formuar koncepte komplekse mbi prodhimin teatral;</li> <li>- Aftësi për t'i implementuar konceptet në mënyrë të pavarur;</li> <li>- Aftësi menaxhuese të trupave teatrore;</li> <li>- Aftësi interpretimi si actor;</li> <li>- Aftësi për të transformuar vizionin teatral në media të tjera;</li> <li>- Aftësi elementare në shkrimin e dramës dhe në kritikën teatrale;</li> </ul> <p>Gjithashtu, siç është përmendur më sipër në këtë RVJ, procesi mësimor gjatë zhvillimit të Programit të Studimit Master i Arteve "Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi" zhvillohet me grupe nga 1-15 studentë.</p> <p>Referuar evidencave shoqëruese<sup>91</sup> të RVB-së, UART-i ka zhvilluar ndër vite marrëdhënie bashkëpunimi në fusha të ndryshme me interes të ndërsjelltë të palëve, me institucione të ndryshme si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Marrëdhëniet ndërinstitucionale brenda vendit përfshijnë marrëdhëniet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- midis universiteteve publike dhe private;</li> <li>- midis UART-it dhe ministrisë që mbulon arsimin dhe shkencën;</li> <li>- midis UART-it dhe enteve publike që operojnë në fushat që mbulon veprimtaria e UART-it;</li> </ul> <p>Marrëdhëniet ndërinstitucionale me jashtë vendit përfshijnë:</p>

<sup>91</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "UART në Marrëveshjet e Bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus +" ASCAL, Evidenca Nr.2.13. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

"UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Marrëveshje Bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit" ASCAL, Evidenca Nr.2.14. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>– marrëdhëniet midis UART-it dhe institucioneve europiane (dhe jo vetëm) të arsimit të lartë me profil të ngjashëm me UART-in;</p> <p>– marrëdhëniet midis UART-it dhe programeve Erasmus+ apo programeve të ngjashme me to;</p> <p>Marrëveshjet e bashkëpunimit që ka ndërtuar UART-i ndër vite mundësojnë rritjen e mobilitetit si të personelit akademik, ashtu edhe të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Siç është përmendur në RVB, si edhe disa herë më përpara në këtë RVJ, nisur nga natyra e veçantë e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”, është në natyrën e vetë programit mësimor organizimi i shfaqjeve, premierave, shkëmbimeve kulturore, në bashkëpunim me personalitete të shquara të fushës<sup>92</sup> apo me grupe dhe trupa teatrore apo televizive, brenda apo jashtë vendit. UART-i është pjesëmarrës dhe fitues i Projektit ADNICH<sup>93</sup>, me Leader Partner, Teatrin “Zetski Dom” Cetinje, Mal i Zi, si dhe me partnerë italianë Universitetin e Salentos dhe Italian Theatre Institute Lecce si dhe Bashkinë Pogradec. Projekti ka zgjatur 24 muaj.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Siç është përmendur në RVB, për shkak të veçantisë së fushës që mbulon Programi i Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”, organizimi i veprimtarive artistike<sup>94</sup> dhe gjetja e formave dhe mjeteve të reja shprehëse është detyrë e përhershme e studentëve dhe e personelit akademik që mbulon programin e studimit. Në mbështetje të këtyre veprimtarive, FAS-i vendos në dispozicion sallat, ateliet, studio, etj.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” janë të treguara në mënyrë të qartë në Rregulloren e Programit të studimit. Nisur nga veçantia e programeve të studimit që administrojnë UART-i, zhvillimi i</i></p>

<sup>92</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Aktivitetet e përbashkëta të pedagogëve dhe studentëve në 3 vitet e fundit) ASCAL, Evidenca Nr.2.15. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>93</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Informacion mbi aktivitetet e Adnich FAS” ASCAL, Evidenca Nr.4.13. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>94</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Dosja e repertorit të shfaqjeve/filmave të pedagogëve të FAS, studentëve aktualë dhe ish studentëve” ASCAL, Evidenca Nr.3.16. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


	<p><i>aftësive sociale dhe të komunikimit është në natyrën e këtyre programeve.</i></p> <p><i>Në përfundim të procesit mësimor për çdo lëndë të programit të studimit, kompetencat dhe aftësitë e fituara kontrollohen në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë semestrit nisur nga tregues të përcaktuar qartë, si edhe përmes provimit përfundimtar dhe detyrimeve përmbyllëse.</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.5

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Detyrimet përmbyllëse (ndryshe parakushtet për hyrje në provim) janë të përcaktuara në Rregulloren<sup>95</sup> e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi” në nenin 19 të saj. Sipas rregullores, parakushtet për hyrjen në provim konsiderohen kur studenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ka plotësuar kriteret detyruese të vendosura për atë lëndë të parashikuara në planin mësimor;</li> <li>- E lejon grafikun i ndërvarësisë së lëndëve;</li> <li>- Plotëson kushtet që lidhen me frekuentimin e formave mësimore;</li> <li>- Ka mbrojtur detyrimet për praktikën mësimore, punët laboratorike, në se lënda parashikon forma të tilla, brenda afatit të parashikuar në grafikun e detyrimeve, para fillimit të sezonit të provimeve;</li> <li>- Të jetë regjistruar në sekretarinë mësimore për dhënie provimi në sezonin dhe datën përkatëse;</li> <li>- Ka paguar tarifën e shkollimit;</li> </ul>

<sup>95</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në UART është ngritur dhe funksionon Zyra Mësimore &amp; Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, e cila funksionon në bazë të rregullores<sup>96</sup> së saj. Rregullorja ka për qëllim ndjekjen me rigorozitet të zhvillimit të kurrikulave, të informimit të studentëve, zbatimin dhe menaxhimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor. Zyra midis të tjerash:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Jep informacione për programet, kurrikulat si edhe diplomat që ofron UART-I;</li> <li>- Përgatit guida dhe fletëpalosje orientuese për studentët e vitit të pare;</li> <li>- Konsulton studentët diplomantë mbi mundësinë e regjistrimit në Platformën GRADUA, për të patur qasje të lehtë në informacion mbi mundësinë e punësimit apo praktikës profesionale;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në nenin 31 të Rregullores së Programit të Studimit<sup>97</sup> Master i Arteve “Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi”, përcaktohet se provimi i diplomës mund të kryhet me një nga format e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Provim i përgjithshëm përfundimtar;</li> <li>- Mbrojtje artistike e diplomës;</li> <li>- Paraqitje e diplomës me tekst;</li> <li>- Paraqitje e tezës së diplomës me tekst dhe mbrojtje artistike e diplomës/projektit;</li> </ul> <p>Provimi i diplomës përmban paraqitjen teorike të diplomës dhe mbrojtjen artistike të diplomës. Punimi i diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një projekti/programi artistik apo të një studimi me karakter përgjithësues në fushën e programit të studimit që ka kryer. Gjithashtu, punimi i diplomës është i lidhur me disa disiplina të përafërta dhe mund të jetë individual ose kolektiv.</p> <p>Punimi i diplomës mbrohet përpara një komisioni të posaçëm, i përbërë nga pedagogë efektivë dhe të jashtëm, të propozuar</p>

<sup>96</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART ” ASCAL, Evidenca. Nr.6.7. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>97</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	nga Departamenti i RRFTV dhe të miratuar nga Dekani i FAS-it. Mbrojtja e diplomës është publike.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmblyës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	<p>Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit Master i Arteve "Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi", studenti ka të drejtë që të shprehë dëshirën e tij në lidhje me temën/programin e diplomës që kërkon të zhvillojë, udhëheqësin dhe konsulentin e tij.</p> <p>Përgjegjësi i njësisë bazë/departamentit bën propozimin e temave dhe programeve të diplomës dhe të udhëheqësve, të cilat miratohen nga dekani.</p> <p>Udhëheqësi i temës së diplomës midis të tjerash, kryhen këto detyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatit dhe përcakton programin e punës së diplomantit, duke vendosur edhe afatet e përafërta;</li> <li>- Përcakton grafikun e konsultimeve;</li> <li>- Mban shënimet përkatëse në lidhje me ecurinë e studentit në përgatitjen e tezës/mbrojtjes artistike;</li> <li>- Jep mendimin e tij duke deklaruar se volumi i planifikuar i punës është kryer dhe studenti është gati për mbrojtjen e tezës së diplomës dhe më pas të mbrojtjes artistike të saj;</li> </ul>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në rastin e UART i cili gëzon dhe status të veçantë për vetë natyrën e tij artistike - kërkimore dhe shkencore, kjo terminologji nuk gjen aplikim, por duhet theksuar se nga shqyrtimi i dokumentacionit është evidentuar se UART i asiston në mënyrë të vazhdueshme studentët e tij për kryerjen e projekteve artistike të shumëllojshme <sup>98</sup> .
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Siç e parashikon neni 36 i Rregullores <sup>99</sup> së Programit të Studimit Master i Arteve "Regji Filmi & Tv dhe Mësuesi", në përfundim të procesit të provimit të diplomës, kryetari i komisionit mbledh anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të diplomantit. Çdo anëtar i komisionit bën vlerësimin me pikë dhe më pas bëhet mesatarizimi i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit dhe plotësohet procesverbali i provimit

<sup>98</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Dosja e repertorit të shfaqjeve/filmave të pedagogëve të FAS, studentëve aktualë dhe ish studentëve" ASCAL, Evidenca. Nr.3.16. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>99</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi" ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	të diplomës. Vlerësimi i anëtarëve të komisionit dokumentohet dhe i bashkëngjitet procesverbalit të mbrojtjes së diplomave, në të cilin regjistrohet nota përfundimtare dhe dërgohet në sekretarinë mësimore të FAS-it.
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në nenin 37 të Rregullores së Programit të Studimit <sup>100</sup> Master i Arteve “Regji Filmi & Tv dhe Mësuesi” përcaktohet se studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës.
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në RVB e paraqitur nga institucioni tregohet se veprimtaria akademike e UART-it, si edhe çdo veprimtari tjetër e ndryshme nga ajo akademike ruhet në Arkivën e UART-it.  FAS-i ka arkivën e vet në të cilën katalogohet dhe arkivohet i gjithë informacioni i FAS-it për një periudhë 3-vjeçare. Pas kalimit të këtij afati, i gjithë dokumentacioni dërgohet për ruajtje në arkivën qendrore të UART-it.
<b>Konkluzione</b>	<i>Detyrimet përmbyllëse (ndryshe parakushtet për hyrje në provim) janë të përcaktuara në mënyrë të qartë në Rregulloren e Programit të Studimit. Informimi i studentëve sigurohet përmes funksionimit të Zyrës Mësimore &amp; Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI. Provimi i diplomës mund të kryhet me disa forma të veçanta ose të kombinuara dhe i organizuar në mënyra të ndryshme. Tema e diplomës, prej zgjedhjes e deri në dorëzimin e saj, ndiqet nga udhëheqësi ndërsa vlerësimi i diplomës bëhet përpara një komisioni të posaçëm. Në përfundim pas përmbushjes së detyrimeve, studenti pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës.</i>

<sup>100</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi”

ASCAL, Evidenca Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Ashtu siç është përmendur edhe në RVB, UART-i ka mjedise të mjaftueshme të llojit salla, studio, atelier, lektoriume me kapacitete të konsiderueshme. Përveç kësaj, si edhe është përmendur më sipër në këtë RVJ, UART-i ka marrëveshje bashkëpunimi<sup>101</sup> në fusha të ndryshme, me interes të ndërsjelltë të palëve, me shumë institucione dhe institute të fushave të ngjashme me ato që mbulon UART-i, si me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Akademinë e Studimeve Albanologjike;</li> <li>- Arkivin Shtetëror Qëndror të Filmit;</li> <li>- Insitutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;</li> <li>- Qendrën Kombëtare të Kinematografisë;</li> <li>- Teatrin kombëtar të Operas dhe Ansamblin Popullor;</li> <li>- Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë;</li> <li>- Galerinë Kombëtare të Arteve;</li> <li>- Teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”;</li> </ul> <p>Marrëveshjet e bashkëpunimit kanë konsistuar kryesisht në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shkëmbimin e stafit akademik, të kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarive kërkimore-shkencore;</li> <li>- nxitjen e projekteve të përbashkëta;</li> <li>- shkëmbim literature dhe akses në arkiva;</li> <li>- kryerje e internship-eve, stazheve dhe praktikave të studentëve;</li> </ul>

<sup>101</sup>“UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Marrëveshje Bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit” ASCAL, Evidenca Nr.2.14. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Siç argumentohet edhe në RVB<sup>102</sup>, ky kriter ka pak ose aspak lidhje me procesin mësimor që zhvillohet në Programin e Studimit Master i Arteve "Regji Filmi &amp; Tv dhe Mësuesi".</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Praktika mësimore (profesionale) është pjesë e programit lëndor me cilësinë e lëndës plotësuese dhe përfshin 150 orë pune në auditor dhe 75 orë pune individuale dhe vlerësohet me 6 kredite.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UART-i ka mjedise të mjaftueshme të llojeve të ndryshme dhe me kapacitete të konsiderueshme. Përveç kësaj, UART-i ka marrëveshje bashkëpunimi në fusha të ndryshme, me interes të ndërsjelltë të palëve, me shumë institucione dhe institute të fushave të ngjashme me ato që mbulon UART-i. Praktika mësimore (profesionale) është pjesë e programit lëndor me cilësinë e lëndës plotësuese dhe përfshin 150 orë pune në auditor dhe 75 orë pune individuale dhe vlerësohet me 6 kredite.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Suk</b> përbushet</p>	<p><b>Përmbushet</b> pjesërisht</p>	<p><b>Përmbushet</b> kryesisht</p>	<p><b>Përmbushet</b> plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<sup>102</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi & TV dhe Mësuesi" ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Pa përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1								
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.								
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve							
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>Mbështetur në të dhënat e disponueshme, edhe në RVB, por edhe në takimet që u realizuan në Institucion gjatë vizitës dyditore, me të drejtë, Grupi i Ekspertëve konstaton se, stafi i angazhuar në realizimin e këtij programi studimi përmbush kërkesat ligjore, por edhe kërkesat akademike në ofrimin e lëndëve që mbulojnë pedagogët. Grupi ka shqyrtuar edhe CV e pedagogëve të angazhuar në mësimdhënien e lëndëve, sidomos ato me karakter artistik (regjisorë), dhe është dëshmuar se kanë një karrierë artistike të admirueshme. Për vetë specifikën e FAS/UART, si institucioni i vetëm arsimor publik në fushën e artit skenik, pjesa dërrmuese e personelit akademik me kohë të plote, si dhe një pjesë e mirë e atyre me kontratë, janë Alumni të dalë nga po auditorët e FAS/UART. Po e njëjta gjë konstatohet edhe për personelin ndihmës akademik të Departamentit të RRFTV.</p> <p>Bazuar në RVB dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit është:</p>							
	Tituj/grada		2021 - 2022		2020 - 2021		2019- 2020	
			PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr		3	1	3	1	3	1	

Prof.As.Dr	3	-	3	-	3	-
Dr/PhD	5	1	4	1	3	1
Msc	2	4	2	2	2	3
Në total	13	6	12	4	11	5


(Evidencë: tabelat 6.1, 6.2 dhe 6.3e stafit akademik në fund të RVB)

<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas të dhënave të paraqitura në fund të RVB, për programin e studimit, objekt vlerësimi nga GVJ, Master i Arteve në “Regji &amp; Regji Filmi dhe Mësuesi”, ngarkesa e personeli akademik rezulton më e ulta 45 orë mësimore dhe ngarkesa më e lartë 195 orë mësimore. Vlen të theksohet që në të dhënat tabelore janë paraqitur edhe ngarkesa e personelit akademik të brendshëm në Departamente te tjera të FAS, por edhe në Departamente të tjera të fakulteteve të UART, të cilat japin mësim edhe në këtë program studimi. Ngarkesë e këtij stafi është dhënë në total së bashku me orët në programet e tjera të studimit.</p> <p>Ngarkesa e stafit akademik të programit të studimit është në përputhje me VKM Nr 29, datë 10.09.2008, i ndryshuar.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Stabiliteti i stafit akademik vlerësohet si një nga pikat e forta të këtij programi të studimit. Jo vetëm për vitet e fundit, në të cilat shtrihet vlerësimi, por edhe më herët, vërehet që nuk ka pasur lëvizje të stafit akademik. Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore, Grupi i Vlerësimi të Jashtëm, pa kontratat e punës për një personel akademik efektiv dhe për një personel akademik me kontratë, apo me kohë të pjesshme. Me aq sa u pa, kontratat ishin të rregullta dhe të dëshmuar për procesin e rekrutimit dhe përmbajtjes së dosjes. Gjatë vizitës në këtë zyrë u deklarua se Institucioni paguan rregullisht si sigurimet shëndetësore ashtu edhe sigurimet shoqërore.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe</p>	<p>Procedura e rekrutimit të personelit akademik ishte e qartë. Sipas kësaj procedure, hapat që ndiqen për rekrutimin e personelit akademik janë këto<sup>103</sup>:</p>

<sup>103</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Dosja e praktikës së punësimit në FAS/UART ” ASCAL, Evidenca. Nr.5.7. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


<p>specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i RRFTV përgatit kriteret e punësimit për personelin akademik të nevojshëm për lëndën të cilën do të mbulojë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kriteret publikohen në faqen web të UART. Tek kriteret e punësimit është shumë e rëndësishme specifika e lëndës, kritere për të cilat kujdeset direkt Përgjegjësi i Departamentit;</li> <li>- Pas miratimit të kërkesës dhe kriterëve të pranimit, Rektori i Universitetit të Arteve, formulon dokumentin informues;</li> <li>- Dokumenti shpallet publikisht në median e shkruar apo elektronike, si dhe në vende të dukshme të FAS;</li> <li>- Pas dërgimit të dokumentacionit pranë Burimeve Njerëzore në Rektorat, Dekani i FAS krijon komisionin ad hoc për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve;</li> <li>- Komisioni bën vlerësimin dhe renditjen e kandidaturave sipas rezultateve të vlerësimit;</li> <li>- Kandidaturat e renditura sipas pikëve të fituara nga kriteret e përzgjedhjes, i dërgohen Rektorit;</li> <li>- Rektori shpall fituesin sipas renditjes së tyre;</li> <li>- Rektori vendos miratimin përfundimtar për të lidhur kontratën e punës me kandidatin/kandidatët e përzgjedhur;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Struktura administrative dhe ndihmës akademike<sup>104</sup> në FAS përbëhet si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sekretaria e Fakultetit;</li> <li>- Kryesekretarja;</li> <li>- Sekretar/e/i (Specialisti/e) për kurrikulën dhe informimin e studentëve;</li> <li>- Kryetari i Degës së FAS;</li> <li>- Specialistët (laborantët) e laboratorëve të Fakultetit;</li> <li>- Punonjësit e shërbimit;</li> </ul> <p>Grupit iu komunikua se personeli ndihmës akademik dhe një pjesë e personelit administrativ, angazhohen në ndihmë të procesit mësimor nëpërmjet elementeve të tillë si zhvillimi i punëve të laboratorit, në përputhje me programin e studimit, ndjekja e zhvillimit të praktikave mësimore, mirëmbajtja e bazës laboratorike, ndihmesa në zhvillimin e praktikave të</p>

<sup>104</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Lista e stafit ndihmës akademik RRFTV " ASCAL, Evidenca. Nr.5.8. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



	<p>diplomave etj. Për këtë synohet angazhimi i një personeli ndihmës akademik me kualifikim të lartë në fushën përkatëse. Stafi administrativ gjithashtu është trajnuar vazhdimisht për të qenë në koherencë me kërkesat e kohës.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Të gjitha të dhënat e personelit akademik, që lidhen me kualifikimin e tyre, aktivitetin artistik, aktivitetin shkencor mbahen në dosjen personale të tyre, të cilat administrohen nga Burimet Njerëzore. Grupit iu komunikua se stafi akademik udhëzohet që të përditësojë në baza të rregullta dhe në vazhdimësi, CV e tyre, meqë aktiviteti i tyre, sidomos ai artistik është gjithmonë në rritje. Kjo mbështetet në aktivitetet e larmishme që organizon Fakulteti i Artit Skenik më vete, por ashtu edhe në bashkëpunim me Fakultete të tjera të UART. Në kuadër të bashkëpunimit duhet përmendur edhe atë me Fakultetin e Muzikës, vecmas në realizimin e regjive, sipas nevojave dhe kërkesave të programit, por edhe të konceptit të veprave artistike.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë kqyrjes së dosjes së DVV, por edhe gjatë komunikimeve në Institucion sidomos me stafin akademik dhe me Dekanatin e FAS, GVJ iu komunikua se Studentët e Programit të Studimit Master i Arteve në Regji, Regji Filmi dhe TV dhe Mësuesi, duhet të realizojnë praktikat mësimore pranë një institucioni të arsimit parauniversitar, në përputhje me parashikimet e planit mësimor dhe në mbështetje të lëndëve specifike të mësuesisë. Departamenti i RRFTV/FAS nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi<sup>105</sup> me institucionin pranë të cilit do të zhvillohet praktika ose me institucionin qëndror. Në rastet e nënshkrimit të marrëveshjes me institucioni qëndror, veç të tjerash, parashikohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkolla/t pranë të cilave do të kryhet praktika mësimore;</li> <li>- Numri i studentëve për çdo shkollë.</li> </ul> <p>Departamenti i RRFTV/FAS, përcakton një ose disa pedagogë,</p>

<sup>105</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Marrëveshje Bashkëpunimi për Zhvillimin e Praktikës Mësimore për Studentët e UART " ASCAL, Evidenca. Nr.3.3.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


	në varësi të numrit të studentëve për të ndjekur praktikën dhe për të mbajtur kontakt me institucionin pritës.			
<b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Praktika mësimore parashikohet, si pjesë e planeve mësimore dhe përmban një numër kreditesh të caktuara, ndaj studentët e kanë të detyrueshme kryerjen e saj. FAS ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi <sup>106</sup> për kryerjen e praktikave. Marrëveshjet parashikojnë angazhimin e pedagogut, në mbikëqyrjen e praktikës dhe një përfaqësues të institucionit pritës. Institucioni pritës mbikëqyr dhe ndihmon studentin gjatë zhvillimit të praktikës, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar. Në përfundim të praktikës, përfaqësuesi i institucionit pritës, jep vlerësimin e tij për çdo student të mbikëqyrur..			
<b>Konkluzione</b>	<i>Personeli akademik në FAS, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiorë dhe ka kualifikimin e duhur në përputhje me fushën e programit MA në "Regji, Regji filmi dhe Tv dhe Mësuesi". Personeli, po ashtu, në përputhje me marrëveshjen, mbikëqyr realizimin e praktikave të studentëve.</i>			
<b>Shkallë e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin	Në mbështetje të mësimdhënies për Fakultetin e Artit Skenik, pjesë e të cilit është edhe Departamenti i RRFTV, Departament i cili ofron programin e studimit objekt vlerësimi, MA në "Regji, Regji Film & TV dhe Mësuesi", ofrohen ambiente në tre godinat

<sup>106</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Marrëveshje Bashkëpunimi për Zhvillimin e Praktikës Mësimore për Studentët e UART" ASCAL, Evidenca. Nr.3.3.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>e UART. Gjatë vizitës Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i pa këto ambiente dhe vërejtë që ato ofrojnë kushte optimale, gjithnjë edhe me natyrën specifike të programit.</p> <p>Sipas dosjes se DVV, FAS gjendet në godinën D të UART, në një ndërtesë e cila është përfunduar në vitin 1972. Sipërfaqja totale e objektit është 1066 m<sup>2</sup>; nga të cilat 534 m<sup>2</sup> janë sipërfaqe ambiente mësimi; 138 m<sup>2</sup> janë sipërfaqe në funksion të zyrave; 47 m<sup>2</sup> janë sipërfaqe ambienteve ndihmëse për mësim dhe 347 m<sup>2</sup> janë sipërfaqe ambiente shërbimi&amp;komunikimi. Pra, nga të dhënat, shihet që godina është e vjetër, por që ende arrin të ofrojë kushte bazike për studentët e programit përkatës.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Një nga sallat në funksion të aktiviteteve artistike por edhe të shfaqeve në funksion të programit MA në Regji, Regji Filmi &amp; TV dhe Mësuesi është edhe Salla Black Box. Në kuadër të Black Box janë dy salla: Salla e Madhe e Shfaqjeve dhe Salla e Vogël e shfaqjeve. Grupi ka vizituar këto ambiente edhe është njohur me kushtet teknike dhe infrastrukturore të këtyre hapësirave. Këto hapësira përvec shfaqjeve teatrore, shfrytëzohen edhe për shfaqjen e filmave të studentëve të regjisë. Po në këtë ndërtesë janë edhe disa studio në funksion të FAS<sup>107</sup>.</p> <p>Mjediset mbështetëse të programit të Regjisurës, së bashku me infrastrukturën dhe pajisjet që disponojnë, janë gjithmonë në shërbim të realizimit, jo vetëm të procesit mësimor por, edhe të projekteve artistike-kërkimore-shkencore, të cilat e kanë nismën nga trupa pedagogjike, studentët, apo grupe të përbashkëta pedagogësh dhe studentësh.</p> <p>Një pjesë e auditorëve ku realizohet ngarkesa mësimore për Programin e Studimit Master i MA në Regji, Regji Filmi &amp; TV dhe Mësuesi janë të pajisura me aparaturat e teknologjisë së informacionit, të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Për vetë specifikën e programit të studimit mjetet e teknologjisë së informacionit nuk nevojiten për zhvillimin e të gjitha lëndëve (sidomos atyre speciale) dhe për rrjedhojë, Departamenti i RRFTV në bashkëpunim me strukturat e tjera ndihmëse si dhe zv.dekanin dhe sekretarinë mësimore të FAS, në përcaktimin e</p>

<sup>107</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Lista e pajisjeve në shërbim të RRFTV " ASCAL, Evidenca. Nr.5.11. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	auditorëve për lëndë merr parasysh specifikën e vetë lëndës.
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ mbëshetur në RVB, si dhe vizitën në terren, deklaron se, studiot dhe laboratorët e FAS/UART janë të pajisura me aparaturat e nevojshme në funksion të realizimit të objektivave të Programit të Studimit Master i Arteve Regji, Regji Filmi & TV dhe Mësuesi, aparatura të cilat përmbushin kriteret themelore për formimin teorik dhe praktik të objektivave të lëndëve në programin e studimit. Për vetë specifikën e programit të studimit pajisjet dhe aparaturat që përdoren në Departamentin e RRFTV/FAS në shërbim të realizimit të programeve speciale në pjesën më të madhe nuk janë pajisje dhe aparatura konvencionale, siç përdoren rëndom në laboratorë formimi në IAL të tjera. Megjithatë studentëve u ofrohen mundësitë të njihen, prekin e përdorin, fjalën e fundit të teknologjisë në specifikën përkatëse.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Gjatë vizitës në hapësirat e Fakultetit, në Departamentin e RRFTV, u pa se ky Departament zotëron, në ambjentet e tij, edhe laboratorë të pajisur me kompjuterarë dhe programe profesionale që lidhen me fushën specifike të studimit. Por, për vetë specifikën e programit, ofrimi i laboratorëve të teknologjisë së informacionit, nuk është kusht i domosdoshëm, pasi vetë studio dhe klasat mësimore janë laboratorë të mirëfilltë në lëndët artistike, kryesisht Regjisurës, por edhe lëndët tjera ndihmëse për lëndën kryesore, ku përfshihet si bazë e lëndës dhe ndërveprimi fizik midis studentëve të këtij programi studimi, prandaj klasat përkatëse luajnë rolin edhe të laboratorëve, por në këtë rast jo të pajisjeve dhe mjeteve elektronike dhe teknologjisë.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave	Gjatë vizitës, Grupit, iu komunikua se praktikrat e zhvilluara në programet e studimit në Departamentin e RRFTV janë praktika profesionale artistike dhe praktika mësimore. Praktikat profesionale artistike, në përputhje me specifikën e programit të studimit, materializohet në përfitim të përvojave kryesisht skenike dhe artistike, në këtë rast filmike, sipas programit për çdo vit studimi. Këto praktika zhvillohen në ambientet e UART me të gjithë infrastrukturën e nevojshme, ose në institucionet partnere të UART. Këto praktika zhvillohen vetëm përgjatë studimeve të ciklit të parë Bachelor. Në kuadër të Programit të Studimit Master i Arteve në Regji



profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Teatri & Spektakli dhe Mësuesi zhvillohen praktika mësimore. Praktikrat mësimore zhvillohen në marrëveshje me DAR dhe pranë institucioneve të arsimit parauniversitar, në përputhje me Marrëveshjen <sup>108</sup> .			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën për realizimin e procesit mësimdhënies të programit të studimit. Këto mjedise, bashkë me infrastrukturën dhe teknologjinë përcjellëse, ofrojnë mundësi zhvillimi dhe aftësimi praktik të studentëve duke e bërë të mundshme kështu edhe zbatimin e planprogramit mësimor.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe	Literatura bazë dhe ndihmëse, për çdo lëndë të Programit të Studimit Master i Arteve në Regji, Regji Filmi & TV dhe Mësuesi, parashikohet në programin (syllabusin <sup>109</sup> ) e çdo lënde. Po ashtu, literatura bazë dhe ajo ndihmëse për secilën lëndë parashikohet në përputhje me Rregulloren e FAS.Në këtë

<sup>108</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Marrëveshje Bashkëpunimi për Zhvillimin e Praktikës Mësimore për Studentët e UART " ASCAL, Evidenca. Nr.3.3.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


<sup>109</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Programi i Ciklit të dytë të Studimit MA në RFTV dhe Mësuesi" ASCAL, Evidenca. Nr.3.2.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>mënyrë, studentëve iu mundësohet qasja në literaturën e lëndës<sup>110</sup> sipas formave të parashikuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- fizikisht (hard copy) në Bibliotekën e UART;</li> <li>- të shtypur (printuar nga vetë pedagogu), në rastin e leksioneve të hartuara (nëse e parashikon specifika e lëndës);</li> <li>- nëpërmjet paraqitjes së linkut ku mund të gjendet materiali i parashikuar<sup>111</sup>.</li> </ul> <p>Grupi pati mundësinë që t'i bëjë vizitë Bibliotekës së UART, dhe për të parë nga afër fondin e literaturës që posedon kjo Bibliotekë, por edhe mënyrat e shfrytëzimit të literaturës në funksion të studentëve në kuadër të programit të studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik, në programin RRFTV, së bashku me rishikimin e programit të lëndës, nëse ka, pedagogu ka mundësinë e rishikimit dhe përditësimit edhe të literaturës bazë dhe asaj ndihmëse. Për më tepër, Departamenti i RRFTV, nisur nga propozimet e pedagogëve të lëndëve dhe hulumtimet e kryera veçmas parashikon përditësimin e literaturës dhe pasurimin me materiale (libra, artikuj etj) të tjera.</p> <p>Lista e literaturës<sup>112</sup> së detyrueshme është e përcaktuar qartë në Syllabuset e lëndës.</p> <p>Pjesa më e madhe e botimeve të reja ka të bëjë me revista e buletine artistike të vendeve kryesore Evropiane si dhe tituj veprash dramatike e filmike, të cilat janë edhe elementi më i kërkuar nga pedagogët dhe studentët e Departamenti i RRFTV/FAS. Duhet theksuar se në mungesë të një tregu të mirëfilltë për botime të mirëfillta artistike/pedagogjike në gjuhën shqipe, literatura është kushtëzuar të jetë në gjuhët kryesore evropiane, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht. Departamenti i RRFTV ka mundur të sjellë risi në sipërmarrjen e pedagogëve të saj për t'u bërë pjesë e përkthimeve të kolanave</p>

<sup>110</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Listat e literaturës RRFTV në Bibliotekën Shkencore të UART " ASCAL, Evidenca. Nr.5.12.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>111</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Linku i leksioneve të Teknikave të Produksionit skenik. " ASCAL, Evidenca. Nr.5.13. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>112</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Listat e literaturës RRFTV në Bibliotekën Shkencore të UART " ASCAL, Evidenca. Nr.5.12.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>





<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>të klasikëve të mendimit teorik dhe praktik të skenës dhe filmit.</p> <p>Biblioteka e UART është në funksion të të gjithë studentëve që ndjekin studimet, duke përfshirë këtu edhe ata të këtij programi. Grupi kishte rastin të realizojë vizitë në hapësirat e Bibliotekës, me c' rast u konstatua se Biblioteka e Universitetit të Arteve ka në përbërje të saj dy salla (laboratorë) në shërbim të studentëve, salla e Fondit të Hapur dhe salla "Media Library", të pajisura me infrastrukturë rrjeti kompjuterik fizik dhe valor, si dhe me pajisje kompjuterike të cilat përdoren nga studentët e të gjitha profileve të studimit në Universitetin e Arteve, për të tre Fakultetet përfshirë edhe studentët e Programit të Studimit Master i Arteve në Regji, Regji Filmi dhe Tv dhe Mësuesi. Këto salla ofrojnë mundësi unike lehtësuese sidomos për studentët e filmit që, në kuadër të punës së tyre praktike, kreative e artistike, të përdoren edhe për editim jo-linear audio, montazh fotografik, dizajn grafik, dizajn 3 dimensional, editim jo-linear video/ montazh filmik, dizajn inxhinierik, procese office, punë kërkimore shkencore, etj. Në këto salla aksesohen burimet elektronike të vetë Bibliotekës së Arteve, si dhe burime të shumta elektronike online, të cilat i janë mundësuar UART.</p> <p>Biblioteka konsiderohet një ndër pikar më të forta të ofrimit të shërbimit dhe mundësisë së shfrytëzimit të pakufizuar nga studentët e të gjitha drejtimeve, por edhe atyre të filmit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës fizike në hapësirat e Bibliotekës, u vërejt se shërbimet elektronike të Bibliotekës së Universitetit ofrohen për anëtarët e saj përmes dy sistemeve, të cilat janë</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) sistemi i menaxhimit të integruar, përmes të cilit Biblioteka kryen katalogimin dhe administrimin elektronik të fondit fizik të titujve të disponuar, kartelave elektronike, qarkullimin, etj., si edhe kryen shfaqjen përmes shfletuesit publik (OPAC) të titujve për audiencën e gjerë;</li> <li>2) sistemi i arkivit digjital, përmes të cilit përdoruesit kanë mundësi të shfletojnë materialet në trajtën elektronike (digjitale);</li> </ol> <p>FAS/UART, ndjek një politikë të ruajtjes së trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore, nëpërmjet depozitimit në Bibliotekën e UART të materialeve të krijuara ndër vite.</p> <p>Biblioteka e UART i ofron koleksionet dhe shërbimet e saj nëpërmjet ambienteve si salla me fond të hapur (sallë e cila i jep mundësinë përdoruesve të bibliotekës të shfrytëzojnë pa limit</p>


	librin që dëshirojnë dhe duke fotokopjuar atë cka studentët dëshirojnë) dhe fondi i mbyllur (literaturë e artit dramatik si teori drame; punime teorike; përkthime; drama; tregime; romane, revista, CD, etj)
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Salla multimediale e Bibliotekës të UART është me e vecanta dhe tejet e shfrytëzueshme, që pa dyshim, si hapësirë fizike dhe infrastrukturore ofron kushte komode. Shërbimet e shumëllojta që ofron kjo sallë, e cila është e pajisur me teknologjinë e re, ofron tërësisht pa pagesë. Për më shumë, kjo sallë, përveç arkivës digjitale, disponon edhe materiale të tjera audiovizuale në shirita në bobina, pllaka gramafoni, kasete, CD e DVD. Arkiva digjitale e aksesueshme e kësaj salle është krijuar nëpërmjet shfrytëzimit të sistemeve me bazë "kod me burim të hapur". Qëllimi i kësaj arkive është që të ofrojë akses të brendshëm, kombëtar dhe ndërkombëtar për të gjithë audiencën e Bibliotekës së UART.
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Në ambientet e bibliotekës ndodhet "Salla Multimediale", e cila është e pajisur me 20 kompjutera <sup>113</sup> me qasje në internet të pajisur me software specifik në mbështetje të punës studimore në fushën e muzikës, por edhe filmit. Në këto salla mund të punohet me editim jo-linear audio, montazh fotografik, dizajn grafik, dizajn 3 dimensional, editim jo-linear video/ montazh filmik, dizajn inxhinierik, procese office, punë kërkimore shkencore, etj. Pra, kjo sallë, kryen shërbime për studentët e programit të filmit.
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave,	Biblioteka e UART funksionon bazuar në përcaktimet e Statutit <sup>114</sup> të UART Neni 21 dhe rregullores së bibliotekës. Në përputhje me sa më sipër, biblioteka qëndron e hapur duke nisur prej orës 08:00, orë në të cilën nis edhe procesi mësimor, e në vazhdim deri në orët e vona. Në mënyrë të veçantë, përgjatë sezoneve të provimeve, biblioteka e UART, për të plotësuar kërkesat e shtuara të studentëve dhe stafit akademik, punon me orar të zgjatur, bazuar në kërkesat e Fakulteteve të UART,

<sup>113</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Lista e pajisjeve të Bibliotekës së UART " ASCAL, Evidenca Nr.5.16. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>114</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Urdhër të MASR Nr. 319 datë 13.09.2021 "Për miratimin e Statutit të UART". Bashkëngjitur Statuti. " ASCAL, Evidenca. Nr.2.17.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>


numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	prandaj është në dispozicion të studentëve me orar të plotë dhe mjaftueshëm për të tërhequr interesimin e tyre.			
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Grupi vëren se Biblioteka e UART informon rregullisht Njësitë Bazë për mundësitë dhe fondet e vëna në dispozicion të pasurimit të literaturës. Bazuar në njoftimin e bibliotekës, RRFTV paraqet kërkesat e saj për literaturën e nevojshme dhe pasurimin e fondit të bibliotekës në funksion të Programit. Gjithashtu, biblioteka raporton për fondin fizik në dispozicion (tituj, tekste, drama, revista, buletine, filma etj) dhe frekuentimin fizik të ambienteve të bibliotekës sikurse dhe online. Pra, ka një praktikë të mira të informimit për përditësimin dhe pasurimin e fondeve të Bibliotekës të vëna në dispozicion të studentëve të Programit RRFTV.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Grupi konstaton se Programi i studimit RRFT përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar, në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme) ofrojnë mundësi të mira për shfrytëzim nga ana e studentëve. Biblioteka përditësohet dhe pasurohet më fondin e saj të shumëllojtë. Studentët kanë qasje në burime arkivore online, por edhe të shfryrëzojnë Sallën Laborator të Bibliotekës për realizime praktike teknike të projekteve të tyre artistike, pra filmave.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Pa përmbushur</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Sa i përket Menaxhimit të informacionit, që lidhet me aktivitetin e studentit në FAS, Grupi vëren se një gjë e tillë garantohet nga Rregulloret përkatëse, mbi të gjitha nga Rregullorja e Sekretarisë mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni, që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në Sekretarinë mësimore Grupi u njoh me mbajtjen në format letër të Rregjistrimit themeltar, Rregjistrimit të arritjeve akademike, Rregjistrimit të kursit dhe Rregjistrimit të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit/transferimit.</p> <p>Ndërsa, për menaxhimin e informatizuar të informacionit në FAS përdoret sistemi Pitagora, i cili është i bazuar në një platformë online, i qasshëm nga të gjithë studentët, stafi administrativ (sekretaritë) dhe ai akademik i FAS, nëpërmjet një Username-i dhe Fjalëkalimi</p> <p><i>(Evidencë RVB; Vizita në institucion, Evidencë Rregullore Institucionale; Rregullore e Sekretarisë Mësimore)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në UART, veçanërisht në FAS, sistemi i informacionit synon të kontribojnë në menaxhimin si duhet të institucionit. Në këtë synim, sistemi i menaxhimit të informacionit Pitagora, është një sistem i ri, i cili është vënë në funksion në këtë vit akademik. Para këtij Sistemi, UART ishte një nga Institucionet e para e cila përqafoi sistemin elektronik ESSE 3. Edhe pse sistemi i përdorshëm tani, Pitagora, është në përmirësim dhe avancim të vazhdueshëm, GVJ është i mendimit se ky sistem aktual shërben për të menaxhuar mjaftueshëm në tërësinë e vet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e</p>	<p>Gjatë vizitës në FAS, Grupi ka vërejtur se qasja në sistemin Pitagora mundësohet nëpërmjet Sekretarisë Mësimore, e cila ka një hyrje dedikuar studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email</p>



dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	dhe fjalëkalimit të personalizuar. Me anë të këtij sistemi i mundësohet sekretarive mësimore të hedhin online rezultatet e provimeve për studentët, të ndarë sipas grupeve dhe programeve përkatëse dhe ky proces, bazuar në procedurat standard, e mundëson në mënyrë më të lehtë edhe vet administrimin e procesit të provimeve si dhe informimin më të shpejtë dhe më të lehtë të studentëve <sup>115</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Nga të dhënat dhe dëshmitë e ofruara në dispozicion për Grupin, u konstatua se sistemi i integruar PITAGORA është një platformë, e cila siguron këmbimin e informacionit mes studentit, sekretarisë FAS dhe pedagogut. Po ashtu, nëpërmjet këtij sistemi vlerësimi i pedagogut për studentin në një lëndë specifike, pasqyrohet në kohë reale në adresën personale të studentit brenda të njëjtit sistem. Ky sistem, siguron një sërë të dhënash si: - Njoftimin rreth datave të provimeve, vlerësimit të marrë dhe librezën e notave; - Shkarkimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të konsiderohen të nevojshme për studentët; - Njoftimin në kohë reale të notave apo mënyrave të tjera të vlerësimit të studentëve. Procesi i përdorimit të sistemit Pitagora, është bërë më i lehtë edhe me përshkrimet dhe udhëzimet që jepen në Manualin për përdorimin e këtij sistemi <sup>116</sup> .
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për	Referuar RVB <sup>117</sup> , sistemi i menaxhimit në Fakultetin e Arteve Skenike, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrative, dhe u mundëson studentëve informacion mbi vlerësimet, mungesat, provimet etj. Ndërkaq, sistemi prodhon edhe raportime individuale, ose të përgjithshme me të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët e tjere, përkatësisht organet drejtuese të Fakultetit dhe Universitetit. Monitorimi i secilit aktivitet akademik dhe

<sup>115</sup> (Evidencë Vizita në institucion)

<sup>116</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Manuali i përdorimit të sistemit PITAGORA" ASCAL, Evidenca. Nr.5.22. Parë në Tetor 2022, gjendet "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT,

<sup>117</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi" ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

organet dhe autoritetet drejtuese.	administrative në FAS, e mundëson një fushëpamje më të gjerë të shkallës së aktiviteteve dhe cilësisë së tyre.								
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja në internet e UART është e mirorganizuar dhe ofron një informacion të zgjeruar mbi institucionin në përgjithësi si dhe programin e studimit Master i Arteve në “Regji, Regji Filmi&TV dhe Mësuesi”. Gjithashtu, nëpërmjet faqes në internet, mund të gjendet dhe shfrytëzohet informacion i zgjeruar për stafin akademik, pastaj informacion mbi kriteret e pranimit në Fakultet, tarifat e studimit në Universitet, për mënyrën dhe kriteret e përfutimit të bursave të studimit dhe çdo lloj informacioni tjetër, që ka të bëjë me aktivitetet e përditshme të Intitucionit. Po ashtu, me qëllim që të prezantojë më shumë dhe më mirë punën dhe angazhimin e studentëve, në këtë faqe internet të universitetit, ndodhet një seksion i veçantë për studentët, ku gjenden informacione për aktivitetet e tyre të përditshme. Për informacionet e përgjithshme faqja është e qasshme nga çdo përdorues, pa limitime aksesit. Por, disa Informacione në faqen mund të ofrohen edhe në gjuhën angleze, edhe pse jo të gjitha.								
<b>Konkluzione</b>	<i>Grupi konstaton se UART disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Faqja në internet e Universitetit dhe brenda saj e Fakultetit të Arteve Skenike, ofron përmbajtje të zgjeruar informative në gjuhën shqipe dhe pjesërisht edhe në gjuhën angleze.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							


<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Referuar RVB-së, hartimi i Projekt Buxhetit afatmesëm dhe buxhetit të përvitshëm, përpos planifikimit të fondit të pagave për stafin akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar, bazohet në kërkesat e Njesisë Bazë RRFTV.</p> <p>Në kërkesat e paraqitura në funksion të mbështetjes financiare të programeve të studimit në varësi të saj, Njësia Bazë RRFTV përqëndrohet në:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Parashikimin e stafit akademik më kohë të plotë;</li> <li>2. Sigurimin e bazës materiale;</li> <li>3. Parashikimin e mbështetjes së veprimtarisë artistike dhe kërkimit shkencor.</li> </ol> <p>Projektbuxheti, parashikon të gjitha kostot e mbulimit financiar të programit të studimit dhe pasi miratohet në Senatit Akademik dhe Bordin e Administrit, i përcillet për miratim përfundimtar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Kjo procedurë është standarde dhe ndjeket rregullisht në përputhje me rregullat dhe legjislacionin në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e</p>	<p>Gjatë vizitës dhe takimeve me nivelet drejtuese të FAS, Grupit iu komunikua se në hartimin e projektbuxhetit dhe mbështetjen efektive financiare të programit të studimit merren parasysh kërkesat e paraqitura nga Njësia Bazë RRFTV përgjegjëse për Programin e Studimit Master i Arteve në Regji, Regji Filmi &amp; TV dhe Mësuesi. Sipas praktikës së përvitshme, përpara fillimit të çdo viti akademik, Njësia Bazë paraqet kërkesën për stafin akademik me kohë të plotë dhe atë me kohë të pjesëshme. Në bazë të rregullave dhe legjislacionin në fuqi, financimi i stafit akademik me kohë të plotë sigurohet nga buxheti i shtetit, ndërkohë që stafi akademik me kohë të pjesëshme mbulohet financiarisht nga të ardhurat e vetë institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të jashtëm, deklaron se UART, për periudhën, në të cilën shtrihet edhe vlerësimi i programit në kuadër të akreditimit, nuk i është nënshtruar ndonjë auditimi financiar, as të rregullt e as periodik.</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Sipas komunikimeve me palët përgjegjëse, Grupi u vua në dijeni se Drejtoria Ekonomike e UART paraqet çdo vit analizën (raportin) për veprimtarinë ekonomike të institucionit<sup>118</sup>. Në këtë analizë vjetore zënë vend raportimi mbi realizimet e zërave sipas parashikimeve të bëra në projekt buxhet dhe realizimeve konkrete të tyre. Zërat në raport përfshijnë: investimet, fondin e pagave, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, mallrat dhe shërbimet e tjera, transferimet korrente për jashtë, ndihmë për individët dhe bursa. Çdo zë paraqitet me peshën specifike në buxhetin total të vitit. Po e njëjta procedurë ndiqet edhe për realizimin e buxhetit për vitin në fjalë. Më pas vijon paraqitja e realizimit të buxhetit sipas zërave dhe bazuar në burimet e financimit për çdo zë. Në finale çdo zë zbërthehet në nënzërat përkatës edhe me detajimin e përqindjeve specifike të realizimit sipas projektbuxhetit. Ky raport kalon më pas për miratim në Senatën Akademik të UART sipas parashikimeve të ligjit. Pra, në këtë provë raportimi financiar, ndiqet një procedurë e përcaktuar qartë, sipas ligjeve në fuqi që mundëson një mbikëqyrje dhe vlerësim të menaxhimit financiar.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në bashkëbisedim me strukturat drejtuese të FAS, Grupit iu komunikua se deri më tani institucioni nuk ka pasur nevojë të ndërhyjë në përmirësimin e situatës financiare. Gjithësesi Grupi u informua se Departamenti i RRFTV/FAS, në përmbushje të misionit për të ofruar një mësimdhënie sa më cilësore si në kushte e në mjete moderne të teknologjisë, ka apikuar me projekte, të cilat do të ishin një burim shtesë të ardhurash në të ardhmen e afërt.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se UART garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e</i></p>

<sup>118</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Raportimi vjetor për realizimin e buxhetit në UART" ASCAL, Evidenca, Nr.5.31. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,



	<p>programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. GVJ u interesua pse UART nuk zhvillon auditim dhe përgjigja ishte se UART nuk plotëson kushtet për të patur një Strukturë të Auditimit të brendshëm, mbështetur në VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në Sektorin publik", pika 1, b. - Njësitë e auditimit krijohen në çdo institucion tjetër që kryen funksione publike, shoqëri tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, si dhe njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike sipas një marrëveshje ndërkombëtare, të cilat kanë në vit, njëkohësisht jo më pak se 400.000.000 (katërqind milionë) lekë të ardhura financiare dhe 300 punonjës, përgjatë 3 (tri) viteve të fundit të veprimtarisë së tyre, me përjashtim të rasteve kur ngritja e njësisë së auditimit të brendshëm parashikohet nga një ligj i veçantë.</p> <p>Megjithatë, UART raporton në mënyrë periodike në MASR pasqyrat vjetore financiare sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>X</b>
--	-----------------------------	----------------------------	-----------------------------	----------

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

75



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit si dhe vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, vëren se Univesiteti i Arteve, ka të hartuara një sërë dokumentash rregullativë, që mbulojnë të drejtat, obligimet dhe detyrimet e studentëve, që nga hyrja e tyre dhe deri në momentin e daljes. Gjithashtu, ky institucion ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura standard, mbi të cilat mbështetet cikli i plotë i programit të studimit. Këto procedura bazohen në dokumentet e mëposhtme:</p> <p>Statuti i UART<sup>119</sup>;</p> <p>Rregullorja e Institucionit;</p> <p>Rregullorja e Fakultetit të Artit Skenik<sup>120</sup>;</p> <p>Rregullorja e Departamentit të RRFTV<sup>121</sup>;</p> <p>Rregullorja e Ciklit të Dytë të studimeve<sup>122</sup>;</p> <p>Rregullorja e programit të Studimit Master i Regjisë, në “Regji, Regji Filmi &amp; TV dhe Mësuesi<sup>123</sup>”</p> <p>Rregullorja e Sekretarisë Mësimore, etj.</p> <p>Të gjitha Rregulloret e mësipërme, janë të mbështeturra në Ligjin e Arimit të Lartë dhe Akteve nënligjore në fuqi si dhe janë të miratuara me Vendim të Senatit Akademik. Gjithashtu ky institucion gëzon Statusin e veçantë që në muajin mars të vitit 2021 sipas VKM Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë UART si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë</p>	<p>Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë për të gjithë kandidatët. Këto politika janë adresuar edhe në RVB, të cilat, si të tilla, janë të normuara edhe në Rregulloren e</p>

<sup>119</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Urdhër të MASR Nr. 319 datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të UART”.

Bashkëngjitur Statuti.” ASCAL, Evidenca. Nr.1.15.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>120</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e FAS” ASCAL, Evidenca. Nr.2.3. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<sup>121</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Departamentit RRFTV” ASCAL, Evidenca. Nr.2.4.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>122</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART.” ASCAL, Evidenca. Nr.2.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>123</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi” ASCAL, Evidenca. Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

Adresa: “Rruga e Durrësit”


Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

76





<p>kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>FAS<sup>124</sup>. Të gjitha këto politika, burojnë dhe ndërlidhen edhe me vizionin e përgjithshëm të UART, si dhe paradigmës që ky institucion ka për të ofruar mundësi të barabarta për të gjithë për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Në proces të shqyrtimit të RVB, dhe takimeve të shumta gjatë vizitave, Grupi veneroi se zhvillimi i procedurës së pranimit të studentëve të rinj në FAS, përkatësisht në PRRFTV, realizohet përmes konkursit publik. Detajet e procedurës së pranimit, por edhe kushtet dhe kriteret e pranimit të kandidatëve, janë të specifikuar mirë në Rregulloren e FAS, dhe si të tilla këto rregulla, procedura dhe kritere, ofrojnë mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët potencialë, duke garantuar një proces të rregullt, të miradministruar dhe jodiskriminues.</p> <p>Përtej, rregullave dhe procedurave që përmban Rregullorja e FAS<sup>125</sup>, kandidatët potencialë, dhe të gjithë të interesuarit e tjerë, kanë mundësi, që paraprakisht, ta marrin këtë informacion të mjaftueshëm, për kohën e shpalljes, procedurat e aplikimit dhe kriteret e pranimit, si në faqen e ueb të UART, ashtu edhe në Sekretarinë Mësimore të Fakultetit, por edhe nga përgjigjet që jep Sektori Mësimor nëpërmjet email, ose në inbox të faqeve sociale si Facebook, Instagram.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Të gjitha procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve, zhvillimit të tyre akademik, por edhe në rastet e transferimeve, në Programin Master në Regji, Filmi&amp;Tv dhe Mësuesi, janë të përcaktuara me Rregulloret në fuqi, të cilat janë edhe të publikuara dhe të qasshme online, për studentët, por edhe palët tjera të interesuara. Rregullorja e Programit të Studimeve Master në Regji, Regji Filmi&amp;TV<sup>126</sup>, përmes neneve të saj, përcakton qartë të gjitha procedurat, të cilat lidhen me hapat administrativë, kriteret e pranimi, kushtet dhe procedurat e zhvillimit akademik, por edhe të transferimit të studentëve në këtë program. Kjo rregullore, dhe të tjera, të rëndësishme së veçantë, janë të qasshme për publikun. Po ashtu, informacionet</p>

<sup>124</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "VSA Nr. 20 dt. 07.10.2021 "Mbi miratimin e Rregullores së UART" " ASCAL, Evidenca. Nr.2.7. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>125</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e FAS" ASCAL, Evidenca. Nr.2.3. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>126</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi" ASCAL, Evidenca. Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

	relevante për studentë jepen edhe në faqen kryesore në internet, por edhe në rrjetet tjera sociale, që tashmë kanë përdorim të gjerë gjithandej.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, UART në përgjithësi por FAS në veçanti si Njësia kryesore e ofrimit të këtij programi studimi, informon të interesuarit në lidhje me kërkeat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, të cilat bëhen publike për audiencën e interesuar, përkatësisht kandidatët potencialë në:</p> <p>a) në faqen web të Fakultetit;</p> <p>b) në ambientet e përcaktuara pranë FAS.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, Grupit iu konfirmua se në kuadër të mbështetjes sa më të gjerë se informimit të publikut si dhe kandidatëve të mundshëm, institucioni organizon përpara fillimit të çdo viti akademik, takime të hapura të stafit akademik me kandidatët e interesuar për të ndjekur programet Master, duke u shpjeguar kriteret, procedurat, tarifat dhe mundësitë e regjistrimit në programet që të interesuarit shfaqin interes, mundësitë e mobiliteteve etj.</p> <p>Gjatë këtyre takimeve paraprake, kandidatët potencialë njihen edhe me pjesën programore të studimeve, por edhe mundësitë që jep ky Program studimor, qoftë në mobilitet po ashtu edhe në angazhimet që do të kenë kandidatët e pranuar. Po ashtu, Grupi, gjatë bashkëbisedimit me studentë aktualë, por edhe me profesorë e drejtues të FAS, vërejti se tashmë është ndërtuar në praktikë që studentët, që ndjekin studimet e cilit të parë bachelor, janë pothuajse të gjithë të interesuar të ndjekin edhe studimet e cilit të dytë Master. Të gjitha këto aktivitete të informimit sa më të gjerë, derivojnë dhe nga Rregulloret<sup>127</sup> dhe Vendimet<sup>128</sup> në fuqi mbi të cilat organizohet dhe vepron Programi.</p>
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, në process të vlerësimit të dokumentacionit dhe takimeve gjatë vizitës, vërejtje se në Programin Master në në RRFTV/FAS nuk parashikohen kuota

<sup>127</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART." ASCAL, Evidenca. Nr.2.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sg>,

<sup>128</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "VSA Nr. 18 dt. 07.02.2020 "Mbi miratimin e Rregulloreve, Krieteve për zhvillimin e konkursit për vitin akademik 2021-2022 FAS" ASCAL, Evidenca. Nr.3.7. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sg>,

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

78

<p>për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>të veçanta, për studentët me aftësi të kufizuara. Me aq sa u tha dhe u arsyetua, kjo vjen edhe si pasojë e specifikës së vetë programit të studimit. Një argument shtesë u paraqit se janë Kurrikulat e lëndëve speciale ato që kërkojnë fizikalitet të lartë brenda dhe jashtë skenës. Pra, në Programin në process të akreditimit, nuk ka kuota të rezervuara për personat me nevoja të veçanta. Rrjedhimisht, ata mund të konkurrojnë dhe t'i nënshtrohen kritereve të vlerësimit të mënyrë të barabartë.</p> <p>Për dallim për mungesën e kuotave për kandidatët me nevoja të veçanta, FAS ka bërë një hap të rëndësishëm, në zbatim të VKM<sup>129</sup> për përjashtimin e nga pagesa të studentëve që vijnë nga përkatësitë etnike minoritare; Romë/Ballkano – Egjiptianë.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të studimit, të drejtën e konkurrimit e kanë edhe kandidatët që kanë një diploma të një vendi të huaj e cila është ekuivalente sipas legjislacionit në fuqi. Pra, kandidatët nga vendet tjera (shtetas të huaj), të cilëve iu njihen diplomat, mund të ndjekin mësimet në Programin Master në RRFTV dhe Mësuesi. Kriteret e pranimit për këta kandidatë janë të hartuara dhe ata i nënshtrohen procedurave sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi. Gjatë vizitës në institucion dhe bashkëbisedimit me akterë kryesorë, u vërejt që edhe përkundër interesimit, numri i studentëve të shteteve të huaja nuk është i madh, edhe për vetë faktin, që një ndër kushtet dhe kriteret për studentët e huaj është edhe dëshmia për njohjen e gjuhës shqipe, si gjuhë e vetme, në të cilën zhvillohet mësimi në këtë program. Përjashtim këtu bëjnë studentët e etnisë shqiptare, por që jetojnë dhe kanë nënshtetësi të vendeve tjera, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi, dhe Serbi. Ngjajshëm si me rastet tjera, edhe më këtë rast, Institucioni publikon me kohë të gjitha procedurat dhe kriteret për pranimin e studentëve të huaj që janë të interesuar për studime në këtë program.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në</p>	<p>Për të stimuluar interesimin për vazhdimin e studimeve në këtë program, Institucioni, përkatësisht FAS, ndjekë një politikë mbështetëse për kategoritë në nevojë përmes ofrimit të lehtësimeve në pagesa shkollimi dhe bursave universitare. Në</p>

<sup>129</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "VKM Nr. 251 dt. 27.03.2020 për një ndryshim në VKM Nr. 269 dt. 29.03.2017 për përjashtimin nga pagesa të studentëve; Romë/Ballkano – Egjiptianë." ASCAL, Evidenca. Nr.3.9. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<p>programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>kuadër të këtyre politikave stimuluese dhe mbështetëse për rastet sociale vëmendje i kushtohen sidomos studentët që vijnë nga shtresa sociale e komuniteteve “Rome/Balkano-Egjiptiane”<sup>130</sup>.</p> <p>Në rastet të tilla, Universiteti i Arteve zbaton anën ligjore dhe nënligjore, procedurën për pranimin e dokumentacionit, për secilin aplikues sipas kategorive, dhe miraton përfituesit.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Si përfundim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, konstaton se FAS si dhe Departamenti përgjegjës për ofrimin e programit të studimit MA në “Regji, Regji Filmi &amp; TV dhe Mësuesi”, ka të hartuara politika dhe procedura për pranimin e studentëve, të cilat nga viti në vit i ndjek dhe i zbaton me rigorozitet. Grupi vërejt se këto procedura, që nga pranimi deri në diplomim, janë të kodifikuara në Rregullore dhe Vendime përkatëse, të cilat janë të qasshme për kandidatët potencialë por edhe për palët tjera të interesuara. Po ashtu, FAS ka hartuar dhe zbaton politika stimuluese për studentët me asistencë sociale, posaçërisht, atyre që vijnë nga komunitetet minoritare.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Në</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe</p>	<p>Grupi, në bazë të dokumentacionit të ofruar, konfirmon se kriteret dhe procedurat e kalimit të studentëve nga njëri vit akademik në tjetrin janë të rregulluara sipas Rregullores së programit të studimit MA në “Regji, Regji &amp; TV dhe</p>

<sup>130</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “VKM Nr. 251 dt. 27.03.2020 për një ndryshim në VKM Nr. 269 dt. 29.03.2017 për përjashtimin nga pagesa të studentëve; Romë/Balkano – Egjiptianë.” ASCAL, Evidenca. Nr.3.9. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,






<p>kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Mësuesi<sup>131</sup> dhe Rregullores se FAS<sup>132</sup>. Në mes tjerash; në këtë Rregulore janë të përcaktuara të drejtat dhe detyrat e studentëve, zhvillimi i provimeve, e drejta për të hyrë në provim, kriteret dhe procedura të vlerësimit, dokumentimi i vlerësimeve, komunikimi i vlerësimeve, transferimi i studimeve, ndërprerja dhe rifillimi i studimeve, etj.</p> <p>Gjithashtu Grupi i Vlerësimit, u vu në dijeni se përmes Sekretarisë Mësimore, faqes së web-it të UART dhe sistemit PITAGORA, jepet informacion i mjaftueshëm për përparimin akademik të studentëve dhe kalimin e tyre nga një vit në një tjetër. Pra, përmes një aktiviteti të gjithanshëm të komunikimit, informimit dhe publikimit, studentët e këtij programi informohen në detaje lidhur me vlerësimet për secilën lëndë të zhvilluar gjatë gjithë vitit akademik; për numrin e krediteve të akumuluar; për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin, etj. Prandaj, marrë për bazë këtë, numri i ankesave sa i përket informimit për zhvillimin akademik, dhe kalimin e vitit, janë të pakta.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Grupi konstaton se mbështetur në Rregulloren e programit të studimit MA<sup>133</sup>, kriter bazë për pranimin në studimet e këtij programi studimi, është studimi i plotë i programit Bachelor në Regji dhe kriteret e tjera që përcaktohen qartë në rregulloren e UART.</p> <p>Në konkursin e rregullt, që bëhet publik paraprakisht, jepen edhe kushtet dhe kriteret edhe për studentët që kanë një diplomë "Bachelor" të një vendi të huaj e cila është ekuivalente sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Pra, grupi vëren se informimi mbi kushtet edhe kriteret edhe të kandidatëve që kanë një diplomë të huaj, por që i plotësojnë kushtet sipas rregullave në fuqi, bëhet me kohë dhe në mënyre transparente për të gjithë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje</p>	<p>Siç rezulton nga vizita në Institucion dhe bashkëbisedimi me aktorët kryesorë, Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Artit</p>



<sup>131</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi " ASCAL, Evidenca. Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>132</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e FAS" ASCAL, Evidenca. Nr.2.3. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>133</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART. " ASCAL, Evidenca. Nr.2.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,




<p>me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Skenik (FAS) i informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Po ashtu, pedagogët e lëndës, për secilin program studimi, kanë përfshirë vlerësimin e studentit, peshën që zë vlerësimi sipas komponentëve si dhe shpërndarjen e komponentëve të vlerësimit.</p> <p>Mes tjerash, Grupi u vua në dijeni se në FAS, për shkak të specifikave të Programit, i cili është subjekt vlerësimi, mësimdhënia është e organizuar në mënyrë individuale për lëndët speciale dhe në grupe të vogla (ose të mëdha) për lëndët artistike/lëndët e formimit bazë.</p> <p>Meqë raporti pedagog-student, për shkak të natyrës specifike të mësimdhënies dhe mësimnxënies, është më interaktiv, pedagogët e Programit në mënyrë individuale kryejnë informimin e studentëve lidhur me procesin mësimor, programin lëndor, sezonin e provimeve, sistemin e vlerësimit dhe detyrimet vjetore që ka studenti në lidhje me programin/fushën specifike ku ai/ajo studion.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Realizimi dhe mbrojtja e temës së diplomës, si në aspektin teorik, po ashtu edhe në aspektin praktik, përbën një proces dhe hap shumë të rëndësishëm në FAS, e sidomos në Programin Master në RRFTV. Sipas përcaktimeve rregullative të planit mësimor, realizimit të temës së diplomës i janë rezervuar 20 kredite ECTS, nga të cilat tema (pjesa) teorike ka 4 kredite dhe Projekti artistik ka 16 kredite. Pra, është një kombinim i krediteve të pjesës artistike me atë teorike. Sipas këtyre krediteve Projekti artistik, në proces të vlerësimit, ka peshën më të madhe për nga numri i krediteve të kërkuara.</p> <p>Departamenti i RRFTV në mënyrë të vazhdueshmë, i mban të informuar studentët për kriteret dhe procedurat e realizimit dhe mbrojtjes së temës së diplomës. Si rezultat i këtyre komunikimeve me administratën dhe personat përgjegjës, por edhe punës interaktive dhe të vazhdueshmë me profesorët e lëndëve përkatëse, studentët marrin informacione të hollësishme për të gjithë hapat proceduralë, kohën dhe afatet e realizimit të temës së diplomës. Në kuadër të rregullave dhe ligjeve në fuqi, studentët vihen në dijeni edhe për politikat e antiplagjiaturës dhe të drejtave të autorit, të cilave duhet t’iu</p>

	nënshtrohen veprat e tyre të diplomës, si në aspektin teorik, po ashtu edhe në atë praktik.			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Grupit të Vlerësimit gjatë vizitës në Institucioniu sqarua mnyra se si funksionon UART në përgjithësi dhe FAS dhe Departamenti i RRFTV në veçanti, për mënyrën sesi ky institucion mundohet të tërheqë sa më shumë kandidatë për studentë në programet që ofron.  Tashmë, UART ka ngritur struktura të veçanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve të rinj. Faqja zyrtare <a href="http://www.uart.edu.al">www.uart.edu.al</a> , panairët e organizuara nga MAS, si dhe faqja më e re e informimit matura shtetërore, në portalin U-Albania, japin informacionin e duhur ku në kohë reale kandidatët pyesin dhe marrin përgjigje për secilën problematikë të ngritur prej tyre. Po ashtu përmes këtyre faqeve jepen edhe informacione shitesë, edhe për nivelin e Studimeve Master, për të gjithë të interesuarit brenda dhe jashtë vendit. Meqë jetojmë në një epokë digjitale për një informacion edhe më të madh, Universiteti dhe FAS kanë zgjedhur të përdorin edhe rrjetet e njohura sociale Facebook, LinkedIn, Google+, Youtube, Instagram.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Grupi, në lidhje me kriteret e këtij standardi, konstaton se UART në përgjithësi dhe FAS dhe Departamenti i RRFTV në veçanti, vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm, elektronik dhe fizik, mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit të tyre. Po ashtu, FAS përdor të gjithë onfrastrukturën e nevojshme elektronike dhe digjitale për të përditësuar të dhënat dhe për të shpërndarë sa më shpejtë dhe sa më lehtë informacionet e nevojshme, jo vetëm për studentët aktualë, por edhe për ata potencialë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, Grupi u informua nga afër për faktin se studentët janë të mirinformuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Në takim me studentët u informuam se ata, përvec shfrytëzimit të informacioneve elektronike, informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën në funksion të realizimit të tij. Pra, burimi elektronik i informacionit të hapur, mbështetet dhe plotësohet edhe me informacionet, që marrin studentët, qysh në javën e parë të fillimit të studimeve. Informacione plotësuese jepen edhe gjatë prezantimit të syllabuseve të lëndëve, detyrimeve përkatëse, mënyrës së shlyerjes së tyre dhe infrastrukturës në dispozicion të studentëve. Pra, në bazë të këtyre informacioneve studentët e kanë më të qartë natyrën e programit të studimeve të tyre, kushteve që ofrohen, por edhe detyrimeve dhe obligimeve që kanë ata<sup>134</sup>. Informacioni në lidhje me këta elementë shpërmdahet edhe përmes sekretarisë mësimore e cila luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve, notat etj<sup>135</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Grupi, gjatë vizitës në institucion dhe takimeve shumëpalëshe, konstatoi se një burim i rëndësishëm informacioni për studentët përveç informimit të tyre nga pedagogu i lëndës në lidhje me modulet, lëndët, veprimtaritë formuese të programit, etj është edhe faja e UAR www.uar.edu .al, Në këtë faqe, studentët, profesorët, por edhe të gjithë të interesuarit tjerë, mund të aksesojnë të gjithë informacionin që dëshirojnë rreth programit të studimit, nëpërmjet kësaj faqeje.</p> <p>Po ashtu nga vizita dhe nga RVB, kuptojmë që për komunikimin në kuadër të realizimit të procesit mësimor për programin e studimit përdoret edhe Sistemi Pitagora, system i cili është bërë i mundur të aplikohet nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH) për</p>

<sup>134</sup> Takime në institucion.

<sup>135</sup> Takim në Sekretarinë Mësimore.

	të gjithë Institucionet e Arsimit të Lartë public që kanë dashur të jenë pjesë e këtij Sistemi. <sup>136</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Referuar RVB <sup>137</sup> , programet dhe riorganizimi i tyre, janë të përshtatshme për t'iu përgjigjur tregut të punës. Këtij qëllimi i ka shërbyer Urdhëri i MASR Nr. 821, datë 26.12.2018 dhe Nr. 512, datë 24.10.2019. si dhe zbatimi i Udhëzimit të MASR Nr.52, dt.03.12.2015, i ndryshuar për gjuhët e huaja. Siç dëshmohet edhe në dokumentacionin e ofruar, por edhe gjatë vizitës, studentët e UART janë të përfshirë në jetën artistike kulturore të vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte dhe ngjarje të ndryshme artistike, që iu hapin atyre mundësi të shumta të punësimit. . Ky bashkëpunim është rritur edhe mëtej nëpërmjet marrëveshjeve që UART ka realizuar me institucionet kulturore artistike në kuadër inisiativës “Paktit për Universitetin”. Studentët e Master në RRFTV dhe Mësuesi, njihen dhe informohen vazhdimisht për mundësitë e punësimit në të ardhmen, jo vetëm në institucione shtetërore por edhe në ato private, veçanërisht në fushën e Televizionit dhe produksioneve të ndryshme, si dhe mundësisë që ofron Qendra Kombëtare e Filmit për të aplikuar për fonde për filma të kategorive të ndryshme.
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Është evidente se studentët e programit Master në RRFTV dhe Mësuesi, gjatë zhvillimit të studimeve, informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.  Po ashtu, elementë të tjerë si orari i mësimave, struktura e vitit akademik, formularë të ndryshëm, modele të testimeve/provimeve që përdoren në institucion, aplikime për bursë, mund të qasen dhe të jenë në përdorim në ambjentet e hapura në Fakultetin e Artit Skenik, po ashtu edhe nëpërmjet faqes ëeb të institucionit. Për gjithë këtë punë të informimit, pashmangshëm, një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan dhe Sekretaria Mësimore e FAS.

<sup>136</sup> Vizita ne institucion dhe RVB: “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi” ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>137</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi” ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

85

**Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.

I tërë informacioni për programet e studimit në UAR, e po ashtu edhe në FAS, është publik dhe i qasshëm prej kujtdo qoftë në çdo moment në faqen e internetit, nga çdo pajisje dhe nga çdo vend i mundshëm. Kjo mundësohet falë zhvillimit të teknologjisë dhe komunikimit digjital. Prandaj, Grupi ka vërejtur që edhe Studentët e Programit të Studimit Master i RRFTV dhe he Mësuesi, qasen dhe e shfrytëzojnë sistemin Pitagora përmes qasjes që ata kanë në emailin e tyre. Nga ky system atyre iu bëhet e mundur që të marrin informacion për ecurinë në programin e studimit në çdo kohe dhe nga çdo vend. Kjo qasja është elektronike dhe studenti mund ta përdori sistemin për të gjitha nevojat e tij/saj studimore, nga të gjitha formatet elektronike, qofshin ato smartphone, tablet, PC, etj

Gjithashtu, studentët nga ana e pedagogëve përkatës, në fillim të çdo semestri, njihen me të gjithë programet lëndore (syllabuset), ku jepen atyre në detaje detyrimet e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar.

**Konkluzione**

*Gjatë vlerësimit të kriterëve të këtij standardi, Grupi është i një mendimin dhe konstaton se FAS, në programin Master në RRFTV dhe Mësuesi, ka vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit të tyre. Këto informacione bëhen edhe më të hollësishme, më lehtë të qashshme dhe më të përdorueshme edhe në saje të shfryrëzimit të Sistemit të komunikimit të brendshëm, por edhe faqes së Universitetit në Internet, por edhe në bazë të komunikimit të vazhdueshëm me administratën dhe pedagogët përkatës.*

**Shkalla e përmbushjes së standardit**

Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X



**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Administrata e FAS, e sidomos ajo e Programit që është në proces akreditimi, ka të rregulluar dhe mirëmenaxhuar procesin e evidentimit, dhe ruajtjes së statistikave të studentëve si ata që ndjekin programin e studimit por edhe të atyre studentëve që tashmë janë diplomuar. Rolin më të rëndësishëm në këtë strukturë administrative për këtë proces e luan Sekretaria Mësimore e FAS, e cila funksionon mbi bazën e detyrave të përcaktuara në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore<sup>138</sup>.</p> <p>Në vizitë dhe në bashkëbisedim me Sekretarinë mësimore Grupi u njoh me mbajtjen në format letër të Rregjistrit themeltar, Rregjistrin të arritjeve akademike, Rregjistrin të kursit dhe Rregjistrin të diplomave të studentëve si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit apo edhe të transferimit. Siç na u kumtua, regjistri i statistikave të studentëve mbahet edhe në Sektoirin e Statistikave, pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në UART.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Në FAS statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve mbahen nga Sekretaria Mësimore sipas Rregullores së saj<sup>139</sup>. Të dhënat ruhen në rregjistra përkatës dhe në formë elektronike. Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore Grupi u njoh me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit Master i Arteve në RRFTV dhe Mësuiesi. Ky regjistër përmban numrin e studentëve, të regjistruar, atyre që janë aktiv, të larguarve, të transferuarve dhe gjithsesi atyre që kanë diplomuar në këtë Program. Tabela statistikore me të dhënat për numrin e</p>

<sup>138</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FAS " ASCAL, Evidenca Nr.5.19. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>139</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FAS " ASCAL, Evidenca Nr.5.19. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

	<p>studentëve, është dhënë në mënyrë të saktë edhe në RVB e Programit<sup>140</sup>.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti gjatë takimit me sekretarinë mësimore, u verifikua regjistri themeltar i studentëve për këtë program studimi nga ku rezulton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- V.A. 2020-2021 6 student regjistruar;</li> <li>- V.A. 2021-2022 7 student regjistruar;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion dhe prezentimit të dokumentacionit përkatës relevant<sup>141</sup>, Grupi vërejti se Sekretaria Mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna statistikore, disponohen në format letër (në rregjistrat përkatës) si dhe në në Sistemin e Pitagora, ku stafi akademik hedh të dhënat dhe ndjek ecurinë e studentëve përgjatë vitit akademik, po ashtu edhe vetë studentët mund të ndjekin ecurinë e tyre, si dhe të informohen për mungesat, vlerësimet, etj., përmes këtij sistemi. Në këtë mënyre menaxhimi i informacionit është ndërtuar mbi një sistem efikas (fizik dhe elektronik) duke bërë të mundur dhe të sigurt evidentimin e saktë, posedimin dhe ruajtjen e këtyre regjistrave të studentëve dhe zhvillimit të tyre akademik e profesional.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me</p>	<p>Me Vendim të Senatit Akademik Nr 21, datë 07.10.2021, në Universitetin e Arteve, është miratuar Rregullorja e Sektorit Mësimor<sup>142</sup>, e cila përcakton se është ky sektor që kryen kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> <p>Gjatë takimit me këtë Sektor, Grupi u informua se ky sektor kryen herë pas here kontrole në përfundim të vitit akademik, në Sekretaritë mësimore duke vëzhguar nga afër regjistrat e arritjeve akademike (regjistri i notave) dhe duke krahasuar një</p>

<sup>140</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi" ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>141</sup> Vizite ne Institucion dhe RVB: "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi" ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>142</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART " ASCAL, Evidenca. Nr.6.7. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë


Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



veprimtarinë e tyre përkatëse.	sistem të rastësishëm se se si janë hedhur notat në këtë regjistër nga stafi i sekretarisë. Është fakt, që gjatë vizitës dhe kontrollit fizik të regjistrave në Programin Master i Arteve në RRFTV dhe Mësuesi, nuk është vërejtur asnjë problem serioz në keq hedhjen e notave apo edhe të ndryshimit të tyre dhe më këtë kuptojmë dhe besojmë se ky sistem i kontrollit tregon për një strukturë efektive të menaxhimit të informimit të brendshëm dhe kontrollit efikas që ka ndërtuar institucioni.
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Gjatë takimeve në Institucion, Grupi u takua me përgjegjës të Departamentit të RRFTV, i cili bëri një pasqyrim në lidhje me punën e tij por edhe me mbarëvajtjen e këtij Departamenti. Po sipas Përgjegjësit të Departamentit, realizohet për çdo vit akademik një Raport analitik <sup>143</sup> , kur prezanton cilësinë e studentëve, rezultatet e arritura prej tyre, si dhe realizimin e objektivave të Departamentit për këtë program studimi. Në këtë Raport paraqitet dhe pasqyrohet në formë të përmbledhur informacione, analiza dhe gjetje në lidhje me aspekte të ndryshme të veprimtarisë akademike në Departamentin e RRFTV. Pjesë e analizës vjetore janë edhe sugjerimet dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e këtyre treguesve.  Departamenti në bashkëpunim me zyrën e Alumnit ruajnë komunikime të shpeshta me të diplomuarit e tyre lidhur me ecurinë e tyre në tregun e punës dhe mbështetjen e tyre të mëtejshme nëpërmjet kualifikimit të vazhduar apo edhe paraqitjen e mundësive për punësim. Propozimet e tyre për përmirësime në programin e studimit janë parë gjithnjë me vlerë dhe të kanë qënë gjithmonë të mirëpritura.
<b>Konkluzione</b>	<i>Grupi i vlerësimit të jashtëm, në bazë të vizitës, takimeve, por edhe shqyrtimit të dokumentacionit relevant të ofruar në dispozicion, konstaton se të dhënat (regjistri) për studentët, që në regjistrimin e tyre dhe deri në përfundim të studimeve, janë të organizuara, sistemuara, dhe të mirëmbajtuara nga Sekretaria Mësimore e FAS. Këto të dhëna në regjistra fizikë dhe elektronik, rezultojnë të jenë të sakta dhe në përputhje me standardet bashkëkohore të regjistrimit dhe ruajtjes së të dhënave dhe kontrollit të tyre cilësor.</i>

<sup>143</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Analiza e punës vjetore për vitin akademik 2019-2020 në RFTV." ASCAL, Evidenca. Nr. 2.12. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sg>,


Shkalla e përmbushjes së standardit	Pa përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Mënyra dhe shkalla e përfaqësimit të studentëve në nivel të FAS dhe UART është e përcaktuar në bazë të Statutit të ri të UART<sup>144</sup> të MASR Nr 3937/5, datë 15.09.2021, me VSA Nr 15, datë 30.08.2021. Në bazë të dispozitave statutare (Kreu IX, neni 126) studentët në nivel qëndror, përfaqësohen në Senatin Akademik të UART prej 19 anëtarësh me 2 studentë, duke forcuar zërin e tyre në ngritjen e problemeve por edhe duke patur në konsideratë edhe zgjidhjen e tyre. Po ashtu, në përputhje me mundësitë që jep Statuti, përveç Senatit studentët përfaqësohen edhe në Këshillin e Etikës, Këshillin studentor, etj.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me studentë, nuk është shprehur, në mënyrë eksplicite, ndonjë shqetësim apo pakënaqësi për shkallën dhe nivelin e përfaqësimit të tyre në nivel fakulteti apo universiteti.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në frymën e ngritjes, sigurimit dhe mbarëvajtjes së një fryme bashkëpunimi të ndërsjellë me student, Grupi Vlerësues konfirmoi se me vendim të Senatit Akademik Nr 22, datë 07.10.2021 është miratuar Rregullorja e Komisionit të marrdhënieve me studentët, duke garantuar dhe zhvilluar kështu mbarrdhëniet e bashkëpunimit midis organeve drejtuese të UART dhe të studentëve të tij. Studentët përfshihen edhe në forma dhe mënyra të ndryshme në vlerësimin e procesit akademik. Sondazhet e bëra nga Sektori Mësimor mbledhin të dhëna për secilën lëndë, secilin pedagog dhe të gjithë studentët</p>

<sup>144</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Urdhër të MASR Nr. 319 datë 13.09.2021 "Për miratimin e Statutit të UART". Bashkëngjitur Statuti. " ASCAL, Evidenca. Nr.2.17.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

	<p>mund të japin mendimet e tyre lidhur me proceset. Për gjetjet e sondazheve, i është dorëzuar një raport edhe Rektorit të UART.</p> <p>Studentët kanë përfshirje edhe në hartimin e RVB-së në procesin e akreditimit, duke artikuluar kështu vlerësimin e tyre për nivelin e cilësisë dhe organizimit të studimeve në FAS në programet përkatëse që ata studiojnë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Gjatë takimit me Sektorin mësimor, GVJ u informua se në Universitetin e Arteve, si një institucion me veprimtari specifike siç është fusha e artit dhe me një numër të kufizuar studentësh, njësia përgjegjëse që garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi është Sektori Mësimor. Edhe në bazë të RVB-së<sup>145</sup>, dëshmohet se ky sektor, organizon sondazhe nëpërmjet pyetësorve për të mbledhur të dhëna lidhur me mësimdhënien, programet e studimit, facilitetet, burimet materiale, logjistikën dhe shërbime të tjera. Gjetjet e këtij raporti i bëhen të ditura nëpërmjet një raporti Rektorit të UART</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Përsa i përket procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, zbatohen procedurat e përcaktuara në rregulloret përkatëse. Studentëve u njihet e drejta e ankimimit edhe në bazë të Rregullores së programit të studimit, të miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr 37, datë 20.07.2022, Në bazë të dispozitave të kësaj Rregulloreje, studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kontestojë rezultatin e marrë në vlerësim nga ana e pedagogut.</p> <p>Kjo Rregullore përcakton qartë hapat dhe procedurat e procesit të ankimimit dhe zgjidhjes së ankesës deri në nivel përfundimtar, gjithnjë duke garantuar të drejtën e studentëve për ankimim dhe kontestim. Po ashtu, ky proces i ankimimit dhe kontestimit, në bazë të rregullave në fuqi, i nënshtrohet një monitorimi dhe transparence sa më të plotë.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Në lidhje me këtë fushë, dhe kriteret e saj, Grupi konstaton se FAS përfshin dhe angazhon studentët në organet</i></p>

<sup>145</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi" ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

	<i>vendimmarrëse e këshilluese, në bazë të normave statutare, po ashtu studentët janë të angazuar edhe në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Në takim me ta, studentët nuk kanë shfaqur ndonjë ankesë ose pakënaqësi për përfaqësimin e tyre në nivel të Fakultetit ose edhe Universitetit në të gjitha nivelet.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, gjatë vizitës në Institucion pati mundësinë që përveç Sektorit mësimor, Sekretarinë Mësimore, të takonte edhe përfaqësuesin e sektorit të projekteve.</p> <p>Gjatë këtyre takimeve me këta sektorë, Grupi u Informua se Universiteti i Arteve ka ngritur njësi me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve siç janë: Sekretaria Mësimore dhe Sektorin Mësimor i cili në përbërje të tij ka edhe strukturën e “Informimit të studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni dhe Koordinatorin i Institucional. Këto zyra ndjekin ecurinë e studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar këshillim për çështje akademike, në shërbim të procesit mësimor, si dhe ato studentore.</p> <p>Sipas rregullores se Sektorit Mësimor<sup>146</sup>, ky sektor ka si detyrë: Ndjekjen, gjurmimin dhe rritjen e marrëdhënieve të vazhdueshme me studentët aktualë dhe me studentët e diplomuar. Studentët e diplomuar të Universitetit të Arteve janë të gjithë artistë të mirëfilltë si dhe specialistë të lartë të fushës së mësuësisë sipas profilit në të cilin janë diplomuar. Kontributi i</p>

<sup>146</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART ” ASCAL, Evidenca. Nr.6.7. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

	<p>tyre në fushën e artit është i pazëvendësueshëm. UART është pjesë e rëndësishme e projektit GRADUA, projekt i cili do të mbështesë Universitetet Shqiptare duke implementuar një model të integruar të kërkesës bazuar në bazën e të dhënave të të diplomuarve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Ashtu siç jemi shprehur edhe më sipër, në bazë të dëshmive dhe fakteve të prezentuara, Grupi vlerëson se përveç Sekretarisë Mësimore dhe Sektorit Mësimor i cili në përbërje të tij ka edhe njësinë e Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni si dhe Koordinatorin i Institucional, përdoret me efikasitet të plotë faqja e ëeb-it të UART si dhe së fundmi sistemi PITAGORA në koordinim të plotë me Rrjetin Akademik Shqiptar. Kjo strukturë e tërë e sistemit të informimit dhe komunikimit, mundëson që studentët e FAS dhe Programit Mastër në RRFTV dhe Mësuesi, të informohen saktë dhe më kohë, për për rezultatet e tyre ashtu edhe me gjithçka tjetër në lidhje me procesin mësimor në programe që ata ndjekin. Dëshmitë për këtë janë dhënë në evidencat në fushat e mësipërme.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë takimit me Sektorin Mësimor, Grupit iu dëshmua se ky Sektor, ka pjesë të tij integrale edhe Informimin e Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Ky sektor është i mirorganizuar dhe funksionon mbi bazë të rregullativës përkatëse. Për të qenë në dispozicion më të madh për studentët, na u tha se specialist i këtij Sektori, njëkohësisht, është edhe Koordinatori Institucional, që mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Sic edhe është përshkruar në RVB<sup>147</sup>, Sektori mësimor një nga detyrat e tij ka edhe mbajtjen e marrëdhënieve të vazhdueshme me këshillat studentorë; drejtimin e procesit të këshillimit të studentëve; mbajtjen e komunikimit me tregun e punës, si dhe ofrimin e asistencës në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve në fushën e artit dhe kulturës. Po</p>


<sup>147</sup> Vizite në Institucion, dhe dëshmi në RVB: "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi & TV dhe Mësuesi" ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

	<p>ashtu, zyra ruan lidhje të ngushta me Këshillin Studentor dhe bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të ndryshme të propozuara prej studentëve. Gjithashtu, zyra bashkëbisedon me studentët e viteve të para për t'u prezantuar atyre: institucionin, programet, mundësitë e punësimit etj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Struktura e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni në UART, në bazë edhe të Rregullave në fuqi<sup>148</sup>, mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, dhe ka krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre, apo vazhdimin e studimeve të tyre postdiplomike, në institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit. Këto të dhëna ajo i siguron bazuar në komunikimet e vazhdueshme me ta, nëpërmjet adresave të e-mailit, të dhënave të kontaktit, adresave të rrjeteve sociale, etj.</p> <p>Duke respektuar të drejtën dhe obligimin për mbrojtjen e të dhënave personale, sidomos atyre më sensitive, Sektori Mësimor ka përgatitur dhe ka vënë në dispozicion një Formular, të cilën e shpërndan t eish-studentët, dhe të cilët, munden që në bazë të vullnetit të tyre të lirë ta plotësojnë me të dhënat për zhvillimin e mëtutjeshëm të tyre akademik dhe profesional.</p> <p>Ky formular dhe të dhënat që vendosen në të nga ish-studentët, janë vetëm për përdorim të brendshëm në UART për qëllime të evidencës statistikore, dhe si të tilla këto nuk mund të përdoren për qëllime të tjera jashtë Institucionit.</p> <p>Për të dhënë një pasqyrë më të saktë, dhe sa më gjithëpërfshirëse, çdo vit, struktura e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, harton plane dhe raporte vjetore në lidhje me gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar programin e studimit, dhe sipas kërkesës ua vë ato në dispozicion organeve përkatëse të FAS dhe Universitetit.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Në bazë të të gjitha dëshmimeve, fizike dhe takimeve përgjatë vizitës në Institucion, Grupi, me të drejtë, konstaton se UART, e sidomos FAS, ka të etabluar, rregulluar e mirstrukturuar sistemin e informimit dhe komunikimit me studentët, për të adresuar dhe zgjidhur problemet dhe shqetësimet e tyre, apo me identifikimine sfidave dhe atë arriturave të tyre akademike e</i></p>


<sup>148</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UART " ASCAL, Evidenca. Nr.6.7. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

	<i>profesionale pas diplomimit në programin në të cilin ata kanë studiuar.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Grupi Vlerësues, vërejtë se për shkak të specifikave që ofrohen në UART, tashmë tradicionalisht zbatohet mësimdhënia në auditor, si një mënyrë me e përshtatshme dhe interactive e mësimdhënies. Megjithatë, rrethanat pandemike, gjatë vitit akademik 2019-2020, imponuan edhe mënyrën alternative të organizimit të mësimdhënies. Për të ju përshtatur nevojave dhe rrethanave të reja të krijuara, gjatë kësaj kohe ishte ngritur dhe ishte vënë në funksionim sistemi Microsoft Teams <sup>149</sup> i ngritur nga Rektorati dhe sektori i TI. Për këtë arsye Sektori i TI vendosi në dispozicion manualin e përdorimit të këtij sistemi si për pedagogët ashtu dhe për studentët. Ky manual ishte përmbajtësor dhe lëhtësues në udhëzimet për organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor online, pra në distancë. Po ashtu, si rezultat i udhëzimeve të sakta dhe të duhura të manualit për përdorimin e këtij sistemi, me shumë sukses u organizuan edhe provimet, po ashtu online, si mënyrë alternative, individualish apo me grupe

<sup>149</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Manuali i përdorimit të sistemit Teams online" ASCAL, Evidenca. Nr.4.9. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sg>,

	të vogla të organizuara në bashkëpunim dhe nën drejtimin e stafit akademik.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	<p>GVJ gjatë takimit me Komisionin Ad Hoc për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë iu komunikua se një nga mekanizmat më të përdorur për monitorimin dhe vlerësimin periodik të ecurisë së programeve të studimit dhe aftësive mësimdhënëse të personelit akademik, janë sondazhet dhe pyetësorët të zhvilluara me studentët dhe pedagogët nga Sektori Mësimor, apo edhe nga vetë Departamentet. Ishte e qartë që strukturat kryesore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në UART janë njësitë bazë. Institucioni ndjek politika mbështetëse për kualifikimin e personelit akademik për të kontribuar në këtë mënyrë në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Kjo politikë, konsiston edhe në mbështetjen e mobilitetit të personelit akademik, me qëllim përfitim të eksperiencave dhe metodologjive të reja të mësimdhënies.</p> <p>Disa nga format e veçanta të mësimdhënies në RRFTV janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- organizimi i veprimtarive të përbashkëta artistike me studentë e pedagogë;</li> <li>- bashkëveprimi midis tyre në këto veprimtari;</li> <li>- bashkëveprimi me departamente të tjera.</li> </ul>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	<p>Institucioni ka një bazë të mirë ligjore dhe rregullative<sup>150</sup>. Prandaj, kjo bazë rregullative e Fakultetit të Artit Skenik dhe e Departamentit të Regji, Regji Filmi dhe TV, garantojnë përfshirjen e studentëve si në vlerësimin periodik, ashtu edhe në mundësinë e trajtimit të ankimimeve të natyrave të ndryshme.</p> <p>GVJ ju komunikua gjatë vizitës në institucion se për vetë specifikën e procesit mësimor, ku studiot dhe atelietë janë laboratorë të mirëfilltë kërkimorë, procesi mësimor parashikon përfshirjen e studentëve në çdo hap, nisur që nga paraqitja e programit të lëndës, hapat e realizimit të tij, te informimi për mënyrën e vlerësimit e deri te paraqitja e provimeve para publikut. Në të gjitha Studentët në UART kanë të gjithë vëmendjen e duhur si nga personeli akademik ashtu edhe nga ai</p>

<sup>150</sup> (Evidencë 2.2....Rregullorja e Ciklit të II-të të Studimit, Evidencë 2.3....Rregullorja e FAS, Evidencë 2.4....Rregullorja e Departamentit RRFTV, Evidencë 2.5....Rregullorja e Programit të Studimit RTSM, (Evidencë 2.7....Rregullorja e UART)



	<p>administrativ. Ashtu siç jemi shprehur edhe në kriteret e mësipërme, GVJ deklaroi se Institucioni, në të gjitha nivelet e organizimit të vet, ua jep mundësinë dhe ua garantoi të drejtën studentëve që të ankohen dhe se ankesat e tyre trajtohen konform rregullave në fuqi, në mënyrë transparente, të paanshme dhe krejtësisht meritore.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Mbështetur edhe në RVB<sup>151</sup>, GVJ shprehet se gjatë takimeve në Institucion, ju bë e qartë se rezultatet e monitorimit të cilësisë së programeve të studimit, të metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve, nëpërmjet pyetësorëve, bëhen publike nëpërmjet afishimit të tyre fizikisht në vende të dukshme në mjediset e brendshme të FAS, takimeve informuese me pedagogët dhe studentët, kontakteve me Këshillin Studentor të UART si dhe analizave vjetore të departamenteve. Ato publikohen periodikisht në faqen web të UART.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nxjerrja e rezultateve të monitorimit të cilësisë së programeve të studimit, të metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve nëpërmjet pyetësorëve, evidenton shembuj të praktikave të mira dhe brenda kufijve të etikës, duke nxitur stafin akademik për përmirësim të proceseve të mësimdhënies, të programeve të studimit. Njësia akademike e Programit në process të akreditimi, përmes mekanizmeve funksionale, nxit personelin akademik për zhvillim dhe avancim të vazhdueshëm në nivel profesional por edhe në teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Sa i përket kriterëve të këtij standardi, brenda kësaj fushe, GVJ deklaroi se FAS dhe Departamenti i RRFTV ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. Po ashtu, institucioni ka krijuar mekanizma që nxit, zhvillon dhe promovon përsosmërinë akademike në stafit në vazhdimësi, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<sup>151151</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi" ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Gjatë takimit me Dekanin dhe Përgjegjësën e Programit RRFTV, por edhe gjatë takimit me Komisioni Ad Hoc, Grupi krijoi një fushëpamje më të gjerë dhe më reale mbi strukturën kryesore përgjegjëse për sigurimin e cilësisë. Në këto takime, Grupi vërejti se Struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm është Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Mënyra e rregullimit, funksionimit dhe organizimit të kësaj strukture është është e përcaktuar dhe e parashikuar në Statutin e UART<sup>152</sup>. Po ashtu, Grupit iu tha se për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ishte ngritur edhe Komisioni Ad Hoc me Urdhër të Rektorit të UART.</p> <p>Sipas deklarimeve të tyre, Komisioni bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë<sup>153</sup> në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit, Statutin e UART. Ky Komision është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e</p>	<p>Referuar RVB, ndër politikat dhe rregulloret që standardizojnë funksionimin dhe detyrat apo angazhimin e Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë përmenden: Organizimi i Brendshëm i Cilësisë; Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve dhe Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit. Dokumenti kryesor që rregullon punën e këtij Komisioni është Manuali i Sigurimit të cilësisë.</p>



<sup>152</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Urdhër të MASR Nr. 319 datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të UART”. Bashkëngjitur Statuti.” ASCAL, Evidenca. Nr.1.15.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>153</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Manuali mbi “Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit” viti 2017 ” ASCAL, Evidenca. Nr.1.9. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<p>vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Gjatë vizitës dhe takimeve të ndërsjella, Grupit iu komunikua se Sigurimi i Cilësisë është një proces i vazhdueshëm i monitorimit, vlerësimit, garantimit, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë të të gjithë Universitetit të Arteve në përgjithësi por edhe të Fakultetit të Arteve Skenike, për të gjitha programet e saj. Institucioni, siç është dëshmuar, ka ngritur një Komision gjithëpërfshirës. Pjesë e këtij Komisioni për FAS ishte Përgjegjësi i Departamentit të RRFTV, i cili ja shtjelloi gjerësisht GVJ të gjithë specifikën dhe mënyrën e funksionimit të këtij Komisioni. Dokumenti kryesor që rregullon punën e këtij Komisioni është Manuali i Sigurimit të cilësisë<sup>154</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Grupi vëren se sigurimi i brendshëm i cilësisë garantohej nga vetë institucioni dhe menaxhohet nga Komisioni Ad Hoc. Po ashtu, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në nivel institucioni dhe programesh studimi organizohet në mënyrë periodike nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). UART i është akorduar riakreditimi institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.17, dt. 24.03.2022<sup>155</sup> duke e vlerësuar pozitivisht me vlerësimin maksimal, me kohëzgjatje 6 vite akademike. Ndërsa programi i studimit Master i Arteve në “Regji, Regji Filmi &amp; TV dhe Mësuesi”, ashtu si edhe të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë që ofrohen në FAS por edhe në UART, po i nënshtrohen akreditimit për herë të parë të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime</p>	<p>Një nga treguesit më të matshëm, për cilësinë e programeve të studimit dhe mësimdhënies në Universitetin e Arteve, është punësimi i studentëve të tij si brenda dhe jashtë vendit, në institucione prestigjioze të fushës së arteve që përbën edhe një nga pikat e forta të diplomuarve në këtë program studimi.</p> <p>Grupit iu dëshmuar se praktika që ndiqet për ndryshime dhe përmirësime të programeve të studimit, në funksion të rritjes së</p>

<sup>154</sup> UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Manuali mbi “Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit” viti 2017 ” ASCAL, Evidenca. Nr.1.9. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>155</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Vendim Nr. 17 dt. 24.03.2022 i Bordit të Akreditimit të ASCAL për Akreditimin Institucional të UART” ASCAL, Evidenca. Nr.3.13. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<p>nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>cilësisë, është e përcaktuar dhe në përputhje me Rregulloret<sup>156</sup> për funksionimin e Fakultetit dhe Rregulloret Mësimore të dy cikleve të studimit me kohë të plotë Bachelor dhe Master, e posaçërisht për programin që është në process akreditimi. FAS, dhe njësia e programit përkatës, ka ofruar si dëshmi vërtetim punësimi për ish studentë<sup>157</sup>.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Për sa i përket dëshmive fizike dhe rezultateve nga takimet gjatë vizitës, Grupi deklaroi se Institucioni, brenda saj edhe FAS në Programin, me të cilin aplikon, zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Këto politika janë të strukturuar dhe mirëfunksionale, të cilat japin rezultate konkrete të prekshme.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë</p>	<p>Nga dokumentacioni i ofruar konfirmohet se mbikëqyrja e herëpashershme e programit të studimit Master i Arteve në "Regji, Regji Filmi &amp; Tv dhe dhe Mësuesi" bazohet në grumbullimin dhe evidentimin e informacionit nëpërmjet pyetësorëve të cilët plotësohen në fund të çdo semestri e që i kushtohen vlerësimit të programit të studimit dhe personelit akademik<sup>158</sup>.</p>

<sup>156</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e ciklit të II të studimit Master në UART." ASCAL, Evidenca. Nr.2.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>, dhe "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Rregullorja e Programit MA RFTV dhe Mësuesi" ASCAL, Evidenca. Nr.2.5.5. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>157</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Vertetim punësimi nga ish studentë" ASCAL, Evidenca. Nr.3.20. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>158</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Të dhëna nga pyetësori i studentëve" ASCAL, Evidenca. Nr.4.6. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


100




<p>proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Nga kjo rezulton se ky vlerësim i programit të studimit, të ofruar nga Fakulteti i Artit Skenik kryhet duke analizuar përputhshmërinë me objektivat dhe strategjinë e zhvillimit, të programit të studimit.</p> <p>Procesi i përpunimit të të dhënave nga pyetësorët kalon nëpër një procedurë standard, rregulluar sipas hierarkisë si në vijim: Gjetjet dhe përgjigjet në këto pyetësor shqyrtohen në Departament duke shqyrtuar problematikat e hasura dhe ecurinë e mësimdhënies për çdo pedagog. Departamenti analizon të gjitha elementët e realizimit të tij, si mbulimi me materiale studimore, realizimi i formave të kontrollit të vazhdueshëm dhe provimit përfundimtar të lëndëve, realizimi i praktikave profesionale, realizimi i punimeve të diplomave dhe bën propozimet përkatëse për ndryshime, nëse e vlerëson të arsyeshme. Pastaj, për të bërë këtë analizë, departamenti mbështetet në sugjerimet dhe komentet e stafit mësimdhënës, në anketimet e studentëve, si dhe në të dhëna që gjenerohen nga sekretaritet mësimore. Departamenti shqyrton analizat e programeve të studimit që mbulon dhe përcjell në dekanat raportin e analizës mësimore të departamentit. Dhe krejt në fund, dekanati harton raportin e analizës mësimore të fakultetit, të cilën e përcjell në rektorat.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Referuar RVB<sup>159</sup> dhe takimeve në institucion, kuptojmë se një formë e vlerësimit sidomos për stafin akademik është edhe vlerësimi i tij prej strukturave përgjegjëse e drejtuese në fund të çdo viti akademik. Njësitë kryesore pasi marrin në dorëzim raportet, i analizojnë konkluzionet me stafet e tyre akademike, ku ftohen dhe përfaqësues të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të dhënë komentet përkatëse, dhe ndërmarrin veprime me hapa konkretë për përmirësimin e situatës. Sipas RVB, në formatin e vetëvlerësimit të stafit akademik, strukturat menaxhuese kur e shohin të arsyeshme kanë mundësi të bëjnë komente dhe sugjerime për secilin pjesëtar të stafit. Grupi u informua se mbi bazën e vlerësimeve të përsëritura negative, ka patur raste të mosrinovimit të kontratës për personelin akademik<sup>160</sup>. Në disa raste, për të adresuar problematikat e</p>

<sup>159</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi" ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>160</sup> Takim me Komisionin Ad Hoc,

	konstatuara, janë zhvilluar trajnime si për shembull për kuptimin e kurrikulës nga stafi i ri, përdorimin e teknikave të mësimdhënies etj.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Referuar shqyrtimit dhe analizimit të RVB <sup>161</sup> , Grupi kupton se metodat e drejtpërdrejta të përdorura në procesin e vlerësimit kanë përfshirë, takimet e autoriteteve drejtuese me studentët, takimet e autoriteteve drejtuese me qeverinë studentore, takimet e përgjegjësve të departamenteve me studentët e programeve të studimit, takimet me studentët ALUMI, vëzhgime në auditor për metodat dhe pedagogjinë e mësimdhënies së stafit akademik apo angazhimin e studentëve, vlerësimet e testeve dhe ecuria gjatë një viti akademik e studentëve programit, analizë e problematikave lidhur me frekuentimin dhe kalueshmërinë etj.  Po ashtu, Grupi pati rastin të konfirmojë një pjesë të këtyre elementëve gjatë takimeve në institucion me stafin akademik, studentët, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm dhe Komisionin Ad Hoc të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Nga këto takime, Grupi krijoi një fushëpamje më të gjerë dhe më të thellë në lidhje me këtë problematikë.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e	Shqyrtimi i RVB-së <sup>162</sup> dhe takimet me grupet strukturore dhe përgjegjëse në institucion, ia dëshmon Grupit të Vlerësimit të Jashtëm se në masë të madhe institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si pyetësorë, anketime, raporte vjetore, raporte vlerësimi programi, raporte vlerësimi prej strukturave drejtuese, vetvlerësim të stafit akademik, pyetësorët me studentët ALUMNI, vlerësimet e studentëve ALUMNI, gjurmimin e studentëve dhe mbledhjen e të dhënave për punësimin (për punësimin në profil ose jashtë profili etj), takimet me ALUMNI në institucion, gjatë trajnimeve

<sup>161</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi" ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>162</sup> <sup>162</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi" ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>, dhe takimet ne Institucion.

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

102

<p>administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>ose në sipërmarrjet ku ata punojnë. Një pjesë e këtyre çështjeve janë elaboruar dhe evidentuar më në hollësi edhe në kriteret e standardeve të fushave më të lartrenditura të këtij draft-raporti.</p> <p>Në kuadër të fushëveprimtarisë së tyre, Grupi konfirmon se Sektori Mësimor, Alumnit dhe Karrierës, realizon studime periodike të punësimit të studentëve dhe zotëron një databazë të studentëve të punësuar. Po ashtu, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka pranuar si fakte të mirëqena evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vlerësimit në institucion.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Në lidhje me zbatimin dhe përmbushjen e kriterëve të këtij standardi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, konstaton se Institucioni, me njësitë e tij vartëse, monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet. Kjo strukturë ka bazë rregullative dhe funksionon sipas standardeve bashkëkohore.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të jashtëm, konstaton se Sigurimi i brendshëm i cilësisë në institucion menaxhohet nga Komisioni ad Hoc për Sigurimin e Cilësisë, aktiviteti i së cilës synon përfshirjen e numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Në varësi edhe të fushës së ekspertizës, aktorët e brendshëm angazhohen më tepër në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësidhënies në gjithë elementët përbërës të saj, ndërsa aktorët e jashtëm kontribojnë në drejtim të përshtatjes së programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. Po ashtu duhet thënë se i</p>




	<p>gjithë aktiviteti i këtij Komisioni bazohet në Statutin e UART<sup>163</sup>, bazën Rregullative të UART dhe në mënyrë të veçantë në Manualin e Sigurimit të cilësisë. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit nga NJSBC me rëndësi konsiderohet edhe informacioni dhe eksperiencat e përfuara në kuadër të mobiliteteve në universitete jashtë vendit që kanë realizuar pjesëtarët e stafit akademik të institucionit, në rastin tonë edhe të Programit në proces të vlerësimit<sup>164</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Referuar RVB, përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë dhe strukturat e angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në dokumentet bazë si Organizimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit, Manualin e Sigurimit të cilësisë.</p> <p>Strukturën, mënyrën e organizimit për sigurimin dhe monitorimin e brendshëm të cilësisë e kemi sqaruar edhe në kriterët e standardeve të fushave të mësipërme. Këtu po e përmendim vetëm rolin e Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Sektori Mësimor dhe i Kurrikulës, ku anëtarët e këtij komisioni dhe këtij sektori, kanë përgjegjësi dhe detyra konkrete dhe të ndryshme, në përshtatje edhe me rolet që ata kanë në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Në RVB<sup>165</sup>, përgjegjësit e institucionit dhe Programit, kanë dhënë shpjegime të mjaftueshme bindëse për skemën e organizimit dhe funksionimit të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të</p>	<p>Nga vlerësimi parësor dhe i përgjithshëm, mbizotëron bindja se institucioni, përkatësisht strukturat në FAS, kanë garantuar një proces gjithëpërfshirës për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Master i RRFTV dhe Mësuesi.</p> <p>Përtej kësaj, edhe nga takimet që ka patur Grupi, me grupet përkatëse dhe personat përgjegjës, u konstatua se ka patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe</p>

<sup>163</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "VSA Nr. 12 dt. 07.07.2021 ""Për miratimin e Statutit të UART"" ASCAL, Evidenca. Nr.1.15.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>164</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "UART në Marrëveshjet e Bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus +" ASCAL, Evidenca. Nr.2.13. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>165</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi" ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

Adresa: "Rruga e Durrësit"


Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

104




<p>personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj., për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit me qëllim, jo vetëm përmbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit dhe vetë institucionit<sup>166</sup>.</p> <p>Grupi vlerëson dhe mirëpret secilin angazhim konkret, që përforcon zbatimin e kriterëve për sigurimin e cilësisë dhe kontrollit të tij, më një pjesëmarrje sa më të gjerë të të gjithë aktorëve relevantë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit Master i Arteve në “Regji, Regji Filmi&amp;Tv dhe Mësuesi”, në veprimtarinë e saj, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë mbështetet nga Universiteti i Arteve në përgjithësi si dhe nga Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamenti i RRFTV në veçanti. Në punën e saj ky Komision zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. Gjatë punës së tij, Grupi i Vlerësimit, nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe anketimet e kryera në veçanti mbështetet nga Universiteti i Arteve në përgjithësi si dhe nga Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamenti i RRFTV në veçanti. Në punën e saj ky Komision zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe anketimet e kryera në veçanti.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e</p>	<p>Referuar RVB<sup>167</sup>, Fakulteti i Artit Skenik ka një bashkëpunim të vazhdueshëm me artistë të njohur të fushave të ndryshme të artit, si brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet angazhimit të tyre në procesin e mësidhënies si pedagogë me kohë të pjesshme. Nëpërmjet zhvillimit të shkëmbimeve të drejtpërdrejta me regjisorë, aktorë, pedagogë, dramaturge, të vendit apo të huaj nga rajoni apo më gjerë, vazhdimisht merret ekspertizë e vlefshme lidhur me programet e mësim, cilësisë dhe përafrimin e tyre me programet e IAL simotra dhe cilësinë e mësimdhënies, nëpërmjet</p>

<sup>166</sup> <sup>166</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi” ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>, dhe takimet gjate vizites ne FAS.

<sup>167</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi” ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	ballafaqimit të nivelit të përgatitjes së studentëve në këto masterclass-e. Nga bisedat na u bë me dije se ekspertiza dhe sugjerimet e tyre vijnë nëpërmjet tryezave të rrumbullakëta, aktiviteteve të përbashkëta, mbledhjeve etj. Në këto rast është konsideruar me prioritet opinioni i bashkëpunëtorëve të jashtëm për të vlerësuar dhe pasqyruar elementë që lidhen me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. Institucioni përkatësisht FAS, gjithnjë mbetet e hapur për të zgjeruar horizontet e bashkëpunimit të ndërsjellë me me artistë të botës së filmit, si mundësi shtesë për studentët e këtij programi në këtë cikël studimesh.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit duke përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të këtij program studimi, duke përbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përbushjes</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni ka një qasje proaktive sa i përket publikimit të politikave, strategjisë, por edhe aktiviteteve të sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në këtë përpjekje të Institucionit, duhet theksuar se faqja web e UART është lehtësisht e qasshme me të gjithë informacionin e saj, prandaj është e verifikueshme plotësisht se UART, përkatësisht, FAS, ka në politikën e tij bërjen e transparencës për të gjithë aktet rregullatorë, Vendime të Senatit Akademik, të Bordit të Administrimit si dhe çdo veprimtari tjetër të njëjësive të tjera, në faqen e ëeb-it të universitetit. Publikimi i këtyre dokumenteve dhe të dhënave

	relevante, që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionim e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësohet si një hap pozitiv dhe i rëndësishëm në transparencë.
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni qarkullon të dhënat relevante të raporteve që kanë të bëjnë me vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit. Në përpjekje për të respektuar parimin e transparencës, nga ana e strukturës përgjegjëse, u është dërguar me email të gjithë stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të Fakultetit të Artit Skenik, një pjesë e të cilëve nuk ishin pjesë përbërëse e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm<sup>168</sup>.</p> <p>Grupi rikujton këtu se sipas RVB, parimet mbi të cilat ndërtohet Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë janë të përcaktuara në Rregulloren e Sektorit Mësimor dhe i Kurrikulës si dhe në Rregulloren e Komisionit të Sigurimit të Cilësisë. Janë këto parime që sigurojnë garantimin e transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e njësive të tij, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj. Në këtë aspekt, Institucioni ka bërë hapa seriozë në përmbushjen e detyrimeve për transparencë në komunikim të ndërsjellë për çështje që kanë të bëjmë me cilësinë në mësimdhënie.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Me sa është kuptuar nga faktet e paraqitura, një rol të posaçëm luan dhe Sektori Mësimor dhe i Kurikulës, si dhe Sektori i TI, duke përgatitur raporte me përmbledhje të dhënash lidhur me përgjigjet e pyetësorëve. Gjithashtu, GVJ është i mendimit se, adresimi i problematikave të konstatuara gjatë hartimit të RVB<sup>169</sup> dhe të dala gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm dhe vendimit të Bordit të Akreditimit për akreditimin institucional, vlerësim i dhënë së fundmi, konfirmojnë angazhimin e institucionit në këtë drejtim. Megjithatë, Grupi mendon se ky angazhim duhet të jetë i vazdhueshëm. Nga takimi në institucion GVJ u informua për elementë të cilët kanë qenë në fokusin e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit e që kanë rezultuar nga anketimet e kryera. Po ashtu, në raportet e përgatitura për</p>


<sup>168</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "Shkëmbime emailësh për RVB" ASCAL, Evidenca. Nr.6.15. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

<sup>169</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT. "RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi" ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq> dhe takime ne institucion.

	<p>instancat e ndryshme ka elementë të rekomandimeve apo përmirësimeve të nevojshme që duhet të merres në konsideratë dhe të adresohen me seriozitet.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Parimisht është vlerësuar dhe konstatuar se procesi i vlerësimit dhe sigurimit të efektivitetit dhe impaktit të veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit është një proces kompleks i cili kërkon angazhimin e të gjithë strukturave të institucionit. Në nivel institucioni kjo, sipas të dhënave të konfirmuaraa të RVB, në Institucion dhe në Program, realizohet përmes strategjive, matshmërisë së realizimit të objektivave, studimeve të tregut, raporteve, analizave, vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme, pyetësorëve dhe anketimeve, angazhimit të ekspertëve dhe të gjitha instrumenteve të tjera akademike dhe administrative.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ sugjeron, që një proces i monitoruar në mënyrë më të përqëndruar, do të kishte një impakt më të spikatur në përmirësimin e sigurimit të cilësisë. Kjo do të ishte në dobi më afatgjate, jo vetëm për Programin që i nënshtrohet vlerësimit, por edhe vetë institucionit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB<sup>170</sup>, është e shprehur qartë se Komisioni i Sigurimit të Cilësisë dhe Sektori Mësimor dhe i Kurrikulës, organizojnë veprimtari periodike me personelin dhe me studentët për informimin, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e tyre mbi sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit nëpërmjet pyetësorëve të zhvilluar për këtë qëllim.</p> <p>GVJ ju konfirmua nga disa drejtime se një sërë takimesh janë realizuar me stafin akademik të bendshëm dhe të jashtëm në kuadër të riakreditimit institucional të UART, proces i cili u mbyll me një vlerësim maksimal. Takime janë zhvilluar edhe me sektorët dhe njësitë përgjegjëse brenda FAS dhe Institucionit.</p> <p>Megjithatë, edhe pse Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu bë një paraqitje shumë e mirë e të gjithë punës së Komisionit AD Hoc për Sigurimin e Cilësisë, <i>GVJ i rekomandon Universitet të Arteve, që këtë Komision ta shndërrojë në një Njësi Permanente</i></p>

<sup>170</sup> "UART", Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, "RVB, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Arteve, Regji Filmi& TV dhe Mësuesi" ASCAL, Dok.Nr.1. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>.

	<i>për Sigurimin e Cilësisë, në përputhje edhe me Statutin dhe Organogramin të miratuar nga Ministria e Arsimit<sup>171</sup>, që do të kishte mandate dhe fushëveprimtari të qartë për Sigurimin e Cilësisë në Institucion e rrjedhimit edhe në Program.</i>			
<b>Konkluzione</b>	Nga pikëpamja dhe këndvështrimi i analizës së hollësishme, të materialeve të ofruara dhe dëshmime të mbledhura përgjatë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, konstaton e Politikën, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë. Institucioni ka në dispozicion bazë ligjore, rregullative dhe mekanizma për ta mirëzbatuar sistemin e kontrollit të cilësisë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Arteve Regji Filmi & Tv dhe Mësuesi”,**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Pika më e fortë e Programit të Studimit është historiku që programi përcjell, si edhe gërshetimi i një kombinimi brezash, kulturash, si edhe përvojash të shumëllojta, me personel akademik me përvojë të gjatë në fushën e mësimdhënies, si edhe në atë profesionale. Gjithashtu, stafi akademik ka në jetëshkrimin e tij specializime të shumta dhe të shumëllojshme si edhe mbart mbi vehte një përvojë të pasur shumëvjeçare. Si rrjedhojë, burimet njerëzore janë më se të mjaftueshme për zhvillimin në normalitet të procesit mësimor, si edhe ka një qëndrueshmëri të kuadrit akademik, shtuar edhe një raport të përshtatshëm midis brezave të ndryshëm të personelit mësimdhënës;

<sup>171</sup> “UART”, Fakulteti i Artit Skenik, DRRFT, “Urdhër të MASR Nr. 319 datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të UART”. Bashkëngjitur Statuti.” ASCAL, Evidenca. Nr.1.15.2. Parë në Tetor 2022, gjendet në: <https://ascal.al/sq>,

2. Pikë tjetër e fortë është përshtatja e kurrikës së Programit të Studimit me nevojat e tregut të punës, duke shtuar se ndryshimet më të fundit u mundësojnë studentëve, të cilët ndjekin këtë program, që të kenë akses edhe në fushën e mësimdhënies;
3. UART, në përbërje të të cilit është edhe FAS/DRFTVPM, për vetë natyrën e tij specifike është unik dhe ka në natyrën e vet të brendshme bashkëpunimin ndërinstytucional me aktorë të tjerë brenda dhe jashtë vendit, duke mundësuar angazhimin e studentëve, pedagogëve, por edhe Alumnëve të RFTVM, në projekte dhe punësim me kohë të pjesshme apo të zgjatur në institucione kulturore vendase, apo angazhimin e tyre në shumë aktivitete artistike e didaktike të përbashkëta;

**b. Pika të dobta:**

1. Një nga pikat që duhet pasur në konsideratë është unifikimi i gjithë dokumentacionit me anë të përfshirjes së kodit programit; (*Standardi II.1, Kriteri 8*)

**Rekomandime**

1. Duhet të ofrohen trajnime të mëtejshme profesionale për të gjithë të interesuarit në këtë fushë;
2. Në çdo raport apo analizë që merret me veprimtarinë vjetore të FAS dhe të Departamentit të RRFTV, të merret në konsideratë edhe analizimi i zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara me rrugë institucionale, që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi & Tv dhe Mësuesi”.
3. Kodi 72MA0211S i Programit të Studimit Master i Arteve “Regji Filmi & Tv dhe Mësuesi” të shoqërojë të gjithë dokumentacionin që i përket këtij programi;
4. Disa informacione në faqen zyrtare të UART-it mund të ofrohen edhe në gjuhën angleze, edhe pse jo të gjitha;
5. Rekomandohet që procesi i vlerësimit të cilësisë të monitorohet në mënyrë më të përqëndruar, me qëllim përmirësimin e sigurimit të cilësisë. Kjo do të sjellë efekte pozitive afatgjata, jo vetëm për programin që i nënshtrohet vlerësimit, por edhe vetë institucionit;
6. Komisioni i sigurimit të cilësisë duhet të shndërrohet në një Njësi Permanente për Sigurimin e Cilësisë, në përputhje edhe me Statutin dhe Organogramën të miratuar nga Ministria e Arsimit, që do të kishte mandat dhe fushëveprimtari të qartë për Sigurimin e Cilësisë në Institucion; për rrjedhojë edhe në program;




## Conclusions of the Evaluation of the second Cycle Study Program "Master of Arts" in Film and Television Directing and Teaching offered by the University of Arts, Tirana

### a. Strong Points and affirmations

1. The strongest point of the Study Program is the history that the program conveys, as well as the combination of different generations, cultures, and various experiences, with highly experienced academic staff both in teaching and in the professional field. Additionally, the academic staff has numerous and diverse specializations in their curriculum vitae and possess rich and extensive experience. As a result, the human resources are more than sufficient for the normal development of the teaching process, and there is a stable academic staff, as well as a suitable ratio between the different generations of teaching personnel;
2. Another strong point is the adaptation of the Study Program curriculum to the needs of the job market, adding that the latest changes allow students who follow this program to have access to teaching as well;
3. UART, of which FAS/DRFTVPM is a part, due to its specific nature, is unique and has an internal inter-institutional cooperation with other actors both within and outside the country, enabling the engagement of students, teachers, and even former RFTVM alumni, in joint projects and employment with full-time or part-time positions in local cultural institutions, or engaging them in various joint artistic and educational activities;


### b. Weak Points:

1. One of the points that must be taken into consideration is the unification of all documentation by including the program code; (*Standard II.1, Criterion 8*)

### Recommendations:

1. Professional training should be offered to all interested parties in this field;
2. In every report or analysis that deals with the annual activity of FAS and the Department of RRFTV, consideration should be given to the analysis of the implementation of agreements signed through institutional channels, which are directly related to the implementation of the Master of Arts program "Film & TV Directing and Teaching";
3. Code 72MA0211S of the Master of Arts program "Film & TV Directing and Teaching" should accompany all documentation related to this program;

4. Some information on the official UART website may be provided in English, although not all;
5. It is recommended that the quality assessment process be monitored in a more focused manner, with the aim of improving quality assurance. This will have long-term positive effects, not only for the program that undergoes evaluation, but also for the institution itself;
6. The quality assurance commission should be transformed into a Permanent Quality Assurance Unit, in accordance with the Statute and Organizational Status approved by the Ministry of Education, which would have a clear mandate and scope of activity for Quality Assurance in the Institution; consequently, also in the program;





Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

